Analizë e situatës së fëmijëve në lëvizje në KOSOVË

Autore:
Natyra Avdiu

Hulumtues:
Sophie Barral
Vjollca Shahini

Terre des hommes
Helping children worldwide. tdh.ch
mario
OAK FOUNDATION

Shtator 2014

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes 2

Përmbledhje ekzekutive 5

Lista e shkurtesave 7

Fjalor 7

I. Hyrje 11

II. Metodologjia 12

a. Kërkimet sekondare 12

b. Intervistat gjysmë të strukturuara me FnL dhe personat përgjegjës 13

c. Vrojtimi 14

d. Diskutime të hapura në grup 15

III. Konteksti 15

IV. Korniza ligjore dhe politike në Kosovë 18

a. Kushtetuta e Republikës së Kosovës 18

b. Legjislacioni i shërbimeve dhe asistencës sociale 20

i. Shërbimet sociale dhe familjare 20

ii. Asistenca sociale 22

c. Legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore dhe punës së fëmijëve 23

e. Legjislacioni mbi azilin 28

f. Legjislacioni mbi ripranimin/ të kthyerit 30

V. Sistemi për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë 33

VI. Profili i fëmijëve në lëvizje në Kosovë 36

1. Profili i FnL: Fëmijët flasin 36

a. Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës dhe/ose që janë në lëvizje gjatë ditës 37

i. Të jesh i detyruar të kërkosh lëmoshë 37

ii. Të jesh i varfër 37

iii. Të qenit dinjitoz dhe krenar ..... **Error! Bookmark not defined.**

iv. A jam unë FnL? 39

v. Të dëshirosh një të ardhme më të mirë..... 40

vi. Të jesh fëmijë dhe të luash 40

vii. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë 41

viii. Arsimimi 41

b. Fëmijët nga Shqipëria 43

i. Shëndeti dhe siguria 43

ii. Varfëria 43

iii. Gjetja e mënyrave për t'u kthyer 44

c. Të qenit në lëvizje si familje 44

d. Fëmijët e kthyer 46

i. Vështirësitë në integrim..... 46

ii. A jam unë një FnL?..... 47

iii. Të mësuarit për t'u përshtatur 48

iv. Banimi 49

v. Përgjegjësia për të kontribuar dhe mungesa e mundësive..... 49

2. Profili i FnL përmes vëzhgimit..... 50

3. Diskutimi i fokus grupit 55

VII. Reagimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijës për FnL..... 58

a. Ngritja e vetëdijes së personave përgjegjës për SMF..... 59

b. Vetëdijësimi i personave përgjegjës për FnL 61

c. Qasja dhe arritshmëria..... 63

d. Gjithëpërfshirja..... 64

e. Përshtatshmëria 66

i. Identifikimi i FnL 66

ii. Mandati i gjerë dhe bashkëpunimi 68

iii. Task Forca/Modeli i TMR-së 69

iv. Posedimi i një plani operacional 69

v. Perspektiva e OJQ-ve 70

Përfundim 71

Rekomandimet 72

Shtojca 1 Sistemi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (FnL) 75

Shtojca 3 Mostra e Pyetësorit – Fëmijët 79

Shtojca 4 Mostra e pyetësorit – Personat përgjegjës 80

Referencat 81

Përmbledhje ekzekutive

Termi 'Fëmijët në lëvizje' (FnL) nuk njihet mirë në Kosovë, gjithashtu nuk njihet mirë prej profesionistëve të cilët e përbëjnë sistemin për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, kategori të ndryshme të fëmijëve, sidomos fëmijët që kërkojnë lëmoshë ose mbledhin mbeturina metalesh, janë më se të dukshëm në një numër të qyteteve Kosovare përderisa fëmijët të cilët janë trafikuar ose janë në rrezik të trafikimit, si dhe të kthyerit janë gjithashtu prezent mirëpo ndoshta me shkallë më të vogël të dukshmërisë.

Ky raport përqendrohet në këto grupe të fëmijëve duke shqyrtuar nëse korniza ligjore dhe politike në Kosovë i mbronë të drejtat e tyre në masë të mjaftueshme. Gjithashtu përqendrohet në profilin e fëmijëve në lëvizje në Kosovë, ku fëmijët mund të flasin rreth aktiviteteve më të cilat ata merren si për arsyet e lëvizjes së tyre. Përveç kësaj, ky raport merr parasysh reagimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës kundrejt fëmijëve në lëvizje për sa i përket vetëdijësimit, qasjes dhe shkallës së arritjes, përfshirjes dhe përshtatshmërisë.

Analiza e kornizës ligjore dhe politike në tërësi tregon se i përfshinë grupet e ndryshme të fëmijëve që mendohet se janë në lëvizje. Megjithatë ka fusha specifike ku mund të bëhen përmirësime duke përfshirë: obligimet specifike për ofrim të shërbimeve, të siguruarit se të gjithë fëmijët në nevojë janë përfshirë brenda regjistrit të Qendrës për Punë Sociale (QPS) dhe të siguruarit e bashkëpunimit efektiv ndërmjet QPS-ve kur trajtojnë rastet e fëmijëve të cilët janë vazhdimisht në lëvizje prej komunës në komunë ose prej shteti në shtet. Ngjashëm, skema e asistencës sociale jo–domosdoshmërisht e zbutë varfërinë dhe në disa raste varfërinë e skajshme që është evidente sidomos tek fëmijët në lëvizje. Për sa i përket fëmijëve viktima të trafikimit, është e domosdoshme të harmonizohet definicioni i trafikimit ndërmjet ligjit të ri kundër trafikimit dhe Kodit Penal si dhe të nxiten përpjekjet për hetime dhe ndjekje penale të personave ose grupeve të involvuara në trafikim të fëmijëve si dhe atyre që kryejnë vepra tjera penale kundrejt fëmijëve viktima. Përderisa sa i përket fëmijëve të kthyer, procedurat e kthimit duhet të merren parasysh me qëllim që autoritetet dhe profesionistët të fokusohen tek fëmijët edhe gjatë periudhës së riintegrimit ku primar është interesi më i mirë i fëmijës.

Fëmijët në lëvizje në Kosovë i përkasin etniteteve të ndryshme (duke përfshirë edhe fëmijët nga Shqipëria), angazhohen në aktivitete të ndryshme dhe arsyet e tyre për lëvizje ndryshojnë. Pjesa më e madhe e fëmijëve të intervistuar ka folur mbi grumbullimin e kanaqeve dhe mbeturinave metalike, disa për kërkim lëmoshe e disa tjerë kanë folur mbi shitjen e artikujve të vegjël në rrugë apo në kafene. Në shumicën e rasteve fëmijët e përmendin varfërinë si arsyen kryesore që i shtyen ata të angazhohen në kërkim lëmoshë apo në grumbullim të kanaqeve dhe mbeturinave metalike. Edhe pse ka fëmijë të cilët janë në gjendje të shpjegojnë se ata janë detyruar me forcë të angazhohen në aktivitete përkatëse prej anës së prindit apo ndonjë të rrituri tjetër. Me rëndësi të veçantë, një numër mjaft i madh i fëmijëve të intervistuar e percepton kërkimin e lëmoshës si një aktivitet të turpshëm, përderisa për grumbullimin e kanaqeve dhe mbeturinave metalike ata kanë thënë se me këtë aktivitet merren me krenari. Poashtu, të qenit në lëvizje përfshinte obligimin për të kontribuar, krijimin e mundësive për të luajtur dhe dëshirën për një të ardhme më të mirë.

Disa fëmijë, jo domosdoshmërisht e shohin vehten si fëmijë në lëvizje, ky ishte rasti sidomos me fëmijët e kthyer. Ndërsa fëmijët nga Shqipëria përfaqësonin një gjendje të vështirë të varfërisë dhe përjashtimit ndonjëherë me rreziqe shtesë të kalimit të kufirit, me fëmijë që ishin në lëvizje me familjet e veta. Në shumicën e rasteve fëmijët e intervistuar nuk e vijonin procesin mësimor në shkollë, duke përfshirë disa fëmijë që nuk kishin shkuar asnjëherë në shkollë dhe pjesa më e madhe e tyre nuk kishte ndonjë përkrahje të vazhdueshme prej autoriteteve me qëllim të përmirësimit të situatës së tyre. Poashtu paraqitet edhe profili i fëmijëve përmes vrojtimit në atë mënyrë që përshihet një fëmij hulumtues 'S' i cili siguron informata shtesë për situatën e fëmijëve në rrugë dhe përdorimin e tyre prej të rriturve përderisa kërkojnë lëmoshë, detyrimin me forcë për të kërkuar lëmoshë ose nëse ka elemente të kontrollit të përdorura nga palët e treta.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistëve të cilët janë pjesë integruese e këtij sistemi, punëtorët social dhe zyrtarët policor, kanë qenë të vetëdijshëm për FnL siç janë fëmijët nga Shqipëria ose fëmijët nga mjediset e varfëra socio-ekonomike të cilët grumbullojnë kanaqe ose mbeturina tjera metalike. Gjithashtu, disa profesionistë kanë identifikuar fëmijë të cilët janë trafikuar prej komune në komunë brenda Kosovës. Pjesa më e madhe e profesionistëve të intervistuar mendonin se sistemi i mbrojtjes së fëmijës nuk është lehtësisht i arritshëm dhe nuk ofron shtrirje të gjerë të mjaftueshme. Ngjashëm, janë identifikuar brenga në lidhje me përfshirjen pasi asistenca afatgjatë zakonisht nuk i ofrohet fëmijëve që nuk janë banorë legal, me përjashtim të viktimave të trafikimit. Sa i përket përshtatshmërisë, ka sfida të cilat hasen gjatë punës në këtë mjedis mirëpo tryeza për menaxhim të rasteve shihet si mënyrë pozitive e punës për identifikim dhe asistim të fëmijëve të cilët janë në rrezik sikurse fëmijët e trafikuar.

Në përgjithësi, ky raport me qëllim synon të rrisë dukshmërinë e fëmijëve në lëvizje në Kosovë, fëmijëve të cilët operojnë në hapësira publike dhe gjendja e vështirë e të cilëve nuk vërehet gjithmonë prej institucioneve. Përmes zërave të fëmijëve është më se e qartë se ata jetojnë një jetë të vështirë dhe kanë nevojë për ndihmë prej të rriturve gjatë ballafaqimit me disa prej problemeve në të cilat hasin në baza ditore. Në anën tjetër, e rëndësishmja është se profesionistët e pranojnë se ka problem brenda vet sistemit, pasi që qasja në të nuk është e lehtë dhe adekuate siç do të duhej të ishte dhe përdorimi i të gjeturave të tilla në planifikimin e veprimeve të ardhshme prej të cilave do të përfitojnë fëmijët në lëvizje do të përbëjë një sfidë të vërtetë.

Lista e shkurtesave

KQR	Komisioni Qendror për Riintegrim
TMR	Tryeza për Menaxhim të Rastit
FnL	Fëmijët në lëvizje
SMF	Sistemi për mbrojtje të fëmijës
KDF	Konventa mbi të drejtat e fëmijëve
QPS	Qendra për punë sociale
DShAM	Departamenti për shtetësi, azil dhe migracion
DRPR	Departamenti për riintegrim të personave të riatdhesuar
QEÇM	Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve në Kosovë
QeK	Qeveria e Kosovës
IOM	Organizata ndërkombëtare për migrim
KKR	Komisioni komunal për riinegrim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MOCR	Zyra Komunale për komunitete dhe kthim
ZQM/ZKM	Zyra e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe jo-diskriminim në zyren e Kryeministrit
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAE	Rom, Ashkali dhe Egyptian
Tdh	Terre des hommes
UNICEF	Fondi i kombeve të bashkuara për fëmijë
UNHCR	Komisioneri i lartë i kombeve të bashkuara për refugjatë

Fjalor

Fëmijë: përcaktohet me Konventën e Kombëve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDNj) si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçe, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më parë në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.[1] Ngjashëm, legjislacioni në Kosovë përcakton fëmijës si person nën moshën 18 vjeçare,[2] përveç në rrethana specifike sikurse lidhja e kunorës.[3] Poashtu, disa ligje i referohen fëmijëve të moshës 14-18 si të mitur edhe pse i mituri vazhdon të trajtohet si fëmijë.[4]

Interesi më i lartë i fëmijës: siç përcaktohet në KDF " të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private, të përkrahjes shoqërore, nga Gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi me i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese".[5] Komiteti për të drejtat e fëmijës (Komiteti) ka deklaruar se kjo do të thotë qasje e bazuar në të drejta për të siguruar " integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës" , përderisa merren parasysh karakteristikat specifike të fëmijës.[6] Për sa i përket fëmijëve të zhvendosur, Komiteti ka deklaruar se " parimi [se duhet të përcaktohet interesi më i lartë i fëmijës] duhet të respektohet gjatë të gjitha fazave të ciklit të zhvendosjes. Në cilëndo prej këtyre fazave duhet të dokumentohet përcaktimi i interesit më të lartë gjatë përgatitjes të çfarëdo vendimi i cili do të ketë ketë ndikim thelbësor në jetën e fëmijës të pashoqëruar ose të ndarë'.[7] Ky parim poashtu është i inkorporuar në sistemin ligjor të Kosovës përmes Kushtetutës së Kosovës, e cila siguron se 'të gjitha veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike ose private në lidhje me fëmijët do të bëhen në interesin më të lartë të fëmijëve'.[8] Gjithashtu, legjislacioni relevant siguron se interesi më i lartë i fëmijës do të jetë faktor suprem.[9]

Fëmijët në lëvizje [FnL]: Një prej definicioneve të para të përdorura për fëmijët në lëvizje janë ata fëmijë që lëvizin për një numër arsyesh, në baza vullnetare ose jo-vullnetare, brenda apo

[1] Neni 1, Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Konventa për të drejtat e Fëmijës (CRC), 20 nëntor 1989

[2] Kjo mund të haset në një numër ligjesh si: Ligij për shtetësi – Ligji nr. 04/L-215 (Article 3.1.2), Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit – Ligji nr. 04/L-218 (Neni 2.1.6), Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare – Ligji nr. 02/L-17 (Neni 1.3.g), Ligji mbi arsimin Para-universitar – Ligij nr. 04/L-032 (Neni 2.1.7) dhe Ligji mbi Familjen – Ligji nr. 2004/32 (Neni 3.2)

[3] Ligji mbi Familjen, Neni 15, para. 2-3

[4] Kodi Penal – Ligji nr. 04/L-082 (Neni 120.20 dhe 120.21), Kodi i procedurës penale – Ligji nr. 04/L-123 (Neni 19.1.16 dhe Neni 19.1.17), Kodi penal për të mitur – Ligji nr. 03/L-193 (Neni 2.1.1 dhe Neni 2.1.2)

[5] Neni 3 (1), UNCRC

[6] Komiteti për të drejtat e fëmijës, Komenti i përgjithshëm nr. 14 [2013] për të drejtat e fëmijës dhe interesi i tij/saj të merret si konsideratë primare (art. 3, para. 1), 2013, para. 5 and 48

[7] Komiteti për të drejtat e fëmijës, Komenti i përgjithshëm nr. 6 [2005] Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë shtetit të tyre amë, 2005, para. 19

[8] Neni 50.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

[9] Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare (neni 9.1) – ju lutem veni re se këtu merren parasysh amendamentimet e bëra në 2012 dhe kjo reflektohet në tërë raportin, Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrotjen e viktimave të trafikimit (Neni 28.4, Neni 29.2, Neni 34.1, Neni 37 dhe Neni 38.5)

jashtë shtetit, me apo pa prindërit ose kujdestarët e tyre dhe lëvizja e të cilëve paraqet rrezik për ata (apo e rritë rrezikun) për shfrytëzim ekonomik ose seksual, abuzim, neglizhim dhe dhunë'.[10] Megjithatë, kjo nuk krijon një kategori të re të fëmijëve, në vend të kësaj më mirë të themi se është një term ombrellë që i bashkon të gjithë fëmijët që janë në rrezik, ata që janë i janë ekspozuar abuzimit ose formave të ndryshme të shfrytëzimit. Këtu synohet të kuptohen ngjashmëritë dhe diferencat si dhe të ri-fokusohen intervenimet me mbrojtje të fëmijës që është faktor suprem si dhe të mbështetet ndikimi pozitiv të cilin mund ta ketë lëvizshmëria në përmirësimin e mundësive jetësore të fëmijës. Për këtë shkak ky definicion përfshinë: fëmijët të cilët janë trafikuar, fëmijët të cilët kanë migruar, fëmijët që janë zhvendosur për shkak të konfliktit ose fatkeqësive natyrore dhe fëmijët të cilët punojnë dhe jetojnë në rrugë.

Në ndërkohë, në vitin 2011, Terre des hommes [Tdh] ka adaptuar definicionin i cili i referohet 'fëmijëve të cilët kanë lënë vendbanimin e tyre të zakonshme dhe janë në rrugë drejt destinimit të ri ose tanimë kanë arritur në një destinacion të tillë'. Gjithashtu, 'fëmija [në lëvizje] mund të lëvizë përtej kufirit të shtetit ose brenda shtetit. Ai/ajo mund të jenë në lëvizje vetë ose në grup me anëtarët e familjes, të rritur dhe/ose fëmijë tjerë, të njohur apo panjohur më parë nga fëmija. Për më tepër, mund të bëhet një dallim ndërmjet fëmijëve në lëvizje, bazuar në arsyet prapa asaj lëvizjeje.' Katër kategoritë përfshijnë: fëmijët e zhvendosur brenda shtetit, kërkuesit e azilit ose refugjatët, migrantët (arsyet ekonomike ose ndryshimet klimarike si dhe brenda/jashtë) dhe fëmijët e trafikuar.[11] Për qëllime të këtij raporti, fëmijët në lëvizje përfshijnë: 'fëmijët migrues (brenda ose përtej kufinjve; legal ose ilegal; të shoqëruar apo të vetëm), kërkuesit e azilit dhe fëmijët refugjatë, fëmijët e trafikuar, fëmijët e zhvendosur përbrenda ose fëmijët jashtë mjedisit mbrojtës. Pra fëmijë vetëm se ka lëvizur, mund të jetë poashtu migrues i kthyer, është në lëvizje dhe/ose nën dyshim për migrim të ardhshëm'.[12]

Fëmijët e trafikuar: janë fëmijët që *janë* rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar ose pranuar *përmes* kërcënimeve ose përdorimeve të forcës ose formave tjera të detyrimit , rrëmbimit, mashtrimit, abuzimi të pushtetit ose të pozitës së dobësisë ose përmes dhënies apo pranimit të pagesave apo të mirave me qëllim të arritjes së pranimit të personit që ka kontrollin mbi personin tjetër, *për qëllime shfrytëzimi.* shfrytëzimi, së paku e përfshin prostitucionin e të tjerëve ose forma tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet nga detyrimi, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë, heqjen e organeve.[13] Sipas legjislacionit të Kosovës shfrytëzimi është specifikuar të përfshijë poashtu pornografinë, kërkimin e lëmoshës dhe heqjen e indeve. [14]

[10] Definicioni i përdorur nga Save the Children gjatë një konference ndërkombëtare për Fëmijët në lëvizje në Spanjë , 2010

[11] Dottridge M, 'Çka mund të bëni JU që të mbroni fëmijët në lëvizje – doracak, nëntor 2012, Terre des hommes International Federation, at p. 21-22

[12] Milne B, Mario 'Udhëzimet metodologjike për kërkime dhe konsultime mbi fëmijën ', Projekti Mario 2013

[13] Neni 3.a, Protokoli për parandalim, shuarje dhe dënim të trafikimit të personave, sidomos femrave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të organizuar transnacional, 2000

[14] Neni 171.6.2, Kodi Penal i Kosovës dhe Neni 3.1.8, Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit

Fëmijët e kthyer janë fëmijët të cilët janë kthyer në Kosovë prej një vendi tjetër mikpritës për shkak se Kosova është shteti amë i tyre, shteti amë i prindërve të tyre, ata ose prindërit e tyre kanë pasur vizë apo leje për qëndrim në Kosovë ose kanë qëndruar në Kosovë para se të hyjnë ilegalisht në territorin e shtetit prej të cilit janë kthyer. Brenda kësaj kategorie fëmijët dhe/ose familjet e tyre mund të kenë hyrë në shtetin mikpritës legalisht ose ilegalisht, mund të kenë pasur statusin e refugjatit, mund të kenë pasur mbrojtje shtesë ose forma tjera të mbrojtjes. Në raste kur është është dhënë statusi përkatës, zakonisht ai është tërhequr për shkak të ndërrimit të rrethanave në rastin e tyre përkatës. Gjithashtu, procesi i kthimit mund të ketë qenë vullnetar, spontan ose i detyruar. Duhet të theksohet se legjislacioni nacional i referohet vetëm ripranimit dhe kthimit,[15] përderisa dokumentet tjera nacionale sikurse strategjia nacionale, përmendin personat e riatdhesuar.[16] Përderisa termet "të kthyer" dhe "të riatdhesuar" duken se përdoren si zëvendësime, që ligjërisht, kjo mënyrë nuk është e përshtatshme[17] dhe për qëllime të këtij raporti të gjithë fëmijët që hyjnë në këtë kategori do të referohen si fëmijë të kthyer.

Fëmijët jashtë mjedisit mbrojtës: janë ata fëmijë të cilët nuk kanë kujdesin dhe mbikqyrjen prej prindërve/kujdestarëve të tyre. Për qëllime të këtij raporti, fëmijët në këtë kategori përfshijnë: fëmijët e arratisur, fëmijët e humbur dhe fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu, fëmijët prindërit e të cilëve kanë vdekur apo i kanë lënë ata nën kujdesin e gjyshërve, të cilët nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes të mjaftueshëm hyjnë në këtë kategori e poashtu edhe fëmijët prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes të mjaftueshëm dhe ushqim dhe në raste e detyrojnë fëmijën të kërkojë lëmoshë ose të angazhohet në punë të rrezikshme.

Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve: është 'numër koherent i aksioneve dhe akterëve në të cilat fëmija është pika fillestare dhe synon garantimin e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës duke ndërtuar sinergji brenda dhe ndërmjet mjediseve mbrojtëse.'[18] Këto institucione/akterë të ndryshëm dhe komponentë kanë përgjegjësinë të ndërmarrin masa të koordinuara për të ruajtur mirëqenien e fëmijës dhe për të mbrojtur fëmijën prej të gjitha formave të " dhunës fizike ose

[15] Ligji mbi ripranimin – Ligji nr. 03/L-208 nuk e përdorë fjalën riatdhesuar mirëpo vetëm kthimin ose të kthyerit. [shih Nenin 8, Nenin 9 dhe Nenin 12)

[16] Strategjia Nacionale për riintegrim të personave të riatdhesuar –edhe pse brenda tekstit kryesor duket se i referohet të kthyerve në vend se personave të riatdhesuar, shih faqet 7 deri 11

[17] Riatdhesimi i referohet të drejtës personale të refugjatit ose të burgosurit të luftës për kthim në shtetin e tij amë nën kushte specifike të specifikuara në instrumentet ndërkombëtare (sikurse është Konventa e Gjenevës 1949 dhe Protokoli ndër të tjera). Procesi i kthimit është më i gjerë pasi i referohet kthimit prej shtetit mikpritës në shtetin amë, edhe pse përfshihen persona me statuse të ndryshme duke përfshirë refugjatët, kërkuesit e azilit dhe shtetasit e kualifikuar. Gjithashtu, ripranimi i referohet procesit të pranimit/ri-hyrjes së shtetasve, shtetasve të shtetit të tretë ose personave pa shtetësi të cilët kanë hyrë ilegalisht ose janë present në shtet tjetër. Për informata të mëtejme në lidhje me këto definicione ju lutemi shikoni: Organizata Ndërkombëtare për Migrim, 'Fjalori i migrimit, 2004, faqet: 55 (riatdhesimi), p.56 (kthimi) dhe p. 55 (ripranimi), që gjindet në http://publications.iom.int/bookstore/free/IML_1_EN.pdf paraqitur më 25/03/2014

[18] Feneyrol O, 'Përmirësimi i sistemeve për mbrojtjen e fwmijws', Politika tematike, Terre des hommes – child relief, tetor 2011, p. 6

mentale, lëndimin ose abuzimin, neglizhimin ose trajtimin neglizhent, keqtrajtimin ose shfrytëzimin duke përfshirë abuzimin seksual përderisa nën kujdesin prindëror, kujdestarit ligjor ose ndonjë personi tjetër i cili kujdeset për fëmijës'.[19] Akterët e involvuar përfshijnë familjen, komunitetin dhe agjencitë statutore sikurse janë shërbimet sociale, sistemi arsimor dhe zbatimi i ligjit.

I. Hyrje

Çdo vit, miliona njerëz, duke përfshirë fëmijët, migrojnë për arsye të ndryshme. Gjatë 2013, 232 milion ose 3.2% të popullatës së botës ishin migrues ndërkombëtarë, prej të cilëve 15.1% kishin moshën 0-19 vjeç.[20] Fëmijët mund të migrojnë për një numër arsyesh të ndryshme duke përfshirë ikjen prej abuzimit, varfërisë ose diskriminimit si dhe dëshirën për jetë më të mirë.

Diskutimet mbi lëvizjen globale të fëmijëve kryesisht janë fokusuar në aspektet negative ose kriminale të lëvizjes së fëmijëve, sikurse fëmijët e trafikuar si dhe adaptimi i qasjes " një mase për të gjithë" për sa i përket shfrytëzimit, pa marrë parasysh karakteristikat specifike.[21] Kjo do të thotë se reagimi i sistemeve mbrojtëse të fëmijës nuk ka qenë gjithmonë i mjaftueshëm; pasi që ka dështuar të marrë parasysh karakteristikat specifike dhe nevojat e secilit fëmijë që është në lëvizje. Pra, përkundër një lëvizjeje të tillë të shkallës së madhe ata mbesin të padukshëm. Në të njejten kohë korniza e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) kërkon që aktivitetet e fëmijëve të njihen dhe të festohen që do të thotë se " fëmijët nuk janë dhe kurrë nuk duhet të trajtohen vetëm si viktima të rrethanave mirëpo gjithmonë duhet të trajtohen edhe si agjentë të së ardhmes së tyre.'[22]

Me rrethana të tilla në mendje, projekti Mario është dedikuar të analizojë situatën e fëmijëve në lëvizje (FnL) dhe inkorporimin e qasjes pjesëmarrëse të fëmijës përmes, ashtu siç parashikohet në Udhëzimet metodologjike të projektit Mario për kërkime dhe konsultime për fëmijën (Udhëzimet metodologjike). Kërkimet dhe ky raport në veçanti fokusohet në identifikimin e fëmijëve në lëvizje ose atyre që janë në rrezik në Kosovë, duke përfshirë rrugët e lëvizjes pa marrë parasysh a janë nacionale apo ndërkombëtare, ndjeshmërinë që mund ta shfaqin fëmijët apo të ballafaqohen me të gjatë lëvizjes, si dhe asistencën që u ofrohet atyre fëmijëve. Poashtu, kërkimet përvijojnë sistemin ekzistues të mbrojtjes së fëmijës në Kosovë dhe merr parasysh efikasitetin e tij në ofrimin e mbrojtjes për FnL duke u fokusuar në atë nëse është efektiv, gjithëpërfshirës, i arritshëm dhe adekuat.

---

[19] Neni 19.1, CRC

[20] Kombet e Bashkuara, Departamenti për ekonomi dhe çështje sociale, Ndarja e popullatës, 'Migrimi ndërkombëtar 2013', mund të gjindet në http://esa.un.org/unmigration/documents/WallChart2013.pdf paraqitur më 25/03/2014

[21] Reale D, Fondi i Save the Children, 'Larg nga shtëpia – Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje, 2008, f. 1-2

[22] Deklaratë hyrëse e Reporterit Special të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut për migrues, Profesor François Crépeau, publikuar me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim 'Children on the Move', 2013, f.2 që mund të gjindet në http://publications.iom.int/bookstore/free/Children_on_the_Move_15May.pdf paraqitur më 25/04/2014

Pjesa e parë e raportit pas hyrjes, shtjellon metodologjinë që është përdorur gjatë këtij kërkimi si dhe ofron informata relevante në kontekst të Kosovës, kornizën legjislative dhe sistemin ekzistues për mbrojtjen e fëmijëve. Ndërsa, pjesa e dytë e raportit shqyrton se kush janë FnL në Kosovë dhe reagimin e sistemit për mbrojtjen e fëmijës ndaj nevojave dhe ndjeshmërisë së tyre para konkludimit dhe rekomandimeve.

II. Metodologjia

Në përputhje me Udhëzimet Metodologjike, janë përdorur metodat kërkimore si vijojnë:

a. Kërkimet sekondare;
b. Intervistat gjysmë të strukturuara me FnL dhe partnerët;
c. Vrojtimi dhe
d. Diskutime të hapura në grup.

Mostra e kërkimit ka përfshirë 47 fëmijë që ishin në rrezik në lëvizje ose në të kaluarën e afërt janë involvuar në aktivitete që përputhen me definicionin e FnL. Përderisa mostra është relativisht e vogël, ajo korrespondon me atë që specifikohet në Udhëzimet Metodologjike të më së paku 20 fëmijëve.[23] Përveç kësaj, fëmijet kanë marrë pjesë në mënyra të ndryshme duke përfshirë intervistat e gjysmë-strukturuara, diskutimet e hapura në grup dhe hulumtuesin "S' të involvuar në vrojtim. Mostra e kërkimit për persona përgjegjës/ partner përfshinë totalin prej 20 profesionistëve prej institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organizatave jo-qeveritare. Përderisa kjo mostër shkon përtej asaj që specifikohet në Udhëzimet Metodologjike ka qenë e domosdoshme të përfshihet një gamë e personave përgjegjës/ partnerëve për shkak të decentralizimit të kompetencave në këtë fushë dhe inputeve të vlefshme që mund të ofronin ata kur e vlerësojnë situatën e FnL. Për të siguruar se fëmijët pjesëmarrës në këtë kërkim nuk do të dëmtohen në ndonjë mënyrë, për të minimizuar rrezikun e identifikimit që do të rezultonte me dëm potencial, si masë mbrojtëse janë ndryshuar detajet specifike sikurse janë inicialet e fëmijëve dhe lokacionet e tyre.

a. Kërkimet sekondare

Si hap i parë, janë bërë kërkime ekstenzive sekondare me qëllim të identifikimit të legjislacionit relevant, strategjive dhe planeve të veprimit që synojnë FnL në mënyrë direkte ose indirekte. Në përputhje me cakun kryesor të këtij raporti për të vlerësuar situatën e FnL në Kosovë, fokusi ka qenë në kontekstin nacional me referenca të kufizuara në kornizën ndërkombëtare përveç sa i përket standardeve ndërkombëtare të aplikueshme relevante.

[23] Milne B, Mario 'Udhëzimet metodologjike për kërkime dhe konsultime për fëmijë', Projekti Mario 2013, f. 12

Gjatë kësaj faze, janë rishikuar një numër dokumentesh prej burimeve të shumta duke përfshirë Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), Save the Children, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM),Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyren për Qeverisje të Mirë në Zyren e Kryeministrit (ZQM/ZKM). Kërkimet sekondare kanë shpalosur se brenda kontekstit nacional, situata e FnL nuk është adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse në kërkim. Në të njejtën kohë për shkak të rritjes së numrit të të kthyerve, duke përfshirë edhe fëmijët të cilët hyjnë në definicionin e FnL kjo çështje është adresuar në raporte të ndryshme.[24]

b. Intervistat gjysmë të strukturuara me FnL dhe personat përgjegjës

Në përputhje me definicionin e FnL, fëmijët e kategorive në vijim janë involvuar në intervistat gjysmë të strukturuara:

- *Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës* (të cilët kanë jetuar me prindërit e tyre në kushte të mjerueshme dhe shpeshherë për shkak të kushteve të tilla janë detyruar të punojnë ose të kërkojnë lëmoshë në rrugë);
- *Fëmijët e kthyer (emigrant)*[25]

Të gjitha intervistat janë zhvilluar individualisht në lokacione të ndryshme në tërë Kosovën duke i përfshirë rajonet/ qytetet ku ka pasur fëmijë që hynin në kategoritë specifike të FnL. Prindërit kanë marrë detaje të kërkimit dhe miratimi për të intervistuar fëmijën që është dhënë gojarisht. Zakonisht, intervistat janë zhvilluar në një vend të qetë ku fëmija ka mundur të komunikojë lirisht me hulumtuesin. Në fillim të intervistës gjysëm të strukturuar hulumtuesi ka shpjeguar fokusin e kërkimit për secilin fëmijë dhe i ka dhënë fëmijës mundësinë të refuzojë pjesëmarrjen ose mundësinë të ndërpresë intervistën në çdo kohë gjatë inervistës së gjysëm-strukturuar. Gjithashtu, hulumtuesi ka shpjeguar se të gjitha informatat e siguruara për qëllime të këtij kërkimi do të mbeten anonime dhe ka siguruar se janë ndërmarrë masa të domosdoshme me qëllim të parandalimit të ndonjë dëmi të shkaktuar për fëmijën prej këtij kërkimi.

[24] Ju lutemi shihni raportet në vijim: Knaus V, UNICEF Kosovë, 'Asnjë vend që mund të quhet shtëpi – riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë siç shihet dhe përjetohet nga fëmijët Rom, Ashkali dhe Egjiptas', 2011;
Këshilli Europian për Refugjatë dhe ekzil në partneritet me Save the Children (Zyra e BE-së), 'Studim krahasues për praktikat në lëmin e kthimit të të miturve', HOME/2009/RFXXPR/1002, dhjetor 2011;
Romani LP, Qendra Evropiane për Cështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosovë), 'Procesi i riatdhesimit në Kosovë- organizata institucoinale, korniza ligjore, mësimet e nxjerra dhe sfidat e mbetura', dhjetor 2013

[25] Gjatë kërkimit është vendosur të fokusohemi në kategoritë e lartpërmendura për shkak të numrit të madh të rasteve. Brenda të intervistuarve mund të ketë pasur të trafikuar mirëpo nuk janë identifikuar të tillë edhe pse është përdorur vrojtimi.

Zhvillimi i këtyre intervistave gjysëm të strukturuara ndonjëherë ishte sfiduese për shkak të vështirësive gjuhësore sidomos pë rata fëmijë që i përkisnin minoriteteve nacionale sikurse janë fëmijët prej komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve. Ngjashëm, me fëmijët e kthyer të të gjitha komuniteteve kjo ishte sfiduese pasi shumë prej tyre kishin njohuri të kufizuara apo asnjë njohuri të gjuhëve zyrtare të Kosovës. Si rezultat hulumtuesi ka treguar një kujdes më të madh kur ka punuar me këta fëmijë me qëllim të shpjegimit të pyetjeve dhe ka përdorur gjuhë tjera kur ka qenë e mundur.

Në tërësi, me zhvillimin e intervistave gjysëm të strukturuara për sa i përket çështjeve etike dhe Udhëzimeve Metodologjike, informatat e fituara krijojnë një pasqyrë të asaj se si këta fëmijë e shohin fenomenin e FnL në nivel nacional, pa marrë parasysh a e shohin ata vehten si pjesë të këtij grupi apo kur kemi të bëjmë më raste kur ata dëshirojnë të kenë pranuar asistencën.

Një komponentë tjetër e rëndësishme e kërkimit ishin intervistat gjysëm të strukturuara me partner. Në përputhje me Udhëzimet Metodologjike partnerët ishin selektuar me kujdes me qëllim që të përfshihen të gjithë ata profesionistë të cilët kanë përgjegjësi primare për t'i ofruar shërbime FnL si dhe akterët jo-shtetëror sikurse janë organizatat ndërkombëtare dhe jo-qeveritare (OJQ). Profesionistët që janë intervistuar për këtë kërkim kanë përfshirë:

- Punëtorët social prej Qendrave të ndryshme për Punë Sociale në tërë Kosovën;
- Zyrtarët policor (duke përfshirë Policinë në komunitet dhe Njësinë kundër trafikimit;
- Drejtorin e Qendrës pranuese për azil;
- Zyrtarin e komuniteteve dhe kthimit në nivel komunal);
- Përfaqësuesit e strehimoreve për viktima të trafikimit dhe
- Përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve lokale duke përfshirë (UNICEF-in, Ideas Partnership dhe Terre des hommes Kosovë).

Të gjitha intervistat janë zhvilluar sy më sy, zakonisht në zyret e tyre dhe në përgjithësi tërë të intervistuarit ishin entuziastë dhe bashkëpunues, të gatshëm për të siguruar sa më tepër detaje rreth punës së tyre dhe mënyrës se si ndërlidhet ajo me FnL. Përderisa inputi i tyre siguron një pasqyrë të rëndësishme rreth FnL në Kosovë dhe mënyrën se si reagon sistemi mbrojtës ndaj ndjeshmërisë dhe nevojave të tyre, shumë prej tyre kanë pranuar se ka sfida të shumta në sistem, që e parandalojnë atë prej të qenit efektiv, gjithëpërfshirës, i arritshëm dhe proaktiv për sa i përket FnL.

c. Vrojtimi

Për shkak të një problemi të dukshëm të shfaqur në Kosovë me fëmijët e angazhuar në kërkim lëmoshe në rrugë, për shkak të rrethanave të vështira ekonomike në shtëpi ose thjeshtë të shtyer për të kërkuar lëmoshë nga ana e prindit/ kujdestarit ose ndonjë të rrituri tjetër, vrojtimi është përdorur si një metodë tjetër e kërkimit. Ky aspekt i kërkimit është zhvilluar prej një hulumtuesi

të rritur, një asistenti të hulumtuesit dhe një hulumtuesi fëmijë. Hulumtuesi fëmijë ishte 'S', një djalosh 13 vjeç i përkatësisë Rome, i cili më parë grumbullonte kanaqe dhe metale si dhe kërkonte lëmoshë.

Para se të fillonte vrojtimi, hulumtuesi i rritur dhe hulumtuesi fëmijë kanë shënuar në hartë hapësirat që do të ishin më relevante për vrojtim, si dhe kanë diskutuar për metodat që do të përdoreshin në përputhje me Udhëzimet Metodologjike, duke siguruar se vrojtimi do të bëhej në mënyrë jo-ndërhyrëse dhe jo-intervenuese. Gjatë vrojtimit hulumtuesi i rritur ka punuar bashkarisht me hulumtuesin fëmijë duke diskutuar rreth gjithçka është vrojtuar dhe hulumtuesi i rritur ka regjistruar të gjitha të dhënat, duke siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve.

Vrojtimi është bërë në Prishtinë, në një numër lokacionesh, që janë selektuar me kujdes, ku ka pasur të rritur me fëmijë që kërkonin lëmoshë, fëmijë që kërkonin lëmoshë vetëm ose fëmijë që punonin në rrugë si pastrues të xhamave të makinave në udhëkryqe. Ekipi kërkimor ka punuar shumë mirë së bashku dhe kjo komponentë ka dhënë edhe rezultate të rëndësishme me qëllim të dokumentimit se çka po ndodhë me fëmijët jashtë një mjedisi mbrojtës dhe fëmijët potencialisht të trafikuar. Përderisa nuk mund t'i qaseshin fëmijëve që vrojtoheshin, të dhënat e regjistruara janë të rëndësishme pasi që në to paraqitet perspektiva e fëmijës. Përveç kësaj pasi që paraprakisht kishte kërkuar lëmoshë në rrugë 'S' ishte në gjendje të sigurojë një vision shumë të rëndësishëm për sa i përket lokacioneve, fëmijëve dhe ndjeshmërive të tyre si dhe reagimeve të të rriturve në afërsi. Për këtë shkak involvimi i S ka shtuar vlerë të madhe pasi që përveç pjesëmarrjes së mundësuar të fëmijëve, 'S' ka diskutuar me të rriturit ndjeshmëritë e ndryshme që ata nuk i kanë vërejtur.

d. Diskutime të hapura në grup

Diskutimet e hapura në grup kanë përfshirë pjesëmarrjen e 8 fëmijëve jashtë mjedisit mbrojtës të moshës prej 9-13 (7 djem dhe 1 vajzë) të angazhuar në diskutime për 20 minuta të mbajtur në ambient privat. Ky aktivitet është drejtuar prej një hulumtuesi të rritur dhe tema kryesore e diskutimit ishte vetëdijësimi i përgjithshëm i fëmijëve për shërbimet që u ofrohen atyre. Përkundër përpjekjeve të hulumtuesit për ta bërë atë mjedis sa më miqësor, 4 prej fëmijëve kanë qenë shumë të strukur, të tërhequr dhe hezitonin të angazhoheshin, kohë pas kohe flisnin shumë pak rreth temës së diskutimit ose nuk thonin asgjë. Përmes diskutimeve të hapura në grup, fëmijët janë konsultuar dhe disa prej përgjigjeve kanë dhënë një pasqyrë më të plotë rreth vetëdijësimit dhe pikëpamjeve të fëmijëve për sa i përket shërbimeve mbrojtëse të fëmijëve. Pasi përshtatshmëria e shërbimeve të tilla është një aspekt i rëndësishëm i këtij kërkimi, pikëpamjet e tyre janë tejet të rëndësishme sepse shumica e fëmijëve të konsultuar ishin jashtë mjedisit mbrojtës dhe efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve kishte rëndësi thelbësore.

III. Konteksti

Kosova është shtet relativisht i ri, që ka deklaruar pavarësinë unanimisht në vitin 2008 dhe në këtë mënyrë ende është në proces të ndërtimit të shtetit ku institucione të ndryshme po konsolidohen dhe po ngriten kapacitete me asistencën e komunitetit ndërkombëtar dhe organizatave ndërkombëtare prezente. Sipas regjistrimit të fundit të popullatës në 2011, Kosova ka popullsinë prej 1,739,825 të cilët jetojnë në 297,090 shtëpi, 592, 046 janë fëmijë nën moshën 18.[26] Për sa i përket FnL, ka nevojë të merret parasysh një numër çështjesh që përveç të kuptuarit të arsyeve të lëvizjes së tyre të ofrohet asistencë bazuar në nevojat e tyre.

Rrethanat ekonomike në Kosovë kanë ndikim direkt në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të saj e sidomos fëmijëve. Sipas statistikave nacionale papunësia në Kosovë mbetet e lartë me rreth 30% të popullatës aktive, edhe pse rinia që përfshinë fëmijët është në veçanti e prekur me 55.3% të 15-24 vjeçarëve të papunësuar.[27] Gjithashtu, Kosovarët që jetojnë në varfëri mbesin me përqindje të lartë prej 29.7% dhe 10.2% që jetojnë në varfëri të skajshme. Një numër i familjeve varen prej asistencës sociale dhe gjatë 2012/2013 statistikat e familjeve që përfitonin kanë ndryshuar prej 29,425 deri në 31,740 me shumicën e familjeve që ndodheshin në Prishtinë.[28]

Në ndërkohë, arsimi është një prej të drejtave të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës. Megjithatë, vijimi jo i rregullt ose braktisja e shkollës ka efekt jo vetëm në zhvillimin e fëmijës mirëpo gjithashtu mund ta vëjë fëmijën në situata të ndryshme duke vënë në rrezik mirëqenien e tij/saj përmes detyrimit për të punuar ose kërkuar lëmoshë, përmes kryerjes së punëve të rrezikshme e edhe trafikimit. Edhe pse është raportuar se ka pasur përmirësime në vijimin e shkollës nga të gjitha komunitetet, statistikat e tilla shihen si të paqëndrueshme për shkak të një sistemi të papërshtatshëm monitorues.[29] Për sa i përket mbrojtjes, shërbimet janë të disponueshme në nivel lokal brenda secilës komunë përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS) edhe pse siç detajon ky raport ky shërbim nuk ka shtrirje të mjaftueshme që do të thotë se FnL dhe familjet e tyre mund të mos jenë në dijeni për shërbime të tilla , mënyrën se si t'i qasen atyre dhe procedurat e aplikimit mund të jenë të rënda.

Për këtë shkak, në këtë kontekst është më se me rëndësi që situata të shqyrtohet në lidhje me FnL. Së pari, fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës janë një kategori shumë e gjerë edhe ose nuk ka kërkime gjithëpërfshirëse ose të dhëna për fëmijët e kësaj kategorie duke u fokusuar në atë se çfarë veprime janë ndërmarrë nga përgjegjësit dhe cilat janë trendet me qëllim të planifikimit të intervenimeve në të ardhmen dhe për të reaguar me përshtatshmëri ndaj nevojave të tyre.

---

[26] Agjensioni i Kosovës për Statistika, Rezultatet e regjistrimit 2011, që mund të gjinden në http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/daëinciMD.jsp?a1=yC&a2=uF0&n=1UR906$$$$$04&o=&v=1UR060DS00V70000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0 paraqitur më 10/05/2014

[27] Agjensioni i Kosovës për Statistika, 'Anketim i fuqisë punëtore në Kosovë – Rezultatet e 2013', që mund të gjinden në http://ask.rks-gov.net/publikimet/doc_view/1131-rezultatet-e-anketaeumls-saeuml-fuqisaeuml-punaeumltore-2013-naeuml-kosovaeuml?tmpl=component&format=raë paraqitur më 10/05/2014

[28] Agjensioni i Kosovës për Statistika, 'Statistikat e Mirëqenies Sociale, 2013, f. 31 që mund të gjinden në http://ask.rks-gov.net/statistikat-e-mireqenies-/publikimet/doc_view/1092-statistikat-e-miraeumlqenjes-sociale-2013?tmpl=component&format=raë paraqitur më 10/05/2014

[29] Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 'Gjurmimi i braktisjes së shkollës dhe mos-vijueshmërisë në Kosovë" shtator 2012, gjindet në http://www.osce.org/kosovo/95112?doënload=true paraqitur më 10/05/2014

Për sa i përket trafikimit situata ndryshon për shkak të raporteve ndërkombëtare që dokumentojnë trendet dhe cilët janë viktimat e trafikimit. Në këtë aspekt, Kosova është gjetur të jetë burimi dhe vendi i destinimit për fëmijët dhe gratë që janë subjekt i trafikimit seksual dhe punës së detyruar me forcë. Në lidhje me fëmijët, kemi kuptuar se fëmijët nga Kosova dhe shtetet fqinje janë subjekt i detyrimit me forcë për kërkim lëmoshe, përderisa trafikuesit i detyrojnë qytetarët e Kosovës të punojnë dhe i shtyejnë drejt prostitucionit gjithandej Evropës[30]. Përpjekje janë bërë për luftim të trafikimit, për shembull paraqitja e Kodit të ri Penal që rritë penalizimet për trafikues. Gjatë 2012, ishin rreth 104 trafikime të reja dhe Gjykatat kanë filluar të merren me 31 raste, në krahasim me 22 rastet e vitit 2011.[31] Gjithashtu, në 2013, Qeveria e Kosovës ka miratuar ligjin e ri për Parandalimin dhe Luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit[32] dhe strategjia e re po finalizohet nga Koordinatori i Anti Trafikimit. Megjithatë problemet kanë vazhduar sidomos me kompleksitetin brenda Policisë si dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale[33] dhe identifikimi i viktimave fëmijë mbetet i vogël.

Një konsideratë tjetër e rëndësishme i është bërë situatës së të kthyerve, pasi që një numër i madh i njerëzve (qytetarët Kosovarë ose tjerë) janë kthyer gjatë 4 viteve të fundit me forcë ose në mënyrë vullnetare prej shteteve të ndryshme të Unionit Evropian duke përfshirë edhe fëmijët. Ndërmjet viteve 2010 dhe 2013[34] në total janë kthyer 15,934 personash, me numrin më të lartë në 2010, në total 5,198. Prej këtij totali të përgjithshëm të të kthyerve gjatë kësaj periudhe, 3,048 janë fëmijë të moshës 0-17 vjeç, edhe pse nuk është representative për të gjithë fëmijët e kthyer, pasi ata që janë 17-18 vjeç nuk janë të përfshirë në këtë statistikë. Gjithashtu është më se e rëndësishme të theksojmë se gjatë kësaj periudhe pjesa më e madhe e të kthyerve janë detyruar me forcë, diku me total prej 10,194 përkundër vetëm 5,740 të të kthyerve në baza vullnetare. [35] Ky process, pa dyshim se ka efekt negativ në fëmijët prej hapave fillestarë kur ndërmerren prej shtetit mikpritës, që mund të jetë edhe më i dëmshëm kur detyrohen me largim. Edhe pse kjo vazhdon deri tek situata në të cilën fëmijët e gjejnë vehten kur kthehen siç është dokumentuar më parë[36] dhe ashtu siç e përshkruajnë fëmijët në këtë kërkim.

---

[30] Departamenti i Shteteve të Bashkuara, 'Raport mbi trafikimin e njerëzve, 2013, në f..244, gjindet në http://www.state.gov/documents/organization/210740.pdf paraqitur më 10/05/2014

[31] Ibid

[32] Ligji nr. 04/L-218

[33] Departamenti i Shteteve të Bashkuara, 'Raport mbi trafikimin e njerëzve, 2013, në f.244, gjindet në http://www.state.gov/documents/organization/210740.pdf paraqitur më 10/05/2014

[34] 6 muajt e parë të 2013

[35] Strategjia Nacionale për Riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë (Strategjia Nacionale për riintegrim), tetor 2013, në f. 11

[36] Knaus V, UNICEF Kosovë, 'Dëmi pa zë – Raport mbi vlerësimin e situatës së shëndetit psiko-social të fëmijëve të riatdhesuar', mars 2012, gjindet në http://www.unicef.org/kosovoprogramme/SILENT_HARM_Eng_Ëeb.pdf paraqitur më 10/05/2014

IV. Korniza ligjore dhe politike në Kosovë

Përderisa fëmijët kanë qenë pjesë e rrjedhës së migrimit për vite të tëra, sistemet ligjore ndërkombëtare dhe nacionale nuk i kanë kushtuar ndonjë vëmendje të veçantë situatës së tyre ose ndjeshmërive. Vetëm në vitin 2010 është mbajtur konferenca e parë ndërkombëtare për të diskutuar fenomenin e fëmijëve në lëvizje, ku është diskutuar mbi konceptin.[37] Si rezultat, dekada e fundit është përdorur prej OJQ-ve përkatëse për të tërhequr vëmendjen në këtë çështje përmes lobimit dhe rritjes së vetëdijësimit në nivel ndërkombëtar dhe nacional. Megjithatë, siç duket prej definicionit këtu grupohen fëmijët që janë në lëvizje për arsye të ndryshme duke përfshirë ata që lëvizin në mënyrë vullnetare ose jo-vullnetare, përbrenda shtetit apo jashtë tij. Për këtë shkak, FnL mbetet një term ombrellë që nuk reflektohet në legjislacionin vendor apo në standardet ndërkombëtare dhe si i tillë duhet të konsiderojë dispozitat që synojnë kategoritë specifike të fëmijëve që hyjnë në këtë definicion ashtu që të vlerësojnë nëse sistemet nacionale ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për FnL.

a. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës si instrument i cili formëson sistemin ligjor parasheh zbatim të drejtpërdrejtë të një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë KDF-në. Përpos kësaj, në rastet kur ekziston mospërputhje ndërmjet normave nacionale ligjore me ato të nivelit ndërkombëtar, mbizotërojnë ato ndërkombëtare.[38] Gjithashtu, në raste kur ka kundërshti ndërmjet normave nacionale ligjore me ato të deklaruara në nivel ndërkombëtar, janë normat ndërkombëtare ato që kanë epërsinë dhe përparësinë. Kjo është më se e rëndësishme për FnL pasi që KDF specifikon një numër parimesh të rëndësishme që janë direkt me atë që deklarohet në KDF, në këto raste epërsinë e ka e dyta. Pra, përkundër faktit se nuk ka lidhje shtetërore palësh me KDF, Kushtetuta krijon bazën ligjore për implementimin e saj që shkon përtej zotimit politik. Poashtu, pasi Kosova nuk është palë në Konventë, aktualisht nuk ka ndonjë proces të vazhdueshëm të raportimit apo monitorimit të implementimit të KDF si dhe pamundësinë e individëve për të dorëzuar ankesa tek Komisioni për të drejta të fëmijëve. Megjithatë, procedurat mund të iniciohen brenda sistemit ligjor nacional duke përfshirë edhe Institucionin e

[37] Lëvizja globale e fëmijëve 2010, 'Konferenca ndërkombëtare për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve në lëvizje' 5-7 tetor 2010, Barcelonë, Përmbledhja ekzekutive gjindet në http://www.gmfc.org/images/pdf/com_executive%20summary.pdf dhe http://www.gmfc.org/images/pdf/leavinghome.pdf paraqitur më 25/03/2014

[38] Neni 22, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ombudspersonit[39] dhe gjykatat vendore duke deklaruar se dispozitat e KDF janë shkelur e poashtu edhe shkeljet e pretenduara kushtetuese para Gjykatës Kushtetuese.[40]

Një prej parimeve kyçe të artikuluara në KDF është se palët shtetërore do të respektojnë dhe sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nën juridiksionin e tyre pa ndonjë diskriminim. Komiteti ka shpjeguar se kjo duhet të interpretohet ashtu që të drejtat e dhëna në KDF duhet të gëzohen prej të gjithë fëmijëve brenda juridiksionit të Shtetit që do të thotë se jo vetëm qytetarët janë në pyetje. Si e tillë ajo do të përfshijë FnL si p.sh. 'fëmijët që kërkojnë azil, fëmijët refugjatë dhe emigrant pa marrë parasysh përkatësinë e tyre nacionale, statusin e migrimit apo mungesën e shtetësisë.[41] Një tjetër parim thelbësor i respektimit të fëmijës dhe sigurimit të mbrojtjes sipas KDF është se palët shtetërore në të gjitha veprimet duhet të sigurojnë qasjen e përqendruar tek fëmija ku " interesi më i lartë i fëmijës është konsideratë primare" .[42] Më tej, KDF gjithashtu siguron mbrojtjen specifike të cilën shteti është i obliguar ta sigurojë për fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit familjar si dhe fëmijët e pashoqëruar që janë refugjatë ose kërkojnë azil.[43]

Kapitulli II i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron një numër të drejtash të njeriut sikurse është e drejta për arsimim[44] dhe ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar me forcë duke përfshirë këtu edhe trafikimin.[45] Megjithatë, një aspekt tjetër i rëndësishëm është se në veçanti i njeh të drejtat e fëmijëve sit ë drejta kushtetuese.[46] Këtu përfshihet e drejta për mbrojtjen dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e tyre.[47] Gjithashtu sigurohet e drejta për çco fëmijë që duhet të mbrohet prej dhunës, keqtrajtimit dhe shfrytëzimi e poashtu deklaron se të gjitha veprimet e ndërmarra do të jenë në interesim më të lartë të fëmijës.[48] Përderisa shumë prej këtyre të drejtave janë të përcaktuara në vija të përgjithshme, vihet në pyetje aplikimi i tyre për të gjithë fëmijët, përfshirë FnL, sidomos pasi që urdhëri kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimin e jo-diskriminimit[49] dhe askush nuk do të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës përkatësisë nacionale apo sociale.[50]

Gjithashtu, pamundësia e Kosovës për t'ju bashkëngjitur organizatave joqeveritare sikurse Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës si dhe Organizata ndërkombëtare e punës e parandalon atë prej inkorporimit formal të standardeve ndërkombëtare shtesë në sistemin e saj ligjor, gjë që

[39] Neni 15.1 dhe Neni 15.4, Ligji mbi Ombudspersonin, Ligji nr. 03/L-195
[40] Neni 113.7, Kushtetuta e Republikës së Kosovës
[41] Komiteti për të drejta të fwmijws, Komenti i përgjithshëm nr. 6 [2005] Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë shtetit të tyre amë , 2005 në f..12
[42] Neni 3, UNCRC
[43] Neni 20 dhe 22, UNCRC
[44] Neni 47, Kushtetuta e Republikës së Kosovës
[45] Neni 28, Ibid
[46] Neni 50, Ibid
[47] Neni 50.1, ibid
[48] Neni 50.3 dhe Neni 50.4
[49] Neni 7, Ibid
[50] Neni 24.2 Ibid

do të mund të siguronte një mbrojtje specifike për FnL. Megjithatë, është e rëndësishme të pranojmë se shumë ligje nacionale janë zhvilluar duke marrë parasysh standardet e tilla përfshirë ato ligje që janë përmendur më poshtë. Këtu përfshihen instrumentet sikurse Protokoli Opsional për Konventën e të drejtave të fëmijës për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve,[51] Konventën e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual,[52] si dhe Konventa ILO nr. 138[53] dhe nr. 182.[54]

b. Legjislacioni i shërbimeve dhe asistencës sociale

i. Shërbimet sociale dhe familjare

Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare[55] rregullon kujdesin social që autoritetet në Kosovë janë të obliguara ta sigurojnë për personat dhe familjet në nevojë. Këtu përfshihet kujdesi i drejtëpërdrejtë social ku hyn konsultimi e në rrethana të jashtëzakonshme edhe asistenca materiale [56] për çdo person të gjetur në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh statusin ose vendin e origjinës.[57] Përderisa në ligj personi në nevojë përfshinë një gamë të tërë të kategorive të personave (të rritur dhe fëmijë), për qëllime të këtij raporti ata më relevant janë fëmijë pa kujdes prindëror, persona të cilët janë të pambrojtur ndaj shfrytëzimit ose abuzimit, fëmijët e trafikuar ose fëmijët të cilët për shkaqe tjera konsiderohen si fëmijë në nevojë.[58] Gjithashtu shërbimet do t'i ofrohen fëmijëve në rrethana kur prindërit e tyre ose kujdestarët për shkak të arsyeve të ndryshme[59] kanë vështirësi në sigurimin e kujdesit adekuat dhe mbikëqyrjes.[60]

Shërbimet e tilla duhet të sigurohen në bashkëpunim me partnerët tjerë bazuar në vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe aftësinë e Komunës për t'i ofruar ato shërbime,[61] edhe pse në të gjitha rastet, është interesi më i lartë i fëmijës që do të merret parasysh i pari dhe do të ketë epërsi.[62] Gjithashtu, Qendra për Punë Sociale (QPS) e ka obligim të mirëmbajë regjistrin e të gjithë fëmijëve brenda territorit të vet të cilët nuk kanë kujdes të duhur dhe mbrojtje ose janë në rrezik

[51] Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, 20 maj 2000
[52] CETS nr. 201, 25 tetor 2007
[53] C138, Konventa mbi moshën minimale (nr. 138), Konventa mbi moshën minimale për punësim, 19 qershor 1976
[54] C182, Format më të rënda të punës së fwmijws (No. 182), Konventa për ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminim të formave më të këqia të punës së fëmijës, 19 nëntor 2000
[55] Ligji nr. 02/L-17
[56] Neni 1.1.3.b, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare
[57] Neni 1.1.3.e, Ibid
[58] Ibid
[59] Këtu përfshihen: stili i jetesës,paaftësia fizike ose mentale ose sëmundja, problemet psiko-sociale, varësia ose arsye tjera
[60] Neni 9.3.b, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare
[61] Neni 9.2, Ibid
[62] Neni 9.1, ibid

prej neglizhencës, shfrytëzimit ose abuzimit; me qëllim të realizimit të vizitave të rregullta për të siguruar mirëqenien e fëmijës dhe për të siguruar shërbimet që mund të jenë të domosdoshme.[63]

Pasi që definicioni i fëmijës në nevojë është i gjerë, është më se evidente se të gjitha kategoritë e FnL janë të përfshira, edhe nëse nuk janë specifikuar në veçanti si fëmijë azilantë ose fëmijë të kthyer. Kjo ndodhë për shkak se lista nuk është shumë e gjatë dhe çdo fëmijë që është i mitur i pashoqëruar që kërkon azil ose për shembull është fëmijë i kthyer, ai prapë do të hynte brenda definicionit të fëmijës në nevojë për shkak të arsyeve tjera siç përcaktohet me nenin 9.1.3.e.14 të Ligjit mbi shërbimet për fëmijë e familje. Gjithashtu, përfshirja e parimit të interesit më të lartë të fëmijës është me rëndësi kur përcaktohet nëse fëmija kërkon shërbime dhe çfarë shërbime duhet të sigurohen.

Megjithatë, obligimi i Komunës për të reduktuar shërbimet e tilla për fëmijët në nevojë është paksa i paqartë. Kjo ndodhë për shkak se neni 9.2 i Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare specifikon këtë si obligim të përbashkët të një numri partnerësh, gjë që në praktikë mund të shkaktojë problem rreth asaj se kush çfarë shërbime do të ofrojë. Me qëllim të sigurimit të obligimeve specifike, përgjegjësitë e institucioneve përkatëse duhet të përcaktohen qartë dhe opsioni i kërkimit të asistencës prej partnerëve tjerë duhet të pranohet si një opsion i mundshëm. Gjithashtu, përderisa obligimi fillon me vlerësimin e nevojave të fëmijës, aftësia e Komunës për të ofruar shërbime të tilla duket të jetë një konsideratë e rëndësishme, gjë që mund të ndikojë dhe interesi më i lartë i fëmijës mund të duket jorelevant.

Një brengë tjetër e rëndësishme e që mund të mos i shërbejë mirë FnL është regjistri i mirëmbajtur prej Qendrës për Punë Sociale, për fëmijët që janë në nevojë për shkak të mungesës së kujdesit apo mbikëqyrjes që u shkakton atyre rrezik të neglizhencës, shfrytëzimit ose abuzimit. Sipas nenit 9.4 të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, ky është regjistri i fëmijëve që janë banorë brenda asaj komune specifike. Edhe pse neni 1.1.3.e i të njejtit Ligj thotë se statusi i personit ose origjina është jo-relevante, nëse kriteri për përfshirje në regjistër është rezidenca, atëherë kjo mund ta përjashtojë FnL dhe ta lë atë pa mbrojtje të mjaftueshme, sikurse do të ishin fëmijët e trafikuar apo fëmijët emigrant jo të rregullt. Në këtë aspekt, është e dukshme se rezidenca në Gjuhën Angleze i referohet prezencës fizike dhe ky interpretim duhet të përdoret. Megjithatë, në Gjuhën Shqipe kjo dispozitë thotë fëmijët që jetojnë në territorin e komunës dhe duket se në praktikë aplikohet e njejta, që do të thotë se FnL mund të përjashtohet duke përfshirë këtu edhe fëmijët të cilët kërkojnë lëmoshë.

Një dispozitë tjetër e rëndësishme është se nëse fëmijët vihen nën vëmendjen e Qendrës për Punë Sociale dhe ata kanë arsye të besojnë se fëmija resident ose ai i cili është gjetur në territorin e tyre është nën rrezik ose vuan prej ndonjë forme të dhunës fizike ose mentale, lëndimi, abuzimi, neglizhence ose shfrytëzimi, Qendra për Punë Sociale duhet të ndërmarrë çfarëdo hapi të domosdoshëm për të mbrojtur atë fëmijë.[64] Gjtihashtu, Qendra për Punë Sociale do të raportojë rastin tek departamenti relevant dhe brenda 24 orësh do të zhvillojë një vlerësim gjithëpërfshirës

[63] Neni 9.4, Ibid

[64] Neni 10.7, Ligji për shërbime sociale e familjare

profesional të nevojës së fëmijës për mbrojtje.[65] Përderisa një dispozitë e tillë mbulon një situatë specifike, mbrojtja adekuate e FnL vihet në pyetje, pasi që është ndërtuar për ato raste ku nevojitet veprimi emergjent, e nuk mendohet për këto çështje në baza permanente dhe të përfshihen në regjistër. Një brengë tjetër, të cilën nuk e trajton Ligji për shërbime sociale dhe familjare është skenari kur fëmijët lëvizin prej një komune në tjetrën gjatë një dite apo një jave. Në raste të tilla, nëse aplikohen kërkesa për rezidencë atëherë prapë kjo do të kishe efekt në identifikimin e atyre fëmijëve në rrezik si dhe do të kishe ndikim në qasjen ndaj shërbimeve të domosdoshme për mbrojtjen e tyre. Kjo për shkak se një fëmijë mund të jetë banor në Fushë Kosovë mirëpo është detyruar të kërkojë lëmoshë në Prishtinë e në këtë rast Qendra për Punë Sociale në Fushë Kosovë mund të mos e ketë fëmijën në regjistrin e vet përderisa ai/ajo nuk i përmbushë kriteret për përfshirje në regjistrin e Prishtinës.

ii. Asistenca sociale

Përkundër faktit se fëmijët mund të jenë në lëvizje për arsye të ndryshme, rrethanat ekonomike në shtëpi mund të kenë pasur ndikim gjithashtu dhe në këtë rast duhet të merret parasysh Ligji për skemën e asistencës sociale që synon të ofrojë rrjetin e sigurisë sociale brenda sistemit për mbrojtje sociale në Kosovë dhe të zbusë varfërinë përmes dhënies së asistencës për familjet e varfëra dhe të cënueshme.[66] Skema operon përmes dy kategorive: kategoria e parë është për anëtarët vartës në familje të cilët nuk janë në gjendje të punojnë; përderisa kategoria e dytë është për familjet ku së paku një anëtar është në gjendje të punojë dhe ku është ose një fëmijë nën moshën 5 vjeçare dhe/ose një jetim nën moshën 15 vjeçare nën kujdesin e përhershëm të familjes. [67] Familjet e të dyja kategorive duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të pasurisë dhe të hyrave me qëllim të pranimit të mbështetjes siç specifikohet me Ligj.[68] Më tej, Ligji specifikon se personat e pranueshëm për aplikim janë qytetarë të Kosovës,[69] si dhe jo-shtetas duke përfshirë qytetarët e huaj me leje qendrimi, kërkuesit e azilit, refugjatët ose personat të cilët kanë mbrojtjen e përkohshme ose plotësuese.[70] Megjithatë, qasja e tyre në skemë duhet të rregullohet me aktin e ndarë nënligjor i cili nuk është miratuar.[71] Më tej, familjet të cilat i përmbushin kriteret nën kategorinë një, do t'u aprovohet kërkesa deri në 12 muaj, përderisa ato në kategorinë e dytë do ta pranojnë atë për 6 muaj, pas kësaj periudhe ata duhet të dëshmojnë se kanë kërkuar punë. Për të dyja kategoritë vlen rregulla se pas periudhës përkatëse (12 muaj dhe 6 muaj) ata duhet të ri-aplikojnë.[72]

---

[65] Neni 9.5, Ligji nr. 04/L-081 për amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02 /l-17 për Shërbimet Sociale e Familjare

[66] Ligji nr. 2003/15, Preambula

[67] Neni 4.1, Ibid dhe me plotësim të Ligjit nr. 04/L-096 për amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15për Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë

[68] Neni 5, Ligji nr. 2003/15 dhe Ligji nr. 04/L-096

[69] Neni 4.1, Ligji nr. 04/L-096

[70] Neni 4.2, Ibid

[71] Neni 4.3, Ibid

[72] Neni 7, Ibid

Edhe pse vlerësimet e mëparshme të skemës kanë shprehur se është një metodë efikase për transferim të burimeve tek të varfërit, gjithashtu një prej të gjeturave është se vetëm 23% të të varfërve dhe 34 % të atyre që jetojnë në varfëri të skajshme janë arritur prej skemës dhe njësitë janë jo-adekuate për t'i nxjerrë ata prej varfërisë.[73] Për më tepër, është gjetur se kriteri i moshës duket jo-logjik dhe i padrejtë, se skema duket se arrinë tek " të varfërit e privilegjuar" e jo tek ata që janë në nevojë ekstreme; vlera e siguruar nuk i mbulon domosdoshmëritë dhe periudhat e shkurtëra të pagesës nuk i lejojnë kohë planifikimit të ekonomisë shtëpiake.[74] Përkundër rekomandimeve të dhëna për përmirësim të skemës aktuale me qëllim të përfshirjes së benefitit për nxënës shkollor (6-18 vjeçar) që do të reduktonte varfërinë në masë të madhe përmes rritjeve modeste të kostove; ato nuk janë marrë parasysh gjatë amendamentimit të ligjit në 2012.[75]

Është e diskutueshme se skema aktuale nuk siguron mbrojtjen e domosdoshme për FnL për shkak të një numri arsyesh. Së pari kriteri i moshës duket se është i padrejtë dhe në fakt mund të jetë faktor shtytës për fëmijët që kërkojnë lëmoshë në rrugë ose të detyrohen të bëjnë ndonjë punë tjetër sikurse është shitja e produkteve të ndryshme duke përfshirë duhanin. Së dyti, skema aktuale nuk trajton në mënyrë të përshtatshme të gjithë FnL pasi që nëse nuk janë shtetas atëherë aktualisht ata nuk do të kenë qasje në skemë. Së treti, procedura e aplikimit është shumë e komplikuar dhe grupet specifike të margjinalizuara sikurse anëtarët e komuniteteve të Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve, personat me aftësi të kufizuara ose personat që janë analfabet mund të kenë vështirësi t'i qasen skemës për shkak të mos-regjistrimit ose mungesës së dokumenteve të nevojshme.

c. Legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore dhe punës së fëmijëve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndalon trafikimin e qenieve njerëzore si dhe skllavërinë dhe punën e detyruar.[76] Gjithashtu, trafikimi i njerëzve është vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës, që dënohet me gjobë dhe burgosje prej 12 deri 15 vite.[77] Definicioni i përdorur është pothuajse identik me atë të Protokolit të Palermos [78] pasi që përfshinë përcaktimin e trafikimit të

[73] Banka Botërore, 'Dokumentet teknike të sektorëve social – Cështjet e politikave në sektoret sociale', korrik 2008, Konferenca e donatorëve, Bruksel

[74] Roelen K, Gassman F, 'Sa mund të jetë efektiv efikasiteti? Asistenca Sociale në Kosovë dhe Cka do të thotë ajo për fëmijë', dhjetor 2010, dokument i përgatitur për prezantim në Konferencën ndërkombëtare të Bankës Botërore për Varfërinë dhe Përfshirjen Sociale në Ballkanin Perëndimor, në f. 12

[75] Ibid, p. 15

[76] Neni 28, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[77] Neni 171.1, Kodi Penal i Kosovës

[78] Kuvendi i përgjithshëm i KB, Protokoli për parandalim, shuarje dhe dënim të trafikimit të njerëzve, në veçanti grave dhe fëmijëve, Plotësim i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, 15 nëntor 2000

fëmijëve edhe kur mjetet [79] nuk janë prezente,[80] si dhe e shton lëmoshë kërkimin si formë të shfrytëzimit. Poashtu, Kodi Penal siguron një dënim më të ashpër maksimal kur viktima e trafikimit është fëmijë (15 vite burgosje),[81] penalizon sjelljen a tyre që pranojnë shërbimet seksuale prej viktimës së trafikimit me dënim më të ashpër maksimal kur viktika e trafikimit është fëmijë (10 vite burgosje)[82] dhe njeh veprat tjera penale të shoqëruara me trafikim sikurse mbajtja e dokumentit të identifikimit të viktimës së trafikimit[83]

Në vitin 2013 është miratuar Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit (Ligji kundër trafikimit të qenieve njerëzore).[84] Qëllimi i ligjit është të vendosë përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse për të punuar në parandalim dhe luftim të trafikimit të qenieve njerëzore pa marrë parasysh nëse bëhet në nivel nacional ose transnacional, si dhe të sigurojë shërbimet për viktima të trafikimit.[85] Përderisa një gamë e autoriteteve kompetente [86] janë specifikuar në lgj për të parandaluar dhe luftuar trafikimin dhe për t'i ofruar asistencë viktimave, Ligji kundër trafikimit të qenieve njerëzore gjithashtu themelon Autoritetin Nacional kundër trafikimit të qenieve njerëzore që udhëheqet prej Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit (më tej i ashtuquajtur Koordinatori).[87] Kompetencat e Koordinatorit përfshijnë kryesimin e Autoritetit Nacional në bashkëpunim me autoritetet tjera kompetente si dhe zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e implementimin e Mekanizmave nacional referues për të siguruar 'identifikimin, referimin, asistencën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, duke përfshirë edhe viktimat fëmijë'.[88]

Gjithashtu, Ligji kundër trafikimit ka një numër të dispozitave të rëndësishme në lidhje me viktimat fëmijë si dhe një kapitull që përshkruan masat për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve. Në përgjithësi, korniza e Ligjit kundër trafikimit, neni 13 përshkruan se fëmija viktimë e trafikimit 'nuk është subjekt i procedurave ose sanksioneve ligjore për vepra penale në lidhje me situatën e tyre si viktika të trafikimit'.[89] Ngjajshëm, neni 16 detajon mënyrat në të cilat duhet të trajtohet fëmija në hetimet e veprave dhe procedurave penale me qëllim të parandalimit të ri-viktimizimit.[90] Përderisa Kapitulli V përfshinë një numër të dispozitave të rëndësishme ku së pari fëmija viktimë e trafikimit në veçanti do të pranojë asistencë dhe mbrojtje në përputhje me atë që është në interesin më të lartë të fëmijës dhe se autoritetet përgjegjëse janë të obliguara të raportojnë rastet kur dyshojnë se fëmija i është ekspozuar rrezikur të shfrytëzimit ose

[79] Sipas Nenit 171.6.1 të Kodit Penal të Kosovës këtu përfshihet: 'rreziku ose përdorimi i forcës apo formave tjera të detyrimit, grabitjes, mashtrimit, keqpërdorimit të fuqisë ose keqpërdorimit të cënueshmërisë ose dhënies ose pranimit të pagesës ose benefiteve prej miratimit të personit i cili ka nën kontroll një person tjetër'
[80] Neni 171.6.4, Kodi penal i Kosovës
[81] Neni 171.2, Kodi penal i Kosovës
[82] Neni 231, Kodi penal i Kosovës
[83] Neni 172, Kodi penal i Kosovës
[84] Ligji nr. 04/L-218
[85] Neni 1 dhe Neni 2, Ligji kundër trafikimit
[86] Neni 6, Ligji kundër trafikimit
[87] Neni 7 dhe Neni 8, Ibid
[88] Neni 8.3, Ibid
[89] Neni 13.2, Ligji kundër trafikimit
[90] Neni 16, Ibid

trafikimit.[91] Së dyti, Ligji kundër trafikimit definon parimet specifike kur lufton trafikimin e fëmijëve në veçanti kur një fëmijë është në gjendje të ketë pikëpamjet e tij/saj, duke i dhënë peshë pikëpamjeve të fëmijës në përputhje me moshën e tij/saj, maturitetin dhe atë që është në interesin më të lartë të fëmijës, informimin e fëmijës për të drejtat e tij/saj në mënyrën e përshtatshme për atë fëmijë dhe duke mbrojtur identitetin e fëmijës i cili është viktimë e trafikimit.[92] Së treti, nëse mosha e viktimës së trafikimit është e panjohur mirëpo ka arsye të besohet se viktima ende nuk i mbushur 18 vite supozohet se viktima është fëmijë.[93]

Përderisa të gjitha dispozitat e lartpërmendura janë definuar në kushte neutrale dhe si të tilla do të aplikoheshin në raste të viktimave nacionale ose të huaja të trafikimit duke asistuar çfarëdo FnL, pa marrë parasysh origjinën ose statusin, Ligji kundër trafikimit gjithashtu e detajon procedurën për sa i përket fëmijëve viktima të huaja të trafikimit. Fëmija viktimë e huaj e trafikimit mund të kthehet/riatdhesohet në shtetin e tij/saj të origjinës edhe pse para kthimit duhet të arrihet miratimi se fëmija do të pritet prej prindit/kujdestarit të tij/saj ose se autoritetet kompetente pajtohen të ofrojnë asistencën dhe mbrojtjen adekuate.[94] Në rrethana kur kthimi/riintegrimi nuk është i lejueshëm, autoritetet e Kosovës së bashku me shtetin amë do të sigurojnë rivendosjen në një shtet të tretë dhe derisa të arrihet një zgjidhje e qëndrueshme fëmija viktimë e huaj e trafikimit ose fëmija pa shtetësi ka të drejtën e lejes së përkohshme të qëndrimit.[95] Në këtë proces duhet të merren parasysh pikëpamjet e fëmijës në përputhje me moshën e tij/saj dhe interesin e tij/saj më të lartë.[96] Përderisa Neni 38 i Ligjit kundër trafikimit përshkruan mënyrat përmes të cilave fëmija viktimë e trafikimit mund të pranojë asistencën dhe mbrojtjen duke përfshirë një vlerësim individual për përcaktim të mbështetjes të cilën e kërkojnë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, deri në 6 muaj akomodimin në strehimore ndaras prej të rriturve, të drejtën për shkollim, asistencën me gjetje të familjeve të tyre, si dhe kujdes afatgjatë deri në marrjen e plotë të vehtes.[97] Më tej, fëmija viktimë e trafikimit ka të drejtën për 30 deri 90 ditë periudhë të reflektimit me qëllim që të vendosë nëse do të dëshmojë kundër trafikuesit të vet.[98]

Para Ligjit kundër trafikimit, Qeveria e Kosovës (QeK) gjithashtu ka aprovuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2011 – 2014, që ka pasur si cak specifik mbrojtjen e fëmijëve si dhe veprime specifike që duhet të implementohen siç detajohen në planin e veprimit.[99] Pas vlerësimit, QeK përmes zyres së Koordinatorit aktualisht po e finalizon Strategjinë e re dhe Planin e Veprimit Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2014-2019. Me qëllim të intensifikimit të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin prej Shqipërisë dhe anasjelltas, autoritetet Kosovare dhe Shqiptare, në qershor 2012, kanë

[91] Kapitulli V, Neni 34, Ibid
[92] Neni 35, Ibid
[93] Neni 36, Ibid
[94] Neni 37.1, Ibid
[95] Neni 37.3 dhe Neni 37.6, Ibid
[96] Neni 37.4, Ibid
[97] Neni 38, Ligji i Anti-trafikimit
[98] Neni 38.6, Ibid
[99] Strategjia dhe Plani i Veprimit mund të gjindet në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJAnglisht.pdf paraqitur më 05/04/2014

nënshkruar Protokolin Shtesë[100] me fokus të veçantë tek fëmijët. Protokoli synon të përmirësojë identifikimin, lajmërimin, referimin dhe kthimin vullnetar të asistuar të viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit, e sidomos fëmijëve. Megjithatë, në implementim janë identifikuar pengesa, në veçanti në lidhje me fëmijët Shqiptarë të cilët duket se janë mbërthyer në një qark të egër të trafikimit në Kosovë për qëllime të kërkimit të lëmoshës ose janë detyruar me forcë prej prindërve të tyre të kërkojnë lëmoshë; janë kthyer në Shqipëri e pastaj janë ri-kthyer në Kosovë. Me qëllim të diskutimit mbi sfidat është organizuar një konferencë nga Koordinatori Nacional për Bashkëpunim Nacional e Transnacional për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore me autoritetet e Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi në mars 2014,[101] me takimet shtesë që do të mbahen gjatë tërë vitit për të përmirësuar implementimin e Protokolit Shtesë dhe kështu të sigurohet një mbrojtje më e mirë për FnL.

Për sa i përket trafikimit, dispozitat ligjore të përshkruara janë përshtatur në vija të përgjithshme dhe si të tilla janë të aplikueshme për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh origjinën ose statusin, kështu që për FnL është siguruar një mbrojtje e mjaftueshme. Megjithatë, brenda kornizës ligjore mund të bëhen përmirësime. Për shembull, Ligji kundër trafikimit përkundër referimit në Kodin Penal, nuk e përcakton trafikimin në të njejtën mënyrë pasi si pasojë i përzien elementet e ndryshme të krimit sikurse akti ose kryerja[102], mënyrat[103] dhe qëllimi[104] duke mos i konsideruar si elemente të veçanta. Përderisa Kodi Penal është "lex specialis" që në këtë rast do të mbështetej në ndjekjen penale të trafikuesve, është me rëndësi të ketë definicione konsistente të krimeve sidomos pasi praktika në Kosovë ka treguar se ka problem në ndjekjet penale të trafikuesve duke përfshirë edhe rastet e viktimave fëmijë. Raporti i OSBE-së në 2011 ilustron problemet në implementim pasi në një rast trafikimi ku janë involvuar 2 fëmijë (njëri 13 dhe tjetri 14 vjeç) vetëm njëri prej të akuzuarve është dënuar për trafikim ndërsa personi tjetër është akuzuar për abuzim seksual të fëmijës. Megjithatë, pokuroria ka dështuar të hetojë me efektivitet rastin pasi i pandehuri i dytë dukej se e kishte strehuar fëmijën para se të abuzojë me të seksualisht dhe mund të jetë akuzuar për trafikim. Më tej, prokuroria do të duhej të kishe hetuar veprat tjera penale të kryera, si pranimi i shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit, rreziqeve dhe dhunimit tek të tjerët.[105] Për më tepër, pasi që definicioni i trafikimit në Ksovë përfshinë kërkimin e lëmoshës, përpjekje shtesë duhet të bëhen ashtu që dhunuesit të cilët trafikojnë fëmijë për qëllime të kërkimit të lëmoshës të sjellen para drejtësisë.

---

[100] Marrëveshja për bashkëpunim të intensifikimit të bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, lajmërimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit sidomos fëmijëve, që plotëson Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë " për bashkëpunimin ndër-kufitar të policisë" të nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, qershor 2012.

[101] Mbështetur nga projekti Mario dhe GIZ – Deutsche Geselleschaft für Internationale Zusammenarbeit

[102] Kjo i referohet: rekrutimit, transportit, transferit, strehimit ose pranimit të personave

[103] Kjo i referohet : kërcënimit dhe detyrimit me forcë, ose formave tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të fuqisë ose pozitës së cënueshmërisë dhe dhënies apo pranimit të pagesës ose benefiteve

[104] Kjo i referohet: shfrytëzimit

[105] Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evrope (OSBE), Misioni në Kosovë, ' Definimi dhe Ndjekja penale e Trafikimit të Qenieve Njerëzore', tetor 2011

Një aspekt tjetër i cili ka nevojë të konsiderohet janë dispozitat brenda kornizës ligjore në lidhje me punën e fëmijës pasi edhe kjo ka ndikim në të drejtat e FnL. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar,[106] përderisa Kodi Penal përshkruan se skllavëria apo kushtet e saj ose puna e detyruar janë vepra penale të dënueshme me gjobë ose burgosje prej 2 deri 10 vite. Nëse vepra penale është kryer kundër një fëmije, dhunuesi mund të dënohet prej 3 deri 15 vite.[107] Përveç kësaj, nëse prindi/ kujdestari ose ndonjë person tjetër i cili ushtron autoritet prindëror e detyron fëmijën të kërkojë lëmoshë ose ndonjë benefit tjetër, të punojë në forma të rënda apo të kryejë punë që nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijës, ose e angazhon fëmijës në ndonjë aktivitet i cili e vë në rrezik apo e dëmton zhvillimin e fëmijës, ai mund të dënohet me gjobë dhe burg prej 1 deri 5 vite.[108]

Sipas Ligjit të Punës, fëmijët nën moshën 15 vjeçare nuk mund të kontraktohen për punë, përderisa ata ndërmjet 15 dhe 18 mund të punësohen për detyra të lehta të cilat nuk paraqesin ndonjë rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre.[109] Gjithashtu, fëmijëve u ndalohet puna gjatë ndërrimit të natës. [110] Poashtu, Udhëzimi Administrativ për parandalim dhe ndalim të punës së rrezikshme për fëmijë në Kosovë[111] (UA mbi punën e rrezikshme të fëmijëve), paraqet një listë gjithëpërfshirëse të punëve të rrezikshme të cilat u ndalohen fëmijëve. Këtu përfshihet puna në lartësi mbi 2 metra, në mjedise ku ka substancë toksike, punë në industritë specifike sikurse bujqësia, puna në rrugë, ndërtimi, ndër të tjera.[112] Komiteti për parandalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijës gjithashtu ka përpiluar Strategjinë për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijës 2011 – 2016, që është miratuar në vitin 2011 si dhe Planin e Veprimit 2011 – 2013. Përderisa korniza ligjore për sa i përket punës së fëmijës është e vendosur dhe përfshin FnL pasi që nuk i diferencon në bazë të origjinës ose statusit, ende ka nevojë për përpjekje të konsiderueshme për të siguruar se FnL janë mbrojtur. Për shembull, gjatë 2012 është përpiluar një Urdhër Operacional "Tërheqja e Lëmoshë-kërkuesve" prej anës së Drejtoratit të Policisë në Komunitet që është implementuar në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale dhe OJQ-të dhe në këtë bazë të ndërmerren të gjitha planet operative të stacioneve të policisë për sa i përket lëmoshë-kërkuesve. Megjithatë, gjatë 2012, vetëm 107 fëmijë lëmoshë-kërkues janë identifikuar dhe duket se aktivitetet për identifikim të fëmijëve të tillë janë zhvilluar vetëm në baza ad hoc.[113]

---

[106] Neni 28, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[107] Neni 169, Kodi Penal i Kosovës

[108] Neni 250, Ibid

[109] Neni7, Ligji mbi punën, Ligji nr. 03/L-212

[110] Neni 27, Ibid

[111] Udhëzimi administrativ 5/2013

[112] Shih Aneksin I, Udhëzimin administrativ 5/2013

[113] Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 'Raporti vjetor për implementimin e planit të veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve 2012', f. 34 gjindet në https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/Report%202012%20on%20Implementation%20of%20the%20KAP%20for%20Prevention%20and%20Elimination%20of%20CL%20in%20Kosovo.pdf paraqitur më 05/04/2014

e. Legjislacioni mbi azilin

Në Kosovë, Ligji mbi azilin[114] siguron llojet e mbrojtjes që është e disponueshme për personat të cilët kërkojnë azil dhe status të refugjatit në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këtu përfshihet statusi i refugjatit[115], i përcaktuar në kushte identike sikurse në Konventën e vitit 1951 për statusin e refugjatit (Konventa e Gjenevës),[116] mbrojtjen shtesë[117] në raste kur është theksuar baza për rrezik osë dëm serioz,[118] dhe mbrojtjen e përkohshme me qëllim të ballafaqimit me situata të fluksit masiv.[119] Gjithashtu, Ligji mbi azilin siguron mbrojtjen që do ti sigurohet azil-kërkuesve edhe në rast se nevoja shfaqet *sur place* dhe ndalon autoritetet e Kosovës që të përjashtojnë azil-kërkuesit (parimi i jo-shtypjes). Çdokush që deklaron synimin e tyre për të kërkuar azil në Kosovë do të trajtohet si azil-kërkues dhe do të pranohet si i tillë në territorin e Kosovës.[120] Brenda 15 ditëve prej dorëzimit të aplikacionit për azil ligji siguron që aplikuesi do të informohet në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton rreth procedurave të azilit, të drejtave dhe obligimeve të tyre si dhe mundësinë për të kontaktuar me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) si dhe me OJQ tjera. [121]

Gjatë aplikimit për azil autoritetet janë të obliguara të ndërmarrin të gjitha masat e synuara për mbrojtje të njësisë së familjes dhe në raste kur të gjithë anëtarët e familjes nuk kualifikohen individualisht për mbrojtje ata mund të përfitojnë prej statusit rezultues të refugjatit në bazë të njësisë familjare.[122] Ligji mbi azilin përcakton anëtarët e familjes që mund të jenë partner të martuar ose të pamartuar, si dhe fëmijë të lindur në apo jashtë kunorës, përfshirë edhe fëmijët e adaptuar.[123] Ligji gjithashtu siguron një definicion specifik për të miturit e pashoqëruar duke rekomanduar që të gjithë fëmijët e huaj ose pa shtetësi nën moshën 18 vjeçare duhet të trajtohen si të mitur të pashoqëruar, pa marrë parasysh nëse ata do të jenë vetëm kur hyjnë në territorin e Kosovës apo janë të lënë vetëm pasi të hyjnë në Kosovë.[124] Gjithashtu. Gjatë procedurës së azilit, azilkërkuesit gëzojnë një numër të drejtash duke përfshirë: kushtet bazë të jetesës sikurse

[114] Ligji nr. 4/L-217
[115] Neni 2.1.1.11, Ligji mbi azilin
[116] Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve, 28 korrik 1951
[117] Neni 2.1.1.12, Ligji mbi azilin
[118] Këtu përfshihet dënimi me vdekje ose ekzekutimi, tortura ose trajtimi johuman ose degradues ose burgosja e azilkërkuesit në vendin e tyre të origjinës ose rreziqet serioze dhe individuale ndaj jetës së civilit ose personit për shkak të dhunës së rrëmujshme në konflikte të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme
[119] Neni 2.1.1.13, Ligji mbi azilin
[120] Neni 10, Ibid
[121] Neni 11.2, Ibid
[122] Neni 3.2, Ibid dhe Ligji për të huaj, Ligji nr. 04/L-219
[123] Neni 2.1.1.19, Ligji mbi azilin
[124] Neni 2.1.1.21, Ibid

strehimi, ushqimi dhe rrobet,[125] si dhe kujdesi shëndetësor, asistenca sociale, shkollimi për fëmijë dhe asistenca ligjore pa pagesë. [126]

Nëse një i mitur i pashoqëruar kërkon azil, Ligji mbi azilin rekomandon që ai/ ajo të delegohet si rast tek një punëtor social i Qendrës për Punë Sociale, sa më parë të jetë e mundur, si përfaqësues i të miturit të pashoqëruar. Roli i punëtorit social është të përfaqësojë dhe/ose të asistojë fëmijës e pashoqëruar gjatë procedurës së aplikimit dhe fëmijës i pashoqëruar nuk mund të intervistohet pa prezencën e punëtorit social.[127] Para intervistës, punëtori social do të ketë mundësinë ta informojë të miturin e pashoqëruar rreth intervistës duke përfshirë pasojat e mundshme dhe mënyrën e përgatitjes së intervistës. Ndërsa, gjatë intervistës punëtori social duhet të lejohet të parashtrojë pyetje ose të komentojë.[128]

Më tej, Ministria e Punëve të Brendshme është e obliguar të ndërmarrë hapa për të gjurmuar familjen e fëmijës të pashoqëruar dhe të dërgojë fëmijës ose me të afërmit e rritur, familjen strehuese ose t'i ofrojë akomodim që është i specializuar ose i përshtatshëm për fëmijë.[129] Autoritetet kompetente gjatë ballafaqimit me një aplikacion prej të miturit të pashoqëruar duhet të sigurojë se interesi më i lartë i fëmijës është marrë parasysh në rend të parë.[130] E rëndësishme është se Ligji mbi azilin gjithashtu siguron se pikëpamjet e fëmijës duhet të merren parasysh në pajtim me moshën e tij/saj dhe shkallën e pjekurisë. Gjithashtu, i mituri i pashoqëruar që kërkon azil ka të drejtën për shkollim fillor dhe të mesëm sipas të njejtave kushte sikurse edhe qytetarët e Kosovës.[131]Kur një i mitur i pashoqëruar njihet si refugjat ose i jepet ndonjë formë e mbrojtjes, atij/asaj do t'i caktohet një Kujdestar nga Qendra për Punë Sociale.[132]

Në përgjithësi, legjislacioni mbi azilin në Kosovë siguron mbrojtjen e vazhdueshme për FnL sidomos pasi që parimi i interesit më të lartë të fëmijës është përfshirë, dëshirat e fëmijës duhet të merren parasysh sipas moshës dhe pjekurisë dhe mbrojtjet specifike për të miturit e pashoqëruar janë të përcaktuara. Megjithatë, korniza aktuale ligjore duhet të përmirësohet duke ofruar udhëzime në lidhje me situatat ku mosha e fëmijës vihet në pyetje dhe mënyra se si do të ballafaqohen me të autoritetet relevante përderisa të procedohet aplikimi për azil. Kjo është e rëndësishme se nëse një i mitur i pashoqëruar supozohet gabimisht se është i rritur kjo do të thoshte se ai do të humbiste mbrojtjet shtesë që janë në fuqi për fëmijët e pashoqëruar. Gjithashtu, është thelbësore që ekspertiza e punëtorëve social të përdoret gjatë vlerësimit të moshës si dhe t'i ofrohet qasja të miturit të pashoqëruar me qëllim të shpjegimit të procesit dhe minimizimit të rrezikut të dëmit.

[125] Neni 21, Ligji mbi azilin
[126] Neni 19, Ibid
[127] Neni 14.1, Ibid
[128] Neni 14.3, Ibid
[129] Neni 14.6 dhe Neni 14.7, Ibid
[130] Neni 14.2, Ibid
[131] Neni 24, Ibid
[132] Neni 14.5, Ibid

f. Legjislacioni mbi ripranimin/ të kthyerit

Gjatë konfliktit në Kosovë, një numër i madh i qytetarëve janë deportuar, dhe shumë prej tyre kanë kërkuar mbrojtje në shtetet Evropiane dhe më larg. Trendi i shtetasve Kosovar që kanë kërkuar azil ka vazhduar pas konfliktit, gjatë 2013 është raportuar se 20 175 Kosovarë kanë kërkuar azil në shtetet e Bashkimit Evropian, prej të cilëve 27.3% ishin ndërmjet 0-17 vjeç.[133] Përderisa është një numër i arsyeve, kushtet e dobëta ekonomike dhe varfëria e skajshme aktuale është faktor i pranuar shtytës sidomos pasi 30% ose një e treta e Kosovarëve jetojnë në varfëri të skajshme.[134]

Pa marrë parasysh, si reagim ndaj kësaj situate një numër i shteteve të Bashkimit Evropian kanë konkluduar marrëveshjet për ripranim me Kosovën me qëllim që të kthejnë emigrantët e parregullt duke përfshirë edhe azil-kërkuesit, të cilëve u është refuzuar aplikimi për mbrojtje. Në këtë aspekt, duhet të pranohet se Kosova ka qenë nën presion politik për të pranuar këtë ofertë, edhe pse nuk ka pasur " kapacitetet ose buxhetin për të pranuar këto familje me dinjitet dhe siguri".[135] Për qëllime të këtij procesi është miratuar Ligji mbi ripranimin[136] si dhe Udhëzimi Administrativ 09/2011 për implementimin e Ligjit mbi ripranimin (UA 09/2011) dhe Strategjia Nacionale për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë (Strategjia Nacionale për Riintegrim).

Ligji mbi ripranimin kërkon të vendosë një kornizë të përgjithshme për procesin e kthimit duke përcaktuar se kush mund të ripranohet[137] dhe kushtet të cilat duhet të plotësohen për sa i përket shtetësisë. [138] Megjithatë, është shumë i shkurtër, nuk përmend fare fëmijët children, dhe *de facto* është UA 09/2011, që përvijon kushtet dhe formalitetet për kthim. Sipas UA 09/2011, Kosova do të ripranojë të gjithë personat të cilët nuk janë me qëndrim ligjor në shtetin kërkues, duke siguruar se është dëshmuar ose mund të supozohet me arsyeshmëri në bazë të dëshmisë *prima facie* se ata janë shtetas të Kosovës në përputhje me Ligjin mbi shtetësinë.[139] Në këtë bazë, bashkëshortët dhe fëmijët të mitur të pamartuar të personave të tillë të cilët posedojnë shtetësinë e Kosovës do të ripranohen në mënyrë simultane përveç nëse ata kanë të drejtën për qëndrim në territorin e shtetit kërkues.[140] Përveç kësaj, Kosova do të ripranojë edhe personat të cilët që nga hyrja në territorin e shtetit kërkues kanë qenë të deprivuar nga ose kanë hequr dorë nga shtetësia

---

[133]Bitoulas A, Eurostat të dhënat në fokus 3/2014, 'Popullsia dhe kushtet sociale, gjinden në http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-QA-14-003/EN/KS-QA-14-003-EN.PDF paraqitur me 10/04/2014, në f. 7

[134] Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Çrrënjosja e urisë dhe varfërisë së skajshme, gjindet në http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/mdgoverview/overview/mdg1/ paraqitur më 10/04/2014

[135] Raporti i Komisionerit për të drejta të njeriut i Misionit Special të Këshillit të Evropës në Kosovë, 23-27 mars 2009, para.156 që gjindet në https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1466279 paraqitur më 10/04/2014

[136] Ligji nr. 03/L-208

[137] Neni 3 dhe neni 7, Ligji mbi ripranimin

[138] Neni 5 dhe Neni 6, Ibid

[139] Neni 3.1, Udhëzimi administrativ 09/2011 Mbi implementimin e Ligjit mbi ripranimin (UA09/2011)

[140] Neni 3.2, UA 09/2011

e tyre Kosovare, përveç nëse atyre u është premtuar natyralizimi nga autoritetet kompetente të shtetit kërkues.[141] Një kategori tjetër e personave që mund të ripranohet është ajo e qytetarëve të shtetit të tretë ose personave pa-shtetësi duke siguruar se personat e tillë mund të kenë lidhje me Kosovë duke përfshirë posedimin e vizës valide ose leje-qëndrimin në Kosovë ose kanë qëndruar në Kosovë para se të hyjnë ilegalisht në territorin e shtetit kërkues. Këto kritere për ripranim janë gjithashtu të aplikueshme për bashkëshortë dhe fëmijët e pamartuar të mitur.[142] Megjithatë, nën këtë kategori ka përjashtime që do të thotë se personat e tillë nuk do të ripranohen nëse shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi kanë hyrë në territorin e Kosovës vetëm përmes aeroportit dhe për qëllime tranziti ose shteti kërkues ka lëshuar vizën apo lejeqëndrimin për shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi para ose pas hyrjes në territorin e saj.[143] Përderisa e gjithë procedura e aprovuar për kthime nuk është relevante për këtë raport, përkujtimi i autoriteteve kompetente relevante përbën një informatë të rëndësishme. Sipas nenit 6 të UA 09/2011, autoritetet kompetente janë Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për shtetësi, azil dhe emigrim si dhe Policia e Kosovës.

Gjithashtu, Rregullorja nr. 20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit (Rregullorja 20/2013) paraqet masat që mund të ndërmerren në fushën e riintegrimit si dhe autoritetet që janë përgjegjëse për sigurim të shërbimeve të tilla. Sipas Rregullores 20/2013, personat të cilët e kanë lënë Kosovën para 28 korrikut 2010 dhe brenda 6 muajsh të kthimit për herë të parë[144] janë në gjendje të marrin benefite për të asistuar riintegrimin.[145] Këto benefite përfshijnë asistencën e menjëhershme pas arritjes, benefitet emergjente dhe masat që mbështeësin riintegrimin e qëndrueshëm. Kur të vlerësohet kërkesa për benefite të tilla, Rregullorja përcakton se gjithmonë duhet të merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës dhe nevojat e veçanta të personave të pambrojtur.[146] Për sa i përket fëmijëve, Rregullorja përcakton se të gjithë fëmijët e kthyer kanë të drejtë shkollimi dhe komuna është e obliguar të ofrojë kurse për mësim të gjuhës nëse ka nevojë. Poashtu, fëmijët kanë të drejtë për " asistencë të rastit" bazuar në situatën e tyre të cënueshmërisë. Rregullorja 20/2013 siguron se një asistencë e tillë duhet të jipet sipas vlerësimit preliminar të nevojave nga autoritetet komunale dhe vlerësimi i nevojave duhet të udhëhiqet prej parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Pra, kjo duhet të përcaktohet në baza individuale duke përfshirë llojin e asistencës që mund të jetë e domosdoshme edhe pse nuk sigurohen udhëzime të mëtutjeshme rreth asaj se cfare asistence do të ishte kjo.[147] Ndërsa Strategjia Nacionale për Riintegrim synon të arrijë riintegrimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm për persona të riatdhesuar, duke mos lënë anash formën e kthimit përmes sigurimit të asistencës dhe mbështetjes gjatë tërë procesit të integrimit.[148] Kur sigurohet një asistencë dhe mbështetje e tillë institucionet duhet t'i kushtojnë vëmendje

[141] Neni 3.3, Ibid
[142] Neni 4.1, Ibid
[143] Neni 4.2, Ibid
[144] Kjo mund të zgjatet edhe për 6 muaj tjerë
[145] Neni 2, Rregullorja nr. 20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit (Rregullorja 20/2013)
[146] Neni 4, Rregullorja 20/2013
[147] Neni 11, Rregullorja 20/2013
[148] Strategjia nacionale për riintegrim të personave të riatdhesuar në Kosovë (Strategjia Nacionale për Riintegrim) , tetor 2013, f. 12

kategorive të pambrojtura duke përfshirë fëmijët të cilët nuk e kanë kujdesin e duhur, të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e trafikimit ndër të tjerë.[149]

Korniza ligjore aktuale ngritë një numër çështjesh në lidhje me fëmijët e kthyer që janë pjesë e FnL. Së pari, procesi i kthimit fillon përmes shqyrtimit të situatës së të rriturve, zakonisht kryefamiljarit dhe në bazë të kësaj fëmijët kthehen siç përcaktohet me Nenin 3.2 të UA 11/2011 për fëmijët me shtetësi të Kosovës ose Nenin 4.1.4 të UA 11/2011 për fëmijë të vendeve të treta ose fëmijë pa shtetësi. Kjo është problematike sepse kur arrihet vendimi prej autoriteteve të Kosovës për të pranuar kërkesën për kthim prej shtetit kërkues, ky vendim merret pa e shqyrtuar situatën e fëmijës dhe interesin më të lartë të fëmijës. Pra, vihet në pyetje përputhshmëria e një praktike të tillë me KDF ose Kushtetutën e Kosovës që siguron se " të gjitha veprimet e ndërmarra prej autoriteteve publike … në lidhje me fëmijës do të jenë në interesin më të lartë të fëmijës".[150] Gjithashtu, as Ligji mbi ripranimin as UA 09/2011 nuk rekomandojnë se kur të merret vendimi për kthimin e fëmijëve, interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsideratë primare.

Së dyti, situata ndoshta është më problematike kur kemi të bëjmë me fëmijë të vendeve të treta ose fëmijë pa shtetësi. Kjo ndodhë sepse Kosova përmes UA 09/2011 ka marrë përsipër obligimin për të pranuar fëmijët e tillë të kthyer nga shtetet kërkuese edhe pse kriteret e aplikuara janë të paqarta pasi prezenca e tyre në territorin e Kosovës për një periudhë të kufizuar kohore do të mund të rezultonte me kthimin e tyre. Edhe njëherë për sa i përket kësaj kategorie, vendimi fillestar për të pranuar të kthyerit bazohet në të rriturit përkundër fëmijëve. Pra, obligimi në vendime të tilla për të sjellë atë që është në interesin më të mirë të fëmijës nuk duket se shqyrtohet dhe ndihmesa në kthimin e tyre do të mund të ishte e dëmshme sidomos pasi fëmijët e kthyer (vendet e treta ose pa shtetësi) mund të mos kenë lidhje me Kosovë. [151] Si rezultat kjo do të ndikojë shumë në integrimin e tyre si dhe realizimin e të drejtave civile, politike dhe kulturore. Së treti, autoritetet kompetente kanë të përcaktuara në UA /09/2011 theksojnë se procesi i ripranimit shikohet vetëm prej perspektivës së emigracionit. Kjo mund të paraqet problem pasi ripranimi mund të jetë proces kompleks që kërkon qasje multi-disiplinore për të minimizuar rrezikun e dëmit që mund t'i shkaktohet fëmijëve dhe në afat të gjatë për të ndihmuar integrimin.

Për sa i përket riintegrimit, Rregullorja 20/2013 i kushton vëmendje fëmijëve duke siguruar se do të merret parasysh interesi më i lartë i fëmijëve dhe është me rëndësi të theksojmë se ky nuk është rasti. Gjithashtu, përderisa Rregullorja siguron masat specifike sikurse ato për shkollim dhe mbështetje shtesë që mund të kërkohet në raste individuale prapë vihet në pyetje shtrirja e saj e pamjaftueshme. Kjo ndodhë për shkak se tërë përvoja e kthimit mund të ketë ndikim negative në sfera të ndryshme të jetës së fëmijës. Pra, në këtë aspekt ka nevojë që rregulloret e vendosura të rekomandojnë masa gjithëpërfshirëse që do të merrnin parasysh mirëqenien e fëmijës përmes vizitave dhe monitorimit pasi për shembull do të mund të ishin në rrezik të abuzimit, trafikimit ose përpjekjeve tjera të migrimit të pasigurtë.

[149] Strategjia Nacionale për Riintegrim të personave të riatdhesuar në Kosovë (Strategjia Nacionale për Riintegrim), tetor 2013, në f. 7

[150] Neni 50.4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[151] Këtu do të mund të përfshihej gjuha, kultura, religjioni

V. Sistemi për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë i referon institucionet/ akterët e ndryshëm dhe komponentët me përgjegjësi për ndërmarrje të masave të koordinuara për ruajtje të mirëqenies së fëmijës dhe për mbrojtje të fëmijës prej të gjitha formave të " dhunës fizike ose mentale, lëndimit ose abuzimit, neglizhimit ose trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual gjersa është nën kujdës të prindit, kujdestarit ligjor ose çdo personi tjetër i cili ka nën kujdes fëmijën'.[152] Akterët e involvuar përfshijnë familjen, komunitetin dhe agjencitë statutore sikuese shërbimet sociale, sistemin edukativ dhe zbatimin e ligjit.

Në Kosovë, sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet prej akterëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror, që i kontribuojnë mbrojtjes së fëmijës. Aktualisht, përgjegjësitë e tyre për mbrojtje nuk janë artikuluar në një akt legjislativ dhe në rast të tillë është e domosdoshme të rikujtojmë dispozitat e ndryshme që në fakt përbëjnë sistemin e mbrojtjes së fëmijës. Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesave lokale që mbulojnë një numër fushash përderisa respektojnë standardet e vendosura me legjislacionin e aplikueshëm. Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve kompetencat e secilës komunë përfshijnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve familjare dhe të tjera të mirëqenies sociale.[153] Ligji mbi Shërbimet sociale dhe familjare përcakton se secila komunë është përgjegjëse për sigurim të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të vet sipas standardit të specifikuar nga Ministria.[154] Poashtu secila komunë është e obliguar të themelojë Qendrën për Punë Sociale (QPS) që zhvillon vlerësimet profesionale për ata që e kanë referuar vehten apo ata persona të cilët fitojnë vëmendjen e QPS si persona në nevojë për shërbime sociale apo familjare, si dhe për themelim të Organit të kujdestarisë.[155]

Aktualisht janë 37 QPS dhe ato mund të konsiderohen si Organi udhëheqës përgjegjës për trajtimin e rasteve të fëmijëve të cilët dyshohet se janë abuzuar, eksploatuar, neglizhuar apo keqtrajtuar.[156] Mandati i tyre rekomandon që nëse QPS " ka bazë për dyshim që një fëmijë *shtetas, ose i gjetur në*, territorin e tyre si i braktisur, jetim, në vuajtje ose në rrezik prej, çfarëdo forme të dhunës fizike apo mentale, dënimi apo abuzimi, neglizhence apo trajtimi neglizhent, duke përfshirë edhe abuzimin seksual, përderisa nën kujdesin e prindit, ose kujdo tjetër që kujdeset për fëmijës, QPS duhet të ndërmerr çfarëdo hapa të nevojshëm pr të siguruar mirëqenien e fëmijës, të raportojë çështjen tek departamenti relevant dhe brenda 24 orësh të zhvillojë vlerësimin profesional të nevojave të fëmijës për mbrojtje.[157] Poashtu, nëse zyrtari i shërbimit social ka arsye të besojë se fëmija është në rrezik imediat ai/ajo mund të hyjnë në

[152] Neni 19.1, KDF

[153] Neni 17.1.i dhe Neni 17.1.k, Ligji mbi vetëqeverisjen lokale, Ligji nr. 03/L-040

[154] Neni 6.1, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare

[155] Neni 7.1 dhe Neni 7.2, Ibid (Ju lutem veni re se Organi i Kujdestarisë ndonjëherë referohet si Autoriteti për kujdestari edhe pse pasi që Ligji mbi familjen i referohet të njejtit si Organ i Kujdestarisë , kështu që në këtë raport do të përdoret ky term.)

[156] Neni 10.7, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare

[157] Neni 10.7, Ibid

objektin rezidencial dhe të marrin fëmijën e ta dërgojnë në vend të sigurtë për një periudhë të caktuar kohore edhe pse jo më gjatë se 72 orë.[158]

Një pjesë integruese e sistemit të mbrojtjes së fëmijës është raportimi obligativ dhe obligimi i profesionistëve për të bashkëpunuar me QPS. Sipas kësaj, çdo profil i mësuesit, motrave medicinale, mjekëve , dentistëve ose psikologëve apo ndonjë zyrtari policor ose ndonjë profesionisti me detyrë kujdesi për fëmijët, i cili mund të dyshojë ose ka dëshmi se fëmija vuan prej abuzimit fizik, seksual ose psikologjik prej anës së prindit apo kujdestarit është i obliguar të raportojë çështjen tek Drejtori relevant i QPS-së. Dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijës [159] prej profesionistëve të përmendur [160] ose dikujt tjetër kur ka dyshim për një abuzim të tillë mund të rezultojë me ndjekje penale.[161] Përveç kësaj, përderisa QPS e bën vlerësimin gjithëpërfshirës profesionale të nevojës së fëmijës për mbrojtje, çdo profesionist i cili ka kontaktuar me fëmijën e ka për obligim të bashkëpunojë dhe asistojë kurdo që të jetë e mundur.[162] Poashtu, agjensionet e zbatimit të ligjit janë të obliguara të asistojnë QPS në raste kur ka dyshime për abuzim të fëmijës si dhe të zhvillojnë hetimet kriminale kurdo që një gjë e tillë të jetë e domosdoshme.[163]

Në të njejtën kohë, QPS vetëm nuk mund dhe nuk e përbën sistemin për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë. Për kategori tjera FnL, nga institucionet tjera kërkohet të marrin rolin udhëheqës edhe pse ka raste kur ata janë të obliguar të përfshijnë QPS. Për sa i përket që janë të ndërlidhura me veprën penale të kryer kundër një fëmije sikurse do të ishte abuzimi seksual ose trafikimi, autoritetet e zbatimit të ligjit janë të obliguara të veprojnë me kujdes të veçantë ndaj fëmijës viktimë, duke pasur në mendje moshën e tij/saj, karakteristikat personale, arsimimin, mjedisin në të cilin ai/ajo jeton, për t'ju shmangur çfarëdo lloji të rrezikut. Gjithashtu do të bëhet edhe ekzaminimi i fëmijës me asistencën e pedagogut, psikologut ose ndonjë eksperti tjetër.[164] Në raste të trafikimit, identifikimi i hershëm mund të bëhet prej shërbimeve konsullore, policisë kufitare dhe/ ose inspektorateve të punës, [165] përderisa identifikimi zyrtar do të bëhet duke aplikuar listën e indikatorëve nga institucionet si: Njësitë e Policisë, Prokuroria, Mbrojtësi i viktimave dhe QPS.[166]Gjithashtu viktimat e trafikimit duhet të marrin asistencë dhe të jenë nën mbrojtje duke përfshirë edhe strehimin si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin. Në këtë aspekt, një numër profesionistësh janë të përfshirë në ofrim të shërbimeve duke përfshirë: strehimoret, profesionistët medicinal (psikologët), punëtorët social, juristët dhe zyrtarët tjerë shtetëror.[167]

---

[158] Neni 10.4, Ibid

[159] Sipas nenit 254 të Kodit Penal këtu përfshihet: keqtrajtimi, braktisja ose neglizhimi

[160] Neni 10.6, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare

[161] Neni 254, Kodi penal i Kosovës

[162] Neni 10.9, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare

[163] Neni 10.10, Ibid

[164] Neni 147, Kodi penal për të mitur, Ligji nr. 03/L-193

[165] Neni 12.3, Ligji kundër trafikimit (ju lutemi veni re Udhëzimin Administrativ i cili është në process të përpilimit)

[166] Neni 12.4, Ibid (ju lutemi veni re se Lista e indikatorëve duhet të zhvillohet)

[167] Shih Kapitullin IV, Asistenca dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Ligji kundër trafikimit

Në raste azili, është Departamenti i shtetësisë, azilit dhe migracionit (DShAM) në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) i cili merr rolin udhëheqës në procesimin e aplikacionit për azil, me Komitetin Nacional për refugjatë që merret me apelime.[168] Kur hyn në territorin e Kosovës dhe kërkon azilin, azil-kërkuesi strehohet në Qendrën për Azil-kërkues ose i gjindet akomodim tjetër.[169] Profesionistët tjerë të involvuar mund të jenë juristët, organizatat e refugjatëve dhe zyrja e UNHCR-së si dhe profesionistë të institucioneve tjera për sa i përkët arsimit ose shëndëtësisë ndër të tjera.[170] Në raste të të miturve të pashoqëruar, pasi të informohet QPS është e obliguar të caktojë një zyrtar të shërbimeve sociale si përfaqësues të miturit të pashoqëruar për ta asistuar dhe/ose përfaqësuar atë gjatë aplikimit për azil.[171]

Një segment tjetër i rëndësishëm i sistemit është ai i të kthyerve. UA 09/2011 siguron kompetencat vetëm për ato institucione të cilat janë të domosdoshme për të ndihmuar në kthim, ku përfshihet DShAM, Policia e Kosovës dhe MPB.[172] Megjithatë, Strategjia Nacionale për Riintegrim përmbledhë një numër institucionesh shtesë të cilat kanë rol ndihmës në riintegrim dhe riatdhesim që prekë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Në nivel qendror, Departamenti për riintegrim të personave të riatdhesuar (SRPR) brenda MPB-së është përgjegjës për menaxhim të procesit të riintegrimit dhe riatdhesimit duke siguruar udhëzimet dhe duke shpërndarë informatat tek të tjerët. Për sa i përket asistencës së drejtpërdrejtë, Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR) i përbërë prej ministrive të ndryshme[173] vendosë mbi kërkesat e personave të riatdhesuar të cilët mund të apelojnë mbi vendimet në Komisionin e apelit.[174] Prej Ministrive të përfshira, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është më relevante pasi strategjia përcakton se roli i saj është të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve dhe në raste trafikimi ose të dhunës në familje të ofrojë strehim.[175] Ndërsa në nivelin lokal, institucionet përfshijnë Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) e cila informon, asiston dhe këshillon të kthyerit, monitoron situatën e tyre dhe koordinon me institucionet e nivelit qendror. Gjithashtu, Komisioni për riintegrim komunal (KRK) merret me kërkesa për asistencë emergjente për të cilën mund të aplikojnë të kthyerit. Në përgjithësi, siç është theksuar, korniza ligjore që krijon sistemin është koncentruar vetëm në ndihmesë për kthim, përderisa roli i institucioneve përgjegjëse për riintegrimin është parashikuar në Strategjinë Nacionale për Riintegrim. Më tej, përderisa drejtoratet e ndryshme të nivelit komunal janë përfshirë në Strategjinë Nacionale për Riintegrim, QPS nuk është involvuar drejtëpërdrejtë për sa i përket mbrojtjes së fëmijës. Duke pasur parasysh faktin se procesi i kthimit mund të jetë traumatik për fëmijët dhe të rriturit e përfshirë në proces, nëse një gjë e tillë nuk merret parasysh në mënyrë efektive kjo mund të rezultojë si problematike pasi që i bën fëmijët e tillë edhe më të pambrojtur.

---

[168] Neni 42, Ligji mbi Azilin

[169] Neni 47 dhe 48, Ligji mbi azilin

[170] Kapitulli II, Ibid

[171] Kapitulli 14, Ibid

[172] Kapitulli 6, AI 11/2009

[173] Minsitria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

[174] Strategjia Nacionale për Riintegrim, pp.15-16

[175] Strategjia Nacionale për Riintegrim, f. 16

VI. Profili i fëmijëve në lëvizje në Kosovë

FnL në Kosovë, ashtu siç përcaktohet me definicionet e adaptuara në baza ndërkombëtare mbulon shumë grupe të fëmijëve të cilët kanë një të përbashkët – janë zhvendosur ose jetojnë në lëvizje. Kërkimet, sidomos ato të zhvilluara në nivel ndërkombëtar ofrojnë një shpjegim gjithëpërfshirës të karakteristikave kryesore, cenueshmërisë dhe mundësive jetësore të FnL që janë relevante për FnL në Kosovë. Fëmijët e identifikuar në këtë studim i takojnë tri grupeve të FnL:

- *Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës* (që jetojnë me prindërit e tyre dhe shpeshherë për shkak të kushteve të tilla detyrohen të punojnë ose të kërkojnë lëmoshë në rrugë);
- *Fëmijët në lëvizje gjatë ditës* (këta fëmijë udhëtojnë prej komunës në komunë për të grumbulluar kanaqe, metale apo për të kërkuar lëmoshë)
- *Fëmijët e trafikuar ose ata në rrezik të trafikimit*
- *Fëmijët e kthyer (migrues)* dhe
- *Fëmijët azil-kërkues.*

Analizat e intervistave, vrojtimeve dhe diskutimet e hapura në grup kanë shpalosur se këto grupe të fëmijëve ndajnë shumë karakteristika të përbashkëta. Megjithatë, për shkak të rrethanave të tyre, arsyeve për lëvizje dhe përvojave jetësore që janë të ndryshme, është e vështirë të përshkruhen ato në mënyrën " një masë për të gjitha". Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës dhe ata që janë në lëvizje gjatë ditës kanë më tepër karakteristika të përbashkëta; për këtë shkak ata do të përshkruhen së bashku. Edhe pse ka ngjashmëri me fëmijët e kthyer, ata gjithashtu janë të ndryshëm sidomos në aspektin e perceptimit të tyre se si ka ndikuar lëvizja në jetërat e tyre dhe si i tillë është e rëndësishme që pikëpamjet e tyre të portretizohen në veçanti. Përveç kësaj, ky studim gjithashtu ka gjetur raste të familjeve të tëra që do të mund të klasifikoheshin si familje në lëvizje dhe sit ë tilla është me rëndësi të përshkruhen dhe të analizohet situata sidomos në lidhje me fëmijët e tyre, të cilët janë të involvuar në aktivitete të ndryshme. Në fund, dy nën-seksione detajojnë vrojtimet dhe fokusohen në diskutimet që janë zhvilluar në grup e që ofrojnë më tepër informata.

1. Profili i FnL: Fëmijët flasin

Në njohjen e të drejtave të fëmijëve për pjesëmarrje, ky kërkim ka adaptuar qasjen pjesëmarrëse të fëmijës ku pikëpamjet e fëmijës zënë vend të tejet të rëndësishëm pasi që janë të pozicionuara ashtu që të shpjegojnë situatën e tyre më së miri gjersa janë në lëvizje, motivimin e tyre, problemet me të cilat janë ballafaquar dhe mënyrën se si e shohin vehten. Në këtë mënyrë janë zhvilluar intervista me 39 fëmijë në qytetet kryesore të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Fushë Kosovën, Pejën, Gjakovën, Ferizajin dhe Mitrovicën. Përderisa mostra është e vogël, intervistat janë detajuar dhe siç paraqitet më poshtë ato sigurojnë një informatë të rëndësishme në lidhje me cënueshmërinë e tyre si dhe shpresat e ëndrrat.

a. Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës dhe/ose që janë në lëvizje gjatë ditës

Fëmijët të cilët hyjnë në këto kategori kanë një karakteristikë të përbashkët, që është se të gjithë vijnë prej familjeve të cilat janë tejet të varfëra, pasi çdo ditë së bashku me prindërit e tyre ata luftojnë të mbijetojnë. Si rezultat i situatës në të cilën ata e kanë gjetur vehten, ata duhet të braktisin fëmijërinë e tyre dhe të gjejnë mënyra se si të fitojnë para për vete apo të kontribuojnë në buxhetin familjar me qëllim të mbijetesës. Ata veprojnë kështu pëmes mënyrave të ndryshme duke përfshirë kërkimin e lëmoshës në rrugë, pastrimin e xhamave të veturave në udhëkryqe, mbledhjen e mbeturinave metalike të cilat i shesin më vonë, kërkimin në kontejnerë mbeturinash për të gjetur artikuj të cilët ata mund ti shesin ose përdorin, ose shesin mallra të ndryshme sikurse kikirikë, gomë përtypëse ose duhan në kafeteri.

i. Të jesh i detyruar të kërkosh lëmoshë

RI është vajzë 12 vjeçare, e cila jeton në shtëpi me prindërit e saj dhe 7 vëllezër e motra. Qysh prej fillimit të intervistës ajo ishte shumë e rezervuar dhe e strukur, rrobet e saja janë të pista dhe duket se frikësohet të përgjigjet në pyetje. Kur është pyetur për FnL, ajo thotë “Nuk e di se çka do të thotë kjo”, edhe pse ajo shton se “ndonjëherë është mirë të shkoj në qytet sepse mund të fitoj më tepër para prej kërkim lëmoshës, njerëzit më japin më tepër para”. Në baza të përditshme “unë shkoj në shkollë mirëpo shpeshherë nuk mund të jem e rregullt dhe pastaj mbetem prapa me mësime ”. Ajo poashtu shton “I bëj detyrat dhe kërkoj lëmoshë dhe me paratë e fituara ne blejmë rrobe dhe ushqim”. Prej sjelljes së saj është më se e qartë se ajo nuk e pëlqen këtë mënyrë të jetesës dhe më pas shton “nëna ime më detyron të kërkoj lëmoshë, ajo ndonjëherë më zëvendëson me vëllaun tim të vogël dhe nëse nuk i bindem atëherë ajo më rrah”. Në rastin e RI nuk është vetëm situate ekonomike problematike por edhe sjellja e nënës së saj që tregon se ajo abuzohet prej nënës. Përderisa ky rast shpalosë se forca është një element në kërkim lëmoshe është me rëndësi që secili rast të trajtohet në baza individuale pasi që ky element nuk reflektohet në të gjitha rastet. Megjithatë, ky është një element i përshtatshëm për këtë rast dhe autoritetet duhet ta përdorin për të koordinuar veprimet.

ii. Të jesh i varfër

AH, është një vajzë 10 vjeçare Rome që jeton në qytetin e Pejës. . Ajo jeton me prindërit e saj dhe 6 motra e vëllezër. Motra e saj më e madhe, e cila është 17 vjeçare, është e martuar përderisa të tjerët janë të moshës prej 10-17. Për shkak të kushteve të rënda të jetesës dhe mungesës së asistencës financiare, AH thotë “ të gjithë ne, fëmijët, kërkojmë lëmoshë”. AH gjithashtu thotë se ka problem me sy dhe se ka shkuar tek mjeku. Ndërsa, përshtypja e intervistuesit ishte se

rrethanat financiare të familjes ishin shumë të këqia dhe duke i lejuar fëmijëve të kërkojnë lëmoshë prindërit janë neglizhent; ky rast ndryshon pasi nuk përdoret detyrimi me forcë. Ngjajshëm me këtë është rasti i *LH, një djali 15 vjeçar Rom prej Pejës.* Ai thotë "Unë jetoj me familjen time dhe me 8 vëllezër e motra të moshës 7-22". Ai thotë se të gjithë fëmijët në këtë familje kërkojnë lëmoshë pasi babai i tyre është operuar në zemër dhe ka pasur edhe asmën dhe nëna e tij gjithmonë ankohet prej dhimbjeve në stomak. Për sa i përket përkrahjes, LH thotë se familja e tij merr asistencë sociale mirëpo " ne nuk kemi mjaftueshëm për të gjithë kështu që kërkojmë lëmoshë". Nëna e tij gjithashtu pritet të operohet. Është më rëndësi të theksojmë se këto raste tregojnë situata të keqësuara ku prindërit kanë problem shëndetësore dhe mund të mos jenë në pozitë të ofrojnë kujdesin e domosdoshëm për fëmijët e tyre.

Rrethanat e vështira dhe varfëria është prezente në shumë komuna kudo në Kosovë. *AN, është djal 16 vjeçar nga Gjakova*. Pas vdekjes së babait, edhe pse ishte vetëm fëmijë ai thotë "Unë duhet të kujdesem për familjen time dhe e bëj këtë duke shitur duhan në kafiteri dhe restorane". Ai vazhdon duke shpjeguar "është punë e vështirë, pasi më duhet të udhëtoj prej Gjakovës në Pejë çdo ditë mirëpo nuk ka diçka tjetër që do të mund të bëja". Ngjashëm, *VJ është djalosh 14 vjeçar, Shqiptar nga Podujeva*. Ai thotë "Unë jam i vetmi që punoj në familjen time" familje 7 anëtarëshe, edhe ose ai nuk dëshiron të japë më tepër detaje. Prej qëndrimit të tij dhe shpjegimeve, hulumtuesi ka pasur përshtypjen se kushtet socio-ekonomike të familjes janë tejet të këqia. Si rezultat, VJ udhëton në Prishtinë prej Podujevës, për çdo ditë dhe punon deri vonë duke shitur duhan, zakonisht deri në 22:00.

iii. Të qenit dinjitoz dhe krenar

Ky është rasti i *BB, një djali 8 vjeçar, i cili jeton në shtëpi me prindërit e tij dhe 3 fëmijë tjerë.* Sipas tij, FnL janë "fëmijët në rrugë", edhe pse ai nuk e di se prej nga vijnë ata. Pasi që BB nuk kërkon lëmoshë, ai shpjegon " unë nuk kërkoj lëmoshë dhe jetoj me prindërit e mi" kështu që nuk jam FnL. Në të njejtën kohë ai pranon se " ndonjëherë" është mirë të shkosh diku tjetër mirëpo nuk e dinte pse. Megjithatë, aktivitetet e përditshme të BB janë të rëndësishme të përmenden për qëllime të këtij raporti. Kur është pyetur se çka bën çdo ditë ai thotë se ai nuk shkon në shkollë por "gjatë disa ditëve unë mbledhë shishe prej kontejnerëve të mbeturinave", "Ndonjëherë mbledh vetëm ndonjëherë me babain tim dhe më pas i shes ato shishe. Ai vazhdon duke thënë" unë lodhem prej kësaj pune dhe nuk më pëlqen të vazhdoj kështu por më duhet sepse kështu fitoj para për bukë ".

Për shkak të situatës së vështirë financiare të familjes së tij, si 8 vjeçar që është BB duhet të mendojë për mënyrat se si do të fitojë para me qëllim që të blejë ushqim për vehte dhe familjarët e tij. Në një moshë aq të re, shëndeti i tij fizik është prekur definitivisht prej një punë të tillë, e

poashtu edhe shëndeti i tij mental dhe vetëbesimi. Në të njejtën kohë, ai nuk e vijon procesin mësimor dhe kjo do të ndikojë në masë të madhe në mundësitë e tij jetësore. Është më se e dukshme se ai nuk është i lumtur për këtë, ai ishte shumë i rezervuar dhe nuk dëshironte të hynte në detaje por duket se sheh më tepër krenari në këtë punë se sa në kërkim lëmoshe dhe ky është një aspekt i rëndësishëm që ndërlidhet me këtë djalosh të ri. Gjithshtu, duhet të theksojmë se përkundër rrethanave të vështira me të cilat ballafaqohet ai dhe familja e tij. Ai thotë "është vetëm Idea Partnership që na ndihmon me rrobe, arsimim dhe higjienë".

iv. A jam unë FnL?

Në të njejtën kohë, përkundër ngjashmërisë së varfërisë që është prezente në shumicën e rasteve , ka dallime sidomos në mënyrën se si e shohin veten këta fëmijë bazuar në aktivitetin të cilin e zhvillojnë. Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve jo domosdoshmërisht e shohin vehten në kategorinë e FnL. Kjo është më se e dukshme tek fëmijët të cilët jetopjnë në shtëpi dhe e shohin këtë si strehimore, si dhe ata që nuk kërkojnë lëmoshë dhe në një mënyrë e shohin kontributin e tyre si diçka të domosdoshme mirëpo gjithashtu janë krenarë se janë në gjendje të kontribuojnë.

Për shembull, *AA është djalosh 10 vjeçar, jeton me prindërit dhe 9 vëllezër e motra në një shtëpi të vogël.* AA thotë se FnL "janë fëmijët të cilët shkojnë në vende tjera", edhe pse ai nuk e di pse, megjithatë vazhdon të shpjegojë "Unë nuk jam një nga ata, unë kam shtëpi dhe nuk kërkoj lëmoshë". Për më tepër, ai shton se " ndonjëherë" është mirë për fëmijët të shkojnë diku tjetër mirëpo nuk e di arsyen pse. Kur pyetet se cka bën çdo ditë ai thotë "Unë shkoj në shkollë por gjithashtu shkoj vetëm të mbledhë metale". Kur u pyet se çka bën me metale ai thotë "I shes ato dhe ia japë paratë babait ". Ai shton "mua më duhet të punoj kështu dhe njoh shumë fëmijë tjerë të cilët punojnë ngjashëm". Ai thotë se i njeh rreth 50 fëmijë tjerë sikurse është ai, që janë vajza e djem por edhe gra. Përkundër kushteve të këqia të familjes së AA e vetmja asistencë që ai e pranon është prej OJQ-së lokale Ideas Partnership të cilët ndihmojnë me rrobe dhe gjëra tjera.

Përveç që e konsiderojnë shtëpinë si faktor dallues, disa fëmijë janë gjithashtu në lëvizje prej kohë pas kohe, varësisht prej rrethanave të familjes së tyre dhe për shkak të natyrës së përkohshme të lëvizjes së tyre, ata mund të mendojnë se ata nuk janë në lëvizje. Për shembull *GB është djalë 9 vjeçar që jeton në shtëpi me prindërit dhe 8 vëllezër e motra.* Ai thotë se FnL janë "ata fëmijë të cilët nuk kanë shtëpi ose prindër dhe jetojnë në rrugë dhe shkojnë prej një vendi në tjetrin ". Ai thotë "zakonisht ata fëmijë vijnë prej vendeve tjera" mirëpo nuk e di prej nga dhe shton " unë nuk e shoh vehten ashtu sepse une kam shtëpi. Në ndërkohë, ai mendon "ndonjëherë është mirë të shkosh në vende tjera, t'i shohësh ato". Në baza të përditshme ai vijon procesin mësimor mirëpo ai gjithashtu thotë " ndonjëherë unë mbledhë metale, kanaqe dhe shishe dhe i shes ato me shokët e m. Ai lë të kuptojë se ai nuk është i detyruar të punojë mirëpo ai njeh edhe së paku 50 fëmijë tjerë të cilët janë të angazhuar në të njejtin aktivitet sikurse ai, e

këta fëmijë janë djem e vajza. Edhe njëherë për sa i përket asistencës së pranuar ai thotë se vetëm IDEAS Partnership e ndihmon me rroba dhe ushqim.

v. Të dëshirosh një të ardhme më të mirë

Një diferencë tjetër është se FnL mund të angazhohet në aktivitete të tilla me qëllim të përmirësimit të jetës së tyre ose situatës së familjes, edhe nëse nuk janë në varfëri të skajshme. Për shembull *AG, është një djalë 15 vjeçar prej një fshati afër Podujevës,* i cili gjatë muajve të verës së bashku me vëllaun e tij vjen të jetojë në Prishtinë. Përderisa thotë se e vijon rregullisht procesin mësimor, ai gjithashtu shet duhan sepse familja e tij është duke ndërtuar shtëpinë kështu që ai duhet të kontribuojë. Ai vazhdon të shpjegojë se babai i tij është fermer dhe se ata nuk pranojnë ndonjë asistencë sociale kështu që atij i duhet të gjejë mënyrën e kontribuimit dhe së bashku me vëllaun e tij HG, i cili është 17 vjeçar, shesin duhan kryesisht në Prishtinë, në kafeteri dhe restorane. Ngjajshëm, *EB është vajzë 12 vjeçare Shqiptare, që vjen nga Prishtina.* Ajo jeton me nënën e saj e cila punon si pastruese dhe dy vëllezër të cilët gjithashtu punojnë. EB thotë "se janë duke ndërtuar shtëpinë me ndihmën e kushërinjëve" dhe se ajo shet gomë përtypëse në kafeteri dhe restorane për të kontribuar. Ajo gjithashtu thotë "unë shkoj në shkollë dhe e pëlqej shumë, jam nxënëse e shkëlqyeshme dhe kam dëshirë të shkoj në kursin e gjuhës angleze". Përveç fitimit nga shitja dhe mbështetjes familjare ata nuk pranojnë ndonjë asistencë tjetër.

vi. Të jesh fëmijë dhe të luash

Gjithmonë në ndërlidhje me varfërinë që i prekë familjet në Kosovë, shumë fëmijë nuk kanë mundësi të gëzojnë fëmijërinë e tyre; të luajnë, të takohen me shokë dhe të gëzojnë aktivitetet e ndryshme jashtëprogramore në të cilat kanë qasje moshatarët e tyre. Si rezultat, ka gjithashtu fëmijë të cilët mund të shihen si fëmijë jashtë mjedisit të tyre mbrojtës për shkak të aktiviteteve në të cilat angazhohen dhe rreziqeve me të cilat përballen, edhe pse motivimi i tyre është të sigurohet se ata krijojnë mundësi për vete, për zhvillimin e tyre dhe thjeshtë argëtohen me të qenit fëmijë. Është më rëndësi të theksojmë se këta fëmijë jo domosdoshmërisht e shohin vehten si fëmijë në lëvizje. Për shembull *SA, është djalë 13 vjeçar, Ashkali, që jeton në shtëpi me prindërit e tij dhe me 8 vëllezër e motra.* Sipas SA, FnL "janë fëmijë që shkojnë në vende tjera" dhe ai ka dëgjuar se "FnL vijnë nga Shqipëria". Përderisa ai nuk e sheh veten si FnL, siç thotë ai " unë jam këtu dhe jetoj në këtë qytet" dhe " do të ishte mirë nëse mund të shkoj diku tjetër, nëse kam para". Përderisa vazhdon intervista e gjysëm strukturuar me SA, ai tregon se edhe pse vijon shkollën, ai mbledhë metale dhe i shet ato me qëllim që të luajë biliardo dhe kur e pyesim se sa fëmijë i njeh që veprojnë sikurse ai, përgjigjet "50".

vii. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë

Meqenëse këta fëmijë kryejnë aktivitetet e tilla, një veçori tjetër e përbashkët e tyre janë rreziqet me të cilat ata ballafaqohen. Përderisa me çdo aktivitet, rreziqet të cilave një fëmijë i caktuar mund t'i ekspozohet mund të ndryshojnë, kryesisht kur ata kryejnë aktivitetet e tilla, shëndeti i tyre fizik, mendor dhe emocional është në rrezik për shkak faktorëve të ndryshëm. Për më tepër, përkundër fizibilitetit të gjerë të tyre, përderisa kryejnë aktivitetet e tyre në qytetet kryesore dhe duke qenë në zonat e shumë frekuentuara nga pjesëtarët e publikut, si dhe ata që punojnë për institucione duke përfshirë fuqizimin e ligjit, kryesisht gjendja e tyre duket të jetë e injoruar.

FB është një djalë 11 vjeçar, i cili jeton me prindërit e tij dhe 3 vëllezërit dhe motrat e tij. Ai thotë FL "janë fëmijët që ne i shohim në rrugë", që ata vijnë "nga vende të ndryshme", edhe pse ai nuk e konsideron veten të jetë njëri nga ta sepse ai thotë "Unë kam shtëpi dhe jetoj me familje". Në të njëjtën kohë ai mendon të shkoj diku tjetër "është mirë por jo shumë larg dhe jo vetëm". Kur e pyetëm për aktivitetet e tij çdo ditore ai thotë se " Unë mbledh kanaçe dhe shishe me vëllanë tim dhe ndonjëherë shkojmë në pjesë të tjera të qytetit, unë gjithashtu shkoj në shkollë por shpesh nuk shkoj sepse kam migrenë". Ai vazhdon duke shpjeguar, " Unë sapo u ktheva nga spitali….Kam qëndruar një muaj. Kur jam në dhembje të tilla, unë nuk mund ta përballoj , ….më duket se tërë dhoma sillet rreth meje". Gjithashtu, kur është pyetur se a e njeh ai ndonjë FL tjetër, ai thotë "shumë", ndonëse shumica djem ndonjëherë ka edhe vajza. Përshkrimi i FB i problemeve të shëndetit të tij për një djalë 11 vjeçar janë shumë serioze dhe duke qenë i përfshirë në mbledhjen e kanaqeve ai i ekspozohet të gjitha llojeve të rreziqeve përfshirë edhe tymin, helmet dhe bakteret që mund të jenë prezentë në kanaçe dhe mund të kenë efekt të drejtpërdrejt në shëndetin e tij. Për më tepër, migrena që ai po e përjeton mund të jetë shenjë e një gjendje serioze të shëndetit dhe nëse vazhdon me aktivitetet e tilla ka gjasa që shëndeti i tij do të shkatërrohet edhe më tej, si dhe do të ndikoj në aftësinë e tij për të vazhduar arsimimin e tij.

viii. Arsimimi

Të ndihmosh fëmijët në një moshë të njomë do të thotë që shumë prej FL humbin të drejtën e të qenit fëmijë gjë që do të ndikojë në masë të madhe në mundësitë e tij në jetë. Edhe në rastet kur këta fëmijë kanë dëshirë të ndjekin shkollën, të qenët i varfër nënkupton që është e pamundshme për ta që vetë ta realizojnë këtë ëndërr pa ndihmën e të rriturve. Për shembull *AF, është një vajzë 7 vjeçare e etnisë shqiptare nga Peja.* Ajo jeton me prindërit e saj dhe vëllanë e saj i cili është 6

vjeçar. AF thotë që " çdo ditë, unë jam në rrugë duke kërkuar lëmoshë për ta mbështetur familjen time". Ajo vazhdon të tregoj se kur ajo kishte disa probleme shëndetësore, ajo i ishte nënshtruar trajtimit mjekësor në shtëpinë e shëndetit, por përveç kësaj ata nuk marrin ndonjë mbështetje tjetër. Babai i saj thotë ajo kontrollon koshat e mbeturinave për të mbledhur alumin, të cilin ai pastaj e shet. Sidoqoftë, përkundër përpjekjeve të tyre, ata prapë mundohen të jetojnë një jetë të dinjitetshme. AF vazhdon të thotë "Unë kurrë nuk kam qenë në shkollë por me të vërtetë do të dëshiroja të shkoj". Edhe pse në këto rrethana pa ndonjë mbështetje specifike nuk ka gjasa që ajo do të jetë në gjendje që të realizoj ëndrrën e saj vetëm.

AB, një vajzë 9 vjeçare me origjinë rome nga Fushë Kosova është në një pozitë të ngjashme. Ajo jeton me prindërit e saj dhe vëllanë dhe motrën e saj, vëllai i saj është 3 vjeçar ndërsa motra është 7 vjeçare. Ajo vazhdon të shpjegojë jetën e familjes së saj si në vijim "babai im nuk punon, nëna ime mbledh kanaqe ndërsa unë kërkoj lëmoshë".Për t'i kontribuar të ardhurave të familjes së saj përmes kërkimit lëmoshë ajo vjen në Prishtinë për ta bërë atë. Ajo gjithashtu thotë se "Unë nuk ndjekë shkollën por do të dëshiroja ta bëja", edhe pse në këto rrethana pa ndonjë lloj ndihme do të ishte e vështirë që ajo ta bëj atë. Një fëmijë tjetër me të njëjtat iniciale *AB, është 10 vjeçar, një djalë shqiptar nga Lezha, Shqipëria.* Ai thotë "familja ime dhe unë jemi zhvendosur në Kosovë që nga viti 2012 dhe ne kemi dokumente për këtu". Babai i tij pastron këpucë në shesh, ndërsa AB i qëndron afër. Familja nuk merr ndonjë asistencë sociale, ata paguajnë vet qiranë e tyre, dhe ai asnjëherë nuk e ka ndjek mësimin.

Rëndësia dhe qasja ende e paqëndrueshme në arsimim të FnL është portretizuar më tej me rastin e *FB një vajzë 11 vjeçare, e cila jeton me prindërit dhe 3 vëllezërit e saj ku me njërin prej tyre është binjak.* Përderisa FB është shumë miqësore, ajo gjithashtu është e druajtur kur i parashtrohen pyetje ajo ose ofron përgjigje shumë të shkurta ose kur nuk dëshiron të përgjigjet ajo buzëqeshë. FB nuk duket të jetë në dijeni për FL dhe për atë se çfarë ata bëjnë; ajo thotë se "është mirë që të shkoj diku tjetër që të vizitojë të afërmit dhe vendet e tjera". Kur pyetët për aktivitetet e saja ditore ajo thotë " Unë shkoj për të mbledhur shishe tek hedhurinat me vëllanë tim binjak dhe, tjera herë, unë qëndroj në shtëpi me prindërit dhe vëllezërit e mi". Ajo vazhdon duke thënë se "Unë nuk ndjekë shkollën, kam ndaluar së ndjekuri atë në klasën e 3-të dhe nuk mund të kthehem prapa". Sidoqoftë, është e qartë se ajo u kënaq dhe se i mungon shkolla ashtu siç thotë ajo "Do të dëshiroja të kthehem në shkollë por jam shumë prapa". Sa i përket fëmijëve të tjerë, ajo thotë se i njeh 5 djemë që mbledhin kanaçe sikurse ajo dhe vëllai i saj që mbledhin. Ndërsa sa i përket asistencës, ngjashëm me fëmijët e tjerë ajo thotë se Ideas Partnership ndihmon me veshmbathje, arsimim dhe higjienë.

b. Fëmijët nga Shqipëria

Nga një hulumtim i kryer është e qartë se fëmijët nga Shqipëria janë gjithashtu jashtë mjedisit të mbrojtur ose në rastet potencialisht të trafikuara dhe ata ndajnë karakteristika me FL nga Kosova, veçanërisht fakti që ata gjithashtu ballafaqohen me varfërinë dhe që mundohen për mbijetesë. Në shumë instanca është kjo situatë e varfërisë që i ka detyruar ata të zhvendosen në rastet e kërkimit të lëmoshës.

i. Shëndeti dhe siguria

BZ, është një djalë 8 vjeçar nga Tirana, Shqipëria. Përderisa nuk është e qartë se për sa kohë ai ka qenë në Prishtinë, ai thotë se zakonisht ai pastron xhamat e përparmë të veturave gjatë pritjes në semafor afër mensës së studentëve në Prishtinë, që është një udhëkryq i frekuentuar. Gjatë intervistës, kur ai pyetët për prindërit e tij, BZ nuk ndihet rehat mbi atë për çfarë pyetët dhe tregon se ai nuk dëshiron të vazhdoj intervistën, në të cilën pikë intervista ndërpritet. Përkundër diskutimit të shkurtë që është kryer është e qartë se BZ e vë vetën në një rrezik serioz duke u munduar që të pastroj xhamat e përparmë të veturave dhe në të njëjtën kohë duhet të gjej mënyra për t'iu shmangur veturave që kalojnë në udhëkryq me shpejtësi të lartë. Ky lloj aktiviteti jo vetëm që e vë atë në rrezik serioz por edhe nuk i ofron atij të ardhura, sepse herë pas herë ai është parë të pastroj xhamat e tillë por që asgjë nuk i është dhënë atij në shkëmbim.

ii. Varfëria

SP është një vajzë 11 vjeçare, nga Durrësi, Shqipëria. Ajo ka dy motra, EP është 12 vjeçare dhe KP është 2 vjeçare, si dhe një vëlla 11 vjeçar. Gjatë kohës së hulumtimit, ata janë gjetur në Pejë. SP së bashku me motrat dhe vëllanë e saj sqarojnë se gjatë 2 viteve të fundit ata kanë lëvizur nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas. Një herë janë depërtuar në Shqipëri por ata janë kthyer prapë në Kosovë. Ajo thotë "nuk ka asgjë në Shqipëri, atje nuk fitojmë asgjë, ndërsa këtu ne fitojmë para duke kërkuar lëmoshë". Përderisa ata kanë qëndruar në Kosovë, ata sqarojnë se si familje, ata jetojnë në një zonë të qytetit me familje tjera që janë të angazhuara në aktivitetet të ngjashme dhe ku kushtet janë shumë të këqija.

Mungesa e mbështetjes shtetërore si dhe zemërgjerësia e kosovarëve ceket gjithashtu si motivim nga *RD, një djalë 12 vjeçar nga Tirana, Shqipëria*. Ai ka arritur në Prishtinë në qershor të vitit 2013, së bashku me motrën e tij (5 vjeçare) dhe vëllanë (6 vjeçar), edhe pse pa prindërit e tyre.

Në Prishtinë RD thotë “ne jetojmë me një familje tjetër dhe prindërit tanë jetojnë në Shqipëri”. Ai vazhdon të sqaroj se edhe në Shqipëri ata kanë bërë të njëjtën gjë, duke kërkuar lëmoshë pa ndonjë mbështetje shtetërore. Për Kosovën RD thotë “njerëzit këtu janë më të mirë dhe më zemërgjerë”. Si fëmija më i madh, ai duket të merr rolin e kujdestarit për motrën edhe vëllanë e tij dhe ende asnjëri prej fëmijëve nuk është regjistruar në shkollë apo nuk ka ndjekë mësimin.

iii. Gjetja e mënyrave për t’u kthyer

Një karakteristikë e rëndësishme tek FnL shqiptarë në Kosovë ku përmes mënyrave të ndryshme ata duken që të jenë në gjendje që të qëndrojnë në periudha relativisht të gjata kohore pa u zbuluar nga autoritetet përkatëse ose në rastet e të kthyerve të ndihmuar, ata gjejnë mënyra që të kthehen në Kosovë. Për shembull, AM, *është një djalë 9 vjeçar nga Fieri, Shqipëria*. Ai thotë se ka qenë në Shqipëri për së paku 4 vite me prindërit e tij por “rreth një javë më parë babai im u kthye në Shqipëri”. Përderisa në Shqipëri, AM thotë “ Unë fillova të shkoj në shkollë por pastaj e ndërpreva”, edhe pse ai nuk thotë pse. Në Kosovë, ai kërkon lëmoshë ose mbledh të holla duke performuar. Kohë pas kohe AM thotë “ unë dhe prindërit e mijë kthehemi në Shqipëri por pastaj ne kthehemi në Kosovë prapë dhe ne nuk marrim ndonjë ndihmë nga ndonjëri”.

MF, një djalë 11 vjeçar nga Pogradeci, Shqipëria ka një storie të ngjashme. Ai ka qenë në Kosovë me familjen e tij për disa kohë, edhe pse ai nuk jep detaje specifike për hulumtuesit. Ai vazhdon duke sqaruar, sidoqoftë se, “dy ditë më parë, familja ime ishte dërguar në Shqipëri nga policia, por dje ne jemi kthyer”. Ai thotë se ata janë kthyer sepse nuk ka asgjë në Shqipëri për ta, ndërsa këtu ai mund të kërkoj lëmoshë dhe ata mund të mbijetojnë.

Ngjashëm, *TR është një vajzë 2 vjeç e gjysmë, gjithashtu e gjetur në Pejë me nënën e saj dhe tre motrat e saja (*MR, 13 vjeçare, NR, 4 e gjysmë vjeç dhe RR, 7 vjeçare) dhe një vëlla (FR, 12 vjeç). Ata janë nga Tirana, Shqipëria dhe janë të origjinës rome; edhe pse në kohën e hulumtimit ata janë gjetur në qendër të Pejës. Nëna ishte pjesë e diskutimit dhe së bashku me fëmijët ata sqarojnë se ata kërkojnë lëmoshë në pjesë të ndryshme të Pejës. Ata kanë bërë këtë për 3 vite, edhe pse ata kanë tendenca që të lëvizin prej Kosovës në Shqipëri dhe anasjelltas “ne qëndrojmë 3 muaj në Pejë dhe pastaj 3 muaj në Tiranë” sqaron nëna, gjë që fëmijët më të mëdhenj e konfirmojnë.

c. Të qenit në lëvizje si familje

Një veçori e përbashkët në FnL të caktuar në Kosovë (qoftë nëse ata janë prej Kosovës ose Shqipërisë) është se për shkak të rrethanave ekonomike ata detyrohen si familje të kërkojnë lëmoshë ose të angazhohen në aktivitetet tjera. Përkundër faktit se këta fëmijë janë me prindërit e

tyre kjo gjithashtu i ekspozon ata në një varg rreziqesh duke përfshirë ndikimin në mirëqenien e tyre fizike, mendore dhe emocionale.

EJ është një djalë 9 vjeçar i komunitetit Ashkali që jeton në Pejë. Së bashku me vëllanë e tij MJ, i cili është 10 vjeç dhe babanë e tyre ata mbledhin kanaçe në kosha të hedhurinave, që më vonë e shesin. Babai shpjegon se ata nuk marrin asistencë sociale dhe ata mundohen që t'ia dalin disi. Prandaj, ata janë të detyruar që të bëjnë këtë dhe ai sqaron se gruaja e tij dhe vajza e tyre LJ, që është 14 vjeç, kërkojnë lëmoshë që të kontribuojnë në përpjekjet e familjes për t'u ushqyer në baza ditore. Kjo situatë e familjes ilustron mirë shpërputhjen e skemës së asistencës sociale me qëllim të zbutjes së varfërisë dhe përfshirjes së më të varfërve. Kjo qëndron sepse edhe nëse kjo familje do të aplikonte për skemë, meqenëse nëna dhe babai janë në gjendje të punojnë por nuk mund të gjejnë punë, dhe nuk kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçe, ata nuk kanë të drejtën e asistencës. Si rezultat fëmijët nuk kanë kohë të jenë fëmijë, meqenëse ata duhet të kontribuojnë që të ushqehen në fund të ditës.

Ngjashëm, *SB është një djalë 8 vjeç nga Tirana, Shqipëria, që kërkon lëmoshë në Prishtinë, Kosovë.* Ai ka së bashku me nënën e tij, motrat e tij, BB (6 vjeçare) dhe AB (14 vjeçare); dhe vëllanë e tij FB (15 vjeçar). Zakonisht SB thotë "ne qëndrojmë së bashku por ndonjëherë ne ndahemi". Ata kanë jetuar në Prishtinë për 2 vite dhe kanë ardhur këtu për shkak të "kushteve të këqija në Shqipëri dhe njerëzit këtu janë më të mirë" thotë SB. Kur u pyet për aktivitetet ditore SB theksoi se asnjëri prej fëmijëve nuk është i regjistruar në shkollë as Shqipëri ose Kosovë dhe se nuk marrin ndihmë nga askush në asnjërin vend. Nëna, e cila iu bashkëngjit intervistës më vonë tha se ajo vuan nga shëndeti i ligë, ajo ka dhembje në stomak por nuk ka të holla që të kërkoj ndihmë mjekësore ose barna.

Sidoqoftë, edhe me asistencë sociale disa familje nuk janë në gjendje që të kenë një jetë të dinjitetshme siç u tregua nga kjo familje kosovare nga Gjakova që u intervistuan derisa po kërkonin lëmoshë në Pejë. Kjo nënë u gjet në rrugë me *MM, që është vetëm 7 muajsh*; ajo gjithashtu ka tre fëmijë tjerë; DM, 11 vjeç, LM, djalë 5 vjeçar dhe MM, djalë 13 vjeçar. Familja merr asistencë sociale dhe jeton në Gjakovë por që vijnë në Pejë për të kërkuar lëmoshë dhe ndonjëherë shkojnë në Prizren. Nëna sqaron se përkundër marrjes së disa vërejtjeve nga prokuri për kërkim lëmoshe, ata vazhdojnë këtë me fëmijët kryesisht në Pejë dhe Gjakovë, ndërsa burri kontrollon koshat e mbeturinave për të mbledhur materiale që mund të shes në Gjakovë. Është evidente që përkundër asistencës sociale që ata marrin ata mundohen për ekzistencë dhe janë në nevojë imediate për ushqim dhe veshmbathje. Për më tepër, përkundër të gjitha rreziqeve për të gjithë fëmijët, ata janë të detyruar që të vazhdojnë në mënyrë që të zbusin rrethanat ekstreme me të cilat ata ballafaqohen në sigurimin e ekzistencës së tyre.

Në një pozitë të ngjashme është një tjetër *familje shqiptare e intervistuar në Pejë, që po kërkonin lëmoshë.* Ata përfshinë MP, vajzë 11 vjeçare, GP, një djalë 7 vjeçar, PP, një djalë 12 vjeçar.

Fëmijët sqarojnë se ata janë këtu me nënën e tyre, ndërsa babai dhe vëllai tjetër janë ende në Shqipëri. MP thotë "ne kërkojmë lëmoshë këtu por kemi probleme me policinë". Fëmijët dhe nëna thonë se ata jetojnë me familje tjera në Pejë dhe nëna gjithashtu konfirmon se ata kanë hyrë në Kosovë ilegalisht. Sa i përket bashkëshortit të saj, ajo thotë se "ai nuk mund të gjej punë" prandaj ata kërkojnë lëmoshë për ekzistencë. Sa i përket arsimimit, kur u pyetën ata thonë se asnjëri prej fëmijëve asnjëherë nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë dhe kështu asnjëherë nuk kanë ndjekur mësimin. Është e qartë se ata gjithashtu ballafaqohen me rrethana të jashtëzakonshme dhe janë në nevojë imediate për ushqim dhe veshmbathje si dhe mbështetje shtesë sa i përket higjienës, strehimit të duhur dhe arsimimit për këta fëmijë.

Për më tepër, *EM është një vajzë 12 vjeçare e origjinës rome nga Gjakova.* Ajo vuan nga shëndeti i ligë, edhe pse nuk është krejtësisht e qartë se çfarë diagnoze/shkaktar ka. Ajo shoqërohet nga gjyshja e saj, e cila sqaron se ajo nuk mund të dëgjoj ose flasë. Gjyshja sqaron se EM i është nënshtruar më parë një ndërhyrje kirurgjike dhe pret që t'i nënshtrohet një trajtimi të mëtejmë. Në familje, janë 8 fëmijë në mes të moshës 3 – 13 vjeçare dhe të dy prindërit janë të papunësuar. Përderisa familja merr asistencë sociale, si dhe mbështetje specifike për EM për shkak të gjendjes së saj, ata ende bëjnë përpjekje që t'ia dalin me të gjitha shpenzimet për jetesë. Si rezultat, gjyshja dhe EM rregullisht dalin në rrugë për të kërkuar lëmoshë.

d. Fëmijët e kthyer

Në krahasim me fëmijët që janë jashtë mjedisit mbrojtës, përderisa fëmijët e kthyer ndajnë disa karakteristika të ngjashme, kanë gjithashtu edhe disa dallime. Një nga ngjashmëritë kryesore është fakti që këta fëmijë po ballafaqohen me rrethana të vështira në lidhje me integrimin për shkak të vendimmarrjes që ishte marrë nga të rriturit përkitazi të rriturve (prindërit e tyre) në vendin nikoqir. Në shumë mënyra, kjo është e ngjashme me fëmijët jashtë mjedisit mbrojtës që humbin fëmijërinë e tyre për shkak se të rriturit ose prindërit ose institucionet ose nuk janë në gjendje ose nuk shprehin gatishmëri për të përmbushur obligimet e tyre për të ofruar kujdes të mjaftueshëm për këta fëmijë dhe për t'iu lejuar atyre që thjeshtë të jenë fëmijë, që të mund të kënaqen me fëmijërinë e tyre. Një ngjashmëri tjetër është fakti që me kthimin e tyre, disa prej këtyre fëmijëve janë lënë jashtë sistemit, në veçanti, ata nuk janë në arsimim të rregullt, e që për fëmijët jashtë mjedisit mbrojtës ndikon shumë në mundësitë e mëvonshme në jetë.

i. Vështirësitë në integrim

Rasti i EM, *një vajzë 10 vjeçare e etnisë shqiptare, që jeton në një shtëpi me qira me familjen e saj, prindërit dhe 6 motrat dhe vëllezërit e saj* më së miri ilustron këtë situatë. Ajo thotë, FnL janë "fëmijë që lëvizin nga vendi në vend dhe ata vijnë nga Gjermania dhe vendet tjera". Kur u

pyet se a hynë ajo në kategorinë e FL ajo u përgjigj "po unë hyj, unë u ktheva nga Gjermania dhe nuk më pëlqen këtu, do të dëshiroja të kthehem prapë atje" dhe se ajo njeh së paku 10 fëmijë të tjerë në situatë të ngjashme. Kur u pyet nëse është mirë ose keq që të shkoj diku tjetër, ajo u përgjigj "po në Gjermani". Sa i përket aktiviteteve ditore, EM thotë "Unë nuk ndjek shkollën sepse kam probleme me gjuhën shqipe dhe vendosa mos të shkoj sepse nuk më pëlqen". Në vend të kësaj ajo i ndihmon nënës së saj në shtëpi dhe ndonjëherë ajo del për argëtim. Sa i përket asistencës, komuna ka ndihmuar familjen në akomodim. Përgjatë intervistës, ajo ishte e shumë e ndrojtur dhe e rezervuar, gjithashtu meqë gjuha e saj shqipe nuk ishte aq e mirë ajo ndjehej disi jo rehat.

Ngjashëm, *BB dhe CB janë vajza rome të moshës 15 dhe 17 vjeçare që janë kthyer nga Italia* që kanë lindur në Itali dhe ballafaqohen me situatë të ngjashme. Ato jetojnë me prindërit e tyre dhe vëllezërit dhe motrat si dhe nuk dalin shumë për shkak të pengesës me gjuhë; ata nuk flasin asnjë nga gjuhët nacionale mirë. BB thotë "ne qëndrojmë të shumtën e kohës në shtëpi, duke shikuar televizionin dhe duke përdorur Facebook-un. Motra ime dhe unë ndonjëherë shkojmë të blejmë gjëra për shtëpi dhe përmes Facebook-ut unë jam në kontakt me shoqet e mija në Itali". Ata ndihmohen nga komuna sa i përket ushqimit dhe qirasë dhe Tdh ka siguruar për ta veshmbathje dhe mbështetje tjetër materiale. Për shkak të pengesave të gjuhës, çështja e FL nuk diskutohet gjerësisht. Gjithashtu ata janë kthyer rishtazi dhe ende nuk janë përshtatur me mjedisin të cilin nuk e kanë parë më parë. Përvoja traumatike të cilën e kanë përjetuar ilustrohet nga BB kur ajo thotë "e tëra që dëshiroj është që të kthehem në Itali". Asnjë nga fëmijët nuk shkojnë në shkollë dhe në fakt do të ishte e vështirë ta bëjnë këtë pa mbështetje substanciale përkitazi pengesës me gjuhë, si dhe shoku kulturor që po e përjetojnë ata, meqë ka shumë çka në shoqërinë kosovare me të cilën ato mund të ndërlidhen. Që të dyja BB dhe DB ishin mjaftë të tërhequra dhe nuk dëshirojnë të hyjnë në detaje lidhur me përvojat si FL. Në fakt BB ishte kohë pas kohe pak më e gatshme**,** ndërsa DB, përkundër asaj që ishte më e vjetër se ajo dukej se vetëm po pajtohej me BB.

ii. A jam unë një FnL?

Një ngjashmëri tjetër është fakti që disa fëmijë të kthyer nuk e shohin veten si FL për shkak se ata jetojnë në shtëpi, fakti që ata nuk kërkojnë lëmoshë në rrugë ose fakti që ata kanë një pikëpamje të bindur për FL duke iu referuar vetëm lëvizjeve përgjatë kufijve. Për shembull *IH është një djalë 12 vjeçar i etnisë shqiptare*, i lindur në Gjermani dhe pasi ka jetuar në Gjermani, Norvegji dhe Suedi ai u kthye në Kosovë rreth 5 – 6 vite më parë. Ai jeton në një shtëpi me prindërit dhe pesë motrat dhe vëllezërit që kanë lindur diku tjetër në Evropë dhe vetëm 2 në Kosovë. IH duket të ketë kuptuar konceptin e FL por nuk e konsideron veten të jetë në këtë kategori, siç thotë ai "Unë nuk kërkoj lëmoshë në rrugë dhe nuk e di se prej nga vinë ata por ata

thonë se disa vijnë nga Shqipëria". Në anën tjetër, ai mendon se është mirë të shkoj diku tjetër "për të vizituar vende tjera". Ai thotë se disa organizata ju ndihmojnë atyre me veshmbathje dhe se "në fillim ishte vështirë për shkak të gjuhës veçanërisht për t'u shoqëruar por tash më shkon mirë". Hulumtuesi vërejti se IH ishte një djalë i gjallë dhe inteligjent, që duket se është gjetur mirë por që ka tendenca të jetë pak ca i rezervuar kur flet për këtë temë të caktuar meqenëse ishte i prirë të jep përgjigje të shkurta.

Ngjashëm, *NI një djalë 11 vjeçar i etnisë shqiptare,* i cili ishte kthyer nga Gjermania, edhe pse nuk e sheh veten të ketë qenë ose që është FL. Ai jeton me prindërit e tij, motrat dhe vëllezërit si dhe familjen e gjerë, në një familje 11 anëtarshe. NI kupton konceptin e FnL, edhe pse thotë "ata kërkojnë lëmoshë ose punojnë dhe lëvizin në pjesë të ndryshme të qytetit ose qyteteve tjera; meqenëse nuk e bëj këtë, unë nuk jam njëri nga ata". Ai vazhdon të thotë se do të ishte mirë që të shkoj diku tjetër "të vizitoj vetëm për t'u argëtuar".

iii. Të mësuarit për t'u përshtatur

Për më tepër, fëmijët e kthyer gjithashtu portretizojnë vështirësitë me të cilat ata dhe familjet e tyre janë ballafaquar, që përfshijnë vështirësinë për t'u përshtatur, varfërinë, mungesën e mundësive dhe mungesën e strehimit adekuat. Fëmijët e kthyer sqaruan këto në më detaje, ata mund shihen të jenë të ndryshëm ndaj rrethanave të ndryshme me të cilat fëmijët jashtë mjedisit mbrojtës janë ballafaquar, meqenëse rrethanat e tyre kanë tendenca që të jenë shumë më ekstreme. Sido që të jetë, është e qartë se këto vështirësi kanë pasur një ndikim në këta fëmijë, veçanërisht në vetë-vlerësimin e tyre, aftësinë e tyre për t'iu besuar zyrtarëve dhe shëndetit të tyre mendor.

Për shembull *BM është një vajzë 10 vjeçare e etnisë shqiptare*, që ka jetuar në Suedi dhe Francë, edhe pse me familjen e saj ajo u kthye në Kosovë dhe vazhdon ta konsideroj të vështirë përshtatjen. Kur është kthyer familja e saj po jetonte me familjen e gjerë por tash jetojnë në një apartament me qira, që ajo mendon se komuna e paguan qiranë. BM thotë "Unë kam dëgjuar për familjet që shkojnë në vende tjera nga Kosova, që janë kthyer në Kosovë. Por ata janë kthyer në Suedi prapë, dhe nuk kanë dashur të qëndrojnë në Kosovë ". Sa i përket fëmijëve në lëvizje, BM thotë "kur ata janë të rinj, nuk mendoj se është mirë meqenëse mund të sëmuren, por nëse janë të rritur atëherë është në rregull që të shkojnë diku tjetër". Ky mendim mund të ndikohej nga ajo çfarë dëshmon BM, derisa ajo lëviz me familjen e saj. "Në Suedi ne ishim në qendrën e pranimit dhe në Francë në një hotel me familjet tjera si ne. Ata na kanë ofruar ushqim tre herë në ditë, shumë patate dhe një ditë na kanë ofruar ushqim vetëm një herë. Atë ditë nëna ime dhe gratë tjera shkuan në kuzhinë dhe janë fjalosur me ta, unë i dëgjova ato. Një herë tjetër, një njeri erdhi në hotel i dehur, ai u rrëzua dhe ishte i tëri i gjakosur; Unë u frikova. Ndërkaq, përderisa ne po

lëviznim, babai im tha se ne duhemi të jemi të kujdesshëm ndaj policëve që të mos i'u besojmë". Në Kosovë, BM ndjek mësimin por asaj nuk i pëlqen aq; "kur kemi edukatë fizike ne asnjëherë nuk bëjmë asgjë, disa nga nxënësit gjithnjë krijojnë telashe, nuk më pëlqejnë ata". "Mësimdhënësja është e ligë dhe ka një shkop, ajo i godit disa nxënës me të, unë kam parë atë duke i goditur ata prandaj unë dëshiroj të ndërroj shkollën".Është e qartë që BM është llafazane, është e hapur dhe përshkruan atë çfarë ka parë ose ndjerë në detaje. Sidoqoftë, ajo e konsideron të vështirë koncentrimin në dhënien e detajeve për një pyetje ose temë specifike dhe ka një tendencë për të kërcyer nga një ngjarje në tjetrën. Ajo gjithashtu ka pasur probleme për t'u përshtatur me rrethanat e kthimit të familjes së saj dhe krahason ato me jetën e saj në Suedi.

iv. Banimi

Ndërkaq për RR, mungesa e banimit adekuat është një problem, edhe nëse kjo nuk e parandalon atë që të jetë e lumtur. *RR është një vajzë 8 vjeçare e etnisë shqiptare,* e lindur në Belgjikë nga prindër kosovar dhe së bashku me familjen e saj është kthyer në Kosovë. Ajo tashmë jeton me prindërit e saj dhe vëllezërit dhe motrat e saj, në një shtëpi dykatëshe, të cilën e ndajnë me familjen e gjerë, gjithsej prej 13 personave (xhaxhai i saj, bashkëshortja e tij dhe fëmijët si dhe gjyshërit). RR thotë "Unë kam dëshirë të jem këtu dhe dëshiroj që të qëndroj këtu" d.m.th në Kosovë. Ajo duket të jetë e lumtur me situatën aktuale, edhe pse ajo zbulon se ajo duhet të flejë në të njëjtën dhomë me prindërit e saj dhe motrat; "Unë flejë në një dyshek në dysheme". Për shkak të mbushjes së madhe të shtëpisë , ajo thotë "ne kemi disa lodra por ne mund të luajmë vetëm në dhomën e ndejës, që ka qenë dhomë e fjetjes". Prindërit e saj ajo thotë planifikojnë që të zhvendosen nga shtëpia familjare në një apartament. Përderisa ajo nuk ka dëgjuar për FnL në mënyrë specifike, ajo thotë "Unë kam dëgjuar rreth lëvizjes së familjeve, por unë nuk mendoj që është mirë", që mund të jetë një indikacion i përvojës së saj së lëvizjes, edhe pse ajo nuk hyn në më shumë detaje. RR shkon në shkollë; asaj i pëlqen edukata fizike dhe ka bërë shoqe. Në përgjithësi RR duket pak e rezervuar dhe ofroi përgjigje të shkurtra, edhe pse ajo u duk e lumtur.

v. Përgjegjësia për të kontribuar dhe mungesa e mundësive

Për më tepër, fëmijët si AP ndjejnë se kanë përgjegjësi për të kontribuar por nuk janë në dijeni se si dhe kur është kthyer ai u bë i vetëdijshëm sa sa pak mundësi ka në Kosovë për të rinjtë siç është ai. *AP është një djal 15 vjeçar i etnisë shqiptare,* i cili kishte lindur në Zvicërr, në moshën 11 vjeçare me familjen e tij ai ishte zhvendosur në Finlandë dhe në vitin 2010 ata u kthyen në Kosovë. Ai jeton me prindërit e tij dhe vllezërit dhe motrat e tij në shtëpinë e tyre, ku ai thotë se kushet janë të mira". Ai thotë, babai i tij është shtylla e vetme e familjes; ai punon kohë mas kohe. "Meqenëse unë nuk punoj, më duhet t'i kërkoj para babait tim dhe ndjehem keq kur i

kërkoj sepse ai nuk punon tërë kohës, por ai punon kurdo që gjen punë dhe këtë ai e bënë për ne". AP thotë se ai ka dëgjuar për FnL, "Unë kam dëgjuar për somalezët që vijnë në Finlandë për të kërkuar azil dhe kam një shok që është kthyer nga Gjermania". Prandaj sipas përvojës së tij FL vijnë nga Somalia dhe Gjermania, ndonëse ai gjithashtu di për fqinjin në Kosovë, që është kthyer nga Finlanda dhe ka arritur që të kthehet prapë. Për më tepër, AP thotë që "nëse ju keni kushte të mira jetese atëherë është në rregull që mos të lëvizni. Njerëzit në Finlandë janë më ftoftë por kushtet e jetesës janë të mira, pra ka të mira dhe këqija". AP shkon në shkollë, ndjekë kursin e gjuhës angleze, të cilën Tdh e mbështetë dhe i ndihmon babait të tij rreth shtëpisë. Ai gjithashtu thotë "Unë gjithashtu dëshiroj të shkoj në palestër ose të luaj futboll në një ekip por kjo nuk është e mundur për momentin". AP ishte në përgjithësi i gatshëm për përgjigje në pyetje, edhe pse ai tregoi një pikëllim të madh kur po fliste për të holla dhe mungesë të mundësive me të cilat është ballafaquar kur është kthyer në Kosovë.

2. Profili i FnL përmes vëzhgimit

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i hulumtimit të kryer u përqendrua në të mësuarit rreth FnL përmes vëzhgimit në përputhshmëri me Udhëzimet Metodologjike. Kjo ishte bërë në lokacione të ndryshme të Prishtinë dhe ishte udhëhequr nga hulumtuesi udhëheqës, së bashku me një hulumtues ndihmës dhe një hulumtues fëmijë, S, një djalë i etnisë rome që ka ofruar një pasqyrë të rëndësishme lidhur me familjet e vëzhguara në rrugë që shumica e tyre konsiderohet të kenë kërkuar lëmoshë. Në përputhshmëri me Udhëzime Metodologjike, vëzhgimet janë bërë në mënyrë jo-ndërhyrëse dhe jo-intervenuese. Për më tepër, ky aspekt i hulumtimit ka lejuar pjesëmarrje të fëmijës, me hulumtuesin fëmijë duke pasuruar gjetjet meqenëse ai vërejti një sërë detaje, që janë shënuar dhe ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme.

Gjatë mëngjesit ekipi i hulumtimit vërejti se nuk ka aq shumë fëmijë që janë parë të kërkojnë lëmoshë, edhe pse gjatë ditës ishte një rritje e dukshme. Në të njëjtën kohë, në një numër rastesh fëmijët nuk u panë që kërkojnë lëmoshë vetëm, ata më shumë po përdoreshin nga prindërit e tyre për të fituar simpatinë e publikut meqenëse ata po kërkonin lëmoshë ose ata ishin duke kërkuar lëmoshë vetëm në pjesë të ndryshme të qytetit duke u takuar si familje në intervale të ndryshme gjatë ditës.

Një nga "familjet" e para që u vëzhgua duke kërkuar lëmoshë ishte një *grua me dy djem të rinj*. Gruaja ishte e etnisë shqiptare dhe bazuar në ngjashmërinë fizike dhe mbrojtjen që gruaja e tregoj ndaj djemve të vogël dukej se ata ishin fëmijët e saj. Të dy fëmijët ishin të rinj, njëri djalë përafërsisht 7-8 vjeçar, ndërsa ai më i riu dukej të jetë në mes 3-4 vjeçar. Duke mbajtur duart e

djemve ajo shkonte në kafe dhe iu ofrohej njerëzve që ishin ulur jashtë, duke kërkuar nga ata të holla. Përderisa gruaja dukej të mos ndihej rahat duke e bërë këtë, djemtë nuk po e tregonin të njëjtën mos-rehati duke shoqëruar gruan. Në të njëjtën kohë, u vërejt se gruaja nuk po i detyronte fëmijët të kërkonin lëmoshë apo që po i keqtrajtonte në njëfarë mënyre, ajo më tepër në mënyrë të vazhdueshme po u mbante duart atyre duke i mbajtur aftër vetes. Edhe pse ata ishin prezent dhe shikonin se si njerëzit po u përgjigjshin kërkesës së saj për të holla, që në shumicën e rasteve kjo përgjigje ishe pozitive, me njerëz që i jepnin asaj të holla. Ajo u vëzhgua duke e bërë këtë në disa kafe dhe sapo ajo i vizitoi të gjitha në sheshin publik, ajo vazhdoi diku tjetër në qytet dhe nuk u kthye më.

Ngjashëm, në pjesë të ndryshme të qytetit, *një burrë rom duke e mbajtur një fëmijë shumë vogël; rreth 1 vjeçar* u vëzhgua duke kërkuar lëmoshë në kafiteri. Njeriu së pari u vërejt nga S, hulumtuesi fëmijë, i cili tha se e njihte njeriun meqenëse ishte fqinji i tij. Ekipi pa se burri kishte disa deformitete në fytyrën e tij, ndërsa faqet e fëmijës dukej të ishin veçanërisht të kuqe, edhe pse fëmija nuk po qante. Meqenëse ekipi vëzhgoi se burri po kërkonte të holla në kafiteri, S sqaroi se burri ishte i martuar dhe fëmija që ai po mbante ishte fëmija i tij i vetëm. Kushtet e kësaj familjeje ishin shumë të këqija dhe meqenëse burri nuk po mund të gjente punë ai detyrohej që të kërkonte lëmoshë në këtë mënyrë. S vazhdoi duke sqaruar se atij i vinte keq që fëmija po përdorej në këtë mënyrë, fëmija po i ekspozohej motit të ftoftë, që shpesh shpinte tek sëmundja. Në të njëjtën kohë, S tha që "njerëzit tentojnë që të jenë më të dhimbsur kur shihnin dikë duke kërkuar lëmoshë me fëmijë dhe kështu familja nuk kishte zgjedhje tjetër meqenëse po mundoheshin që të mbijetonin".

Ndërkaq në pjesë të ndryshme të qytetit, afër xhamisë ku shumë fëmijë janë parë duke kërkuar lëmoshë, ekipi vëzhgoi *tre romë të ulur në një stol: një grua me djalë, dhe një grua tjetër më e re*. Meqenëse ekipi u ulë në anën tjetër të tyre duke mbetur në këtë mënyrë i pavërejtur, ata vërejtën se bazuar në dukjen e saj njëra nga gratë ishte diku në fund të njëzetave/fillim të tridhjetave, ajo kishte një veshje të leckosur, një shall në kokën e saj dhe në përgjithësi dukej e shqetësuar dhe e pikëlluar. Në një situatë të ngjashme ishte dhe gruaja më e re e cila ishte në fund të tetëmbëdhjetave/ fillimi i viteve të njëzeta e gjithashtu kishte një veshje të leckosur si dhe vazhdimit fliste me gruan më të vjetër, e cila dukej se po mundohej ta qetësonte atë. Ndërkaq djali dukej të ishte rreth 6 ose 7 vjeç, që dukeshin të lodhur dhe ishin ulur afër gruas më të vjetër. Ndërsa nuk ishte e qartë se a ishin të afërm, dukej që gruaja më e vjetër mund të ishte nëna e tij. Deri sa ata vazhduan që të qëndronin ulur në stol, një djalë tjetër rom, rreth 14 vjeçar iu afrua atyre, që dukej shumë i lodhur, i brengosur dhe i pikëlluar.

Deri sa ekipi nuk ishte në gjendje që të shoh se a i dha ai të rriturve të holla, S tha se ai e kishte parë djalin 14 vjeçar më parë gjatë ditës te semaforët në qytet, duke iu afruar veturave që ishin ndalur aty duke kërkuar të holla nga njerëzit brenda aty. Së shpejti pastaj, një vajzë e vogël, rreth 5 ose 6 vjeç iu bashkëngjit atyre, duke iu ofruar gruas më të vjetër, duke i gjuajtur disa gjëra tek

ajo dhe duke i dhënë të holla asaj. Me të dëshmuar këtë, S tha se ai besonte që vajza e re ishte lënë të kërkonte lëmoshë vetëm në pjesë tjetër të qytetit dhe vajza e re pastaj i bërtiste gruas më të vjetër "pse u vonove dhe pse nuk erdhe të më merr". Gruaja më e vjetër u mundua ta qetësonte vajzën por vajza refuzonte, ajo pastaj i dha asaj çantën me ushqim të dyqanit të bukës, të cilën ajo e morri dhe filloi ta hante shpejt. Bazuar në këto ndërveprime, ekipi vëzhgues besoi se kjo vajzë ishte vajza e gruas më të vjetër, edhe pse S tha se ka shumë gjasa që gruaja më e vjetër ishte nëna e të tre fëmijëve dhe se familja kishte ardhur ilegalisht nga Shqipëria. Meqë ekipi vazhdoi të vëzhgoj, ata mund të dëgjonin kohë pas kohe bisedën e tyre dhe u bë qartë se për shkak të theksit të tyre dhe përdorimit të fjalëve të caktuara kishte shumë gjasa që ata ishin nga Shqipëria.

Grupit, përderisa po vëzhgohej, iu afrua një burrë i cili kishte karrocë plot me kanaqe që me gjasë i kishte mbledhur nga koshat e hedhurinave. Edhe pse ai nuk iu afrua shumë afër grupit, S, vërejti se gruaja më e vjetër ja shkeli syrin atij dhe vajza e vogël po i tregonte atij disa monedha. S, besoi se ai burrë ishte bashkëshorti i gruas më të vjetër dhe babai i fëmijëve, edhe pse kjo nuk mund të dihej me siguri sepse ai nuk vazhdoi së afruari atyre por u kthye prapa dhe u largua me qerren e tij. Sidoqoftë, ekipi pastaj vëzhgoi një burrë tjetër i cili po i shikonte gratë nga distanca dhe ishte e dukshme se ai po drejtonte shikime shumë të zemëruara kah gratë, ku gruaja më e vjetër pastaj u ndje shumë e rrezikuar duke qenë dëshmitare e kësaj. Që të dy gratë pastaj vazhduan të bisedojnë dhe dukej që gruaja më e vjetër po mundohej që ta qetësonte atë më të rejën edhe pse ekipi nuk mund të dëgjonte për çfarë po flisnin ato. Pas largimit të burrit, grupi u nda, ku djemtë shkuan në rrugën afër tek semaforët ku ata vëzhgonin veturat që po afroheshin atje e pastaj të kërkonin të holla nga ta. Duke bërë këtë, u vëzhgua nga ekipi se djemtë e rinj ishin në rrezik që të shkeleshin apo të lëndoheshin, veçanërisht ai më i riu meqenëse ai ishte mjaftë shtatshkurtër dhe veturat në lëvizje mund të mos e vërenin. Ndërkaq gratë dhe vajza më e re, u vërejtën më vonë duke kërkuar lëmoshë në një rrugë tjetër.

Përkitazi këtij grupi të të rriturve dhe fëmijëve, S, më vonë sqaroi se ata operojnë sikurse të drejtojnë një biznes familjar. Gjatë ditës, e tërë "familja" shpërndahet në pjesë të ndryshme të qytetit ku ata ose kërkojnë lëmoshë, ose kërkojnë metale ose kanaqe dhe pastaj në mbrëmje ata kthehen në shtëpi ku i ndajnë "fitimet" e tyre. S vazhdoi duke sqaruar se ata ishin në gjendje që të jetonin me qira sepse secili prej tyre mund të mblidhte rreth 15-20 Euro brenda një dite duke përfshirë edhe fëmijët e vogël. Sidoqoftë, ekipi u la në mëdyshje nga burri i dytë që iu afrua grupit, dukej se ishte ai që kontrollonte tërë operacionin, edhe pse kjo nuk mundi të konfirmohej.

Në të njëjtën kohë ekipi gjithashtu vëzhgoi fëmijët që ose punon ose kërkonin lëmoshë vetë, pa i pasur të rriturit prezent. Një nga rastet e tilla ishte një grup i djemve të rinj të gjetur në një udhëkryq të kryeqytetit, duke pastruar xhamat e përparmë të veturave në shkëmbim të të hollave me vozitës të veturave që po kalonin andej. Ekipi i kishte parë këta djem më parë gjatë ditës por nuk ishte në gjendje që t'i ndaloj ata dhe t'i vëzhgoj ata, gjithashtu ky udhëkryq i caktuar është i

njohur për fëmijët që e bëjnë këtë. Derisa ekipi po i afrohej udhëkryqit, ata vërejtën dy policë afër udhëkryqit , ku ata prisnin se asnjë fëmijë nuk do të gjendet. Sidoqoftë, për befasinë e ekipit ata gjetën një djalë rreth 7 ose 8 vjeç në njërën anë të udhëkryqit, duke u munduar të pastroj xhamat e përparmë të veturave, ku priste të ndryshonin dritat e semaforëve. Ndërkaq në anën tjetër, ekipi vëzhgoi një grup tjetër të djemve rreth moshës 16 deri 19 vjeç, të cilët ishin të angazhuar në të njëjtin aktivitet. Dukej që fëmijët më të mëdhenj njohën S, fëmijën hulumtues, dhe filluan ta ngacmojnë atë, ku pastaj ekipi u desh që të largohej nga atje. Sidoqoftë, duke u kthyer drejt qendrës së kryeqytetit, S vërejti dy gra të ulura në stol afër kampusit të Universitetit dhe ai sqaroi se disa nga fëmijët e tyre ishin ata tek udhëkryqi. S i kishte parë ata më parë dhe zakonisht ai thotë se nënat ose kërkojnë lëmoshë ose marrin të hollat që fëmijët i fitojnë duke pastruar xhamat e përparmë tek udhëkryqet e frekuentuara.

Ekipit të hulumtimit përderisa po vëzhgonte në një nga sheshet kryesore në kryeqytet iu afruan fëmijët që kërkojnë lëmoshë. Një vajzë e etnisë rome, e cila dukej të ishte më e re se 6 vjeç, ishte e tëra e vetme në sheshin publik duke u munduar të kërkonte të holla nga njerëzit. Ajo iu afrua ekipit dhe fillimisht vetëm i shikoi ata për një kohë para se të kërkonte të holla. Kur ekipi nuk i ofroi asaj të holla ajo u largua dhe filloi të kërkonte nga kalimtarët e tjerë. Meqenëse ‘S’ ishte në gjendje ta njihte atë, ai tha se ajo ishte nga Shqipëria dhe se zakonisht ishte parë duke kërkuar lëmoshë në rrugë dhe kryeqytet. Sipas ‘S’, familja zakonisht e lë atë vetëm për të kërkuar lëmoshë dhe e vëzhgon atë nga larg, edhe pse në këtë rast ekipi nuk vërejti ndonjë të rritur që po monitoronte aktivitetet e saj. ‘S’ vazhdoi të thotë se ishte gabim që prindërit të lënë fëmijët e tyre vetëm në rrugë që të kërkojnë lëmoshë dhe se kjo është e rrezikshme meqenëse ata ballafaqohen me një numër të rreziqeve. Ai vazhdoi duke sqaruar një rast që ai e njihte lidhur me përfshirjen e vajzës së fqinjit të tij, e cila duke kërkuar lëmoshë u godit nga një veturë. Familja e saj ai tha u kujdes për të por sapo u shërua ata e vënë atë prapë në rrugë për të kërkuar lëmoshë, gjë që është tërësisht e gabuar. Në rastet e tilla ‘S’ thotë se ai nuk e pëlqen praktikën ku prindërit detyrojnë fëmijët e tyre të kërkojnë lëmoshë dhe nëse i ndodh atij ai do të shkoj në polici.

Gjatë pauzës në një nga kafiteritë e kryeqytetit, ekipit iu ofrua një vajzë tjetër e etnisë rome me një fëmijë që sapo kishte filluar të ecte, e që po shkonte në çdo tavolinë të kafiterisë për të kërkuar para nga njerëzit. Së shpejti u bë e qartë që fëmija i vogël nuk ishte i kënaqur që po bënte këtë meqë filloi të qante. Sidoqoftë, fëmija më i madh vazhdoi ta tërhiqte zvarrë fëmijën më të vogël dhe në fakt po dukej se ajo po e përdorte këtë skenar për të fituar keqardhjen e njerëzve për t’iu ofruar atyre një zgjedhje të lirë dhe për ta bërë këtë shpejt në mënyrë që ata të shkojnë tutje. ‘S’ më vonë sqaroi se ai gjithashtu i njihte këta fëmijë, meqë vajza jetonte në të njëjtën lagje me familjen e tij. Në fillim, hulumtuesit e rritur kishin përshtypjen se këta dy fëmijë ishin motër dhe vëlla; sidoqoftë, ‘S’ sqaroi se fëmija i vogël në fakt ishte djali i asaj vajze. ‘S’ vazhdoi duke thënë se ndonjëherë ai sheh këtë vajzë duke u grindur me bashkëshortin e saj, e që rezulton pastaj me nënën duke rrahur fëmijën.

Ndërkaq, në të njëjtin lokacion, ekipi po ashtu vërejti në sheshin publik një vajzë me aftësi të kufizuara në karrocë invalidësh e cila ishte lënë vetëm të kërkonte lëmoshë në mes të sheshit kryesor të kryeqytetit. Edhe një herë, 'S' e njohu fëmijën dhe tha se zakonisht nëna e vajzës dhe fëmijët tjerë do të jenë diku në afërsi. Menjëherë pas kësaj, ekipi vërejti një grua më të vjetër të etnisë rome e ulur në një stol rrethuar me fëmijë jo larg prej ku vajza me aftësi të kufizuara po qëndronte. Dukej se në këtë grup në stol, gruaja më e vjetër po e përcillte vajzën me aftësi të kufizuara nga distanca; sidoqoftë, ishte gjithashtu një nënë tetëmbëdhjetë vjeçare me djalin e saj [176]. Ekipi ishte në gjendje që veçanërisht të përqendrohej në vëzhgimin e tyre dhe vërejti se nëna tetëmbëdhjetë vjeçare nuk tregoi ndonjë kujdes ose vëmendje për djalin e saj. Derisa fëmija i vogël po vraponte rreth sheshit pa ndonjë mbikëqyrje, nëna tetëmbëdhjetë vjeçare vazhdonte të qëndronte ulur në stol. Për më tepër, kur djali i saj i kërkoi asaj të pijë atë çfarë ajo po pinte, ajo vetëm i hodhi shishen atij. I mësuar me këtë lloj trajtimi të vrazhdë, ai vetëm mori shishen dhe piu atë çfarë kishte mbetur nga ajo.

Siç mund të pritet vëzhgimet nuk mund të ofrojnë informata në detaje lidhur me veçoritë e veçanta të FnL. Sidoqoftë, është e qartë se FnL në Kosovë përbëhet nga ata që janë të angazhuar në kërkimin lëmoshë ose puna e rrezikshme si njësi e familjes ose duke kryer aktivitetet e tilla së bashku ose duke u ndarë në pjesë të ndryshme të qytetit por në pika të ndryshme të rigrupimit në qytet. FnL e angazhuar në aktivitetet të tilla ballafaqohet me kushte të vështira, që padyshim ndikojnë në shëndetin e tyre mendor dhe fizik, si në mirëqenie emocionale. Në anën tjetër ndoshta është grupi i fëmijëve që po kërkojnë lëmoshë ose që po pastrojnë xhamat e përparmë krejt vetëm, që janë shumë të cenueshëm dhe ballafaqohen me rreziqe shtesë, meqenëse rrethanat me të cilat ballafaqohen mund të jenë shumë më të rrezikshme kur ata mund të jenë të përfshirë në aksident ose mund të abuzohen nga kalimtari.

Përderisa disa nga fëmijët e përfshirë në kërkim lëmoshe në rastet e përvijuara, mund ta kishin detyruar këtë kjo as nuk mund të konfirmohet e as të mohohet në baza të këtij vëzhgimi të kufizuar. Një vëzhgim i mëtejmë që duhet të theksohet është se duket të jetë një numër i vogël i rasteve ku palët e treta ishin të përfshira në monitorimin e aktiviteteve të atyre që kërkojnë lëmoshë. Që të dy vëzhgimet janë të rëndësishme sepse supozimi mund të jetë që shumica e këtyre fëmijëve janë ose të detyruar nga prindërit e tyre ose janë të përfshirë në aktivitete të tilla për shkak të ndonjë ndërmarrje kriminale dhe ajo forcë është përdorur për të siguruar dëgjueshmërinë e tyre.

Sidoqoftë, ajo çfarë është e qartë është se shumica e këtyre fëmijëve po ballafaqohen me jetë të vështirë dhe familjet e tyre që kanë për detyrë të sigurojnë mirëqenien e tyre ose nuk janë në gjendje ose nuk kanë vullnet për ta bërë këtë. Në të njëjtën kohë, përkundër situatës së tyre ekstreme dhe të qenit të ekspozuar në vende publike, gjendja e tyre e vështirë duket të jetë

[176] Ajo paraprakisht iu ofrua ekipit derisa ishte në kafiteri, të përshkruar në paragrafin paraprak

pothuajse e padukshme për personat përgjegjës institucional të cilët kanë përgjegjësi të veprojnë ndaj neglizhencës hetuese nëse vjen nga prindërit ose nëse janë të kontrolluar nga kriminelët. Në këtë kuptim, është absolutisht e nevojshme që të gjithë personat përgjegjës të mos vazhdojnë të injorojnë FnL; por të ndërmarrin veprime përmes përpjekjeve të koordinuara në mënyrë që të përmbushin obligimet e tyre të përfshirjes së këtyre fëmijëve dhe për të ofruar mbështetje që është e nevojshme për të siguruar mirëqenien e tyre.

3. Diskutimi i fokus grupit

Fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës, të cilët janë pjesë të FL ishin gjithashtu të përfshirë në diskutim të fokus grupit ku ata qenë në gjendje që të diskutojnë dijeninë e tyre lidhur me shërbimet e mbrojtjes së fëmijës. Kjo është një mundësi tjetër ku qasja e pjesëmarrjes së fëmijës ishte përdorë, me pjesëmarrje të 9 fëmijëve (8 djem dhe 1 vajzë) në mes të moshës 9 dhe 13 vjeç.

Fillimisht, kur u pyetën se çfarë dinin për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, të gjithë fëmijët thanë se ata dinin për policinë dhe shërbimet sociale. Në rastet kur ata kishin nevojë për ndihmë, fëmijët thanë se ata janë paraqitur në polici. *F, një djalë 11 vjeçar i cili mblidhte metale dhe kanaqe* tha "nëse dikush dëshiron të më lëndon, unë do të paraqitem në polici. Një herë një i rritur më lëndoi sepse dëshiroi të më merrte një pjesë të hekurishtes që unë e kisha mbledhur, kështu që unë i tregova axhës tim. Ai pastaj e lajmëroi rastin në polici." Fëmijët tjerë, si *V, një djalë 10 vjeçar që po mblidhte metale* tha "Unë do të kërkoja ndihmë nga sigurimi." Sidoqoftë, ishte e paqartë se për çfarë lloj sigurimi ai fliste. Fëmijët tjerë, duke përfshirë, *G, një djalë 9 vjeçar dhe S, një djalë 13 vjeçar* përmendën avokatët dhe gjyqtarët si profesionistë të cilëve ata do t'u drejtoheshin nëse do të kishin nevojë për ndihmë. Edhe pse nga ta u kërkua që të shtjellojnë përgjigjet e tyre, S nuk ofroi ndonjë detaj tjetër, ndërkaq V shtoi se "një avokat mund të mbroj në një gjykatë." Bazuar në përgjigjet e tyre, ishte e qartë që këta fëmijë kishin një dijeni të kufizuar lidhur me shërbimet që punojnë për mbrojtjen tyre.

Në mënyrë që të arrihet një kuptim gjithëpërfshirës i perceptimit të këtyre fëmijëve për kërcënimin potencial të personave ose situatave, ata në mënyrë specifike u pyetën "kush mund të ju lëndoj." Vetëm dy fëmijë i'u përgjigjën kësaj pyetje. *V, një djalë 10 vjeçar* tha "hajdutët mund të ju lëndojnë" dhe *F, një djalë 11vjeçarë* edhe një herë përmendi rastin kur ai u kërcënua dhe u lëndua nga një i rritur në përpjekje për të vjedhur metaleqë ai i mblidhte. Për më tepër, shumica e këtyre fëmijëve thanë se ata nuk ndjeheshin të kërcënuar apo të detyruar nga prindërit e tyre për të kërkuar lëmoshë ose angazhuar në ndonjë punë të rëndë. Vetëm *R, një vajzë 10 vjeçare tha* "nëna ime më detyron të kërkoj lëmoshë." Në fakt, shumë fëmijë të tjerë, duke përfshirë *M, një djalë 10 vjeçar dhe B, një djalë 11vjeçar*, që dukej të njihte R dhe familja e saj mbështeti komentin e saj duke thënë se R ishte e detyruar të kërkonte lëmoshë nga nëna e saj.

Një analizë paraprake e këtyre përgjigjeve të shkurtra dhe komenteve mund të ofroj mbështetje të mëtejme të përshtypjes së përgjithshme se fëmijët që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës janë të trajnuar që të t'iu binden prindërve të tyre dhe të shohin familjen e tyre si sistem kryesor ose të vetëm mbështetës. Për më tepër, kushtet e tyre të vështira, mjedisi rrethues dhe nevojat e pa-adresuara të tyre duken të kenë ushqyer hezitimin e tyre për të raportuar çfarëdo lloj abuzimi të shkaktuar nga prindërit e tyre. Në fakt, edhe pse shumica e këtyre fëmijëve thanë që ata nuk kishin qenë të detyruar nga prindërit e tyre që të kërkojnë lëmoshë apo të kryejnë punë të vështirë, ata janë lënë vetëm dhe të pa mbikqyrur, duke kaluar disa orë larg shtëpisë së tyre, në zona të rrezikshme dhe të largëta, ku ata mblidhnin metale dhe materiale tjera të cilat pastaj i shisnin.

Një çështje tjetër e ndërlidhur me të kuptuarit e fëmijëve të shërbimeve mbrojtëse të fëmijës, që kishte për qëllim të konstatojë se a po merrnin ndonjë ndihmë, material ose diçka tjetër nga shërbimet sociale apo ndonjë organizatë tjetër. Shumica e këtyre fëmijëve thanë se ata po merrnin ndihmë nga shërbimet sociale. Për shembull, *G, një djalë 9 vjeçar* tha: "shërbimet sociale na kanë ndihmuar ne me mirëqenie financiare. Ata madje thanë se do të ndihmojnë familjen time duke nga dhënë 500 Euro për të blerë traktorin, në mënyrë që ne të mund të punojmë, e dini për çfarë po flas, të mbledhim kanaqe." Të tjerët fëmijë, duke përfshirë *S, një djalë 13 vjeçar dhe B, një djalë 11 vjeçar* tha "kryetari i komunës dhe udhëheqësit e komunitetit të Romëve dhe Ashkalive na ndihmojnë duke na dhënë ushqim dhe veshmbathje." Kur i pyetëm nëse ata kishin vizituar ndonjëherë QPS-në për të kërkuar ndihmë, shumica e fëmijëve nuk dhanë ndonjë përgjigje. Sidoqoftë, *V,një djalë 10 vjeçar* tha "Po, unë kam shkuar me familjen time në QPS dhe kemi kërkuar ndihmë financiare dhe kemi marr njëlloj ndihme." Sidoqoftë, ai nuk ishte në dijeni nëse ata kanë vazhduar të marrin më ndihmë. Fëmijët gjithashtu u pyetën nëse familja e tyre ishte vizituar ndonjëherë nga punëtori social. Si përgjigje, të gjithë fëmijët thanë se ishin vizituar, dhe si rezultat i kësaj ata u ndihmuan me ushqim dhe tjera gjëra.

Përveç QPS dhe zyrtarët komunal, fëmijët përmendën ndihmën që ata kishin marr nga OJQ-të për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Për shembull, *F, një djalë 11 vjeçar* tha " Ideas Partnership na ndihmojnë me ushqim, veshmbathje dhe vijueshmëri të mësimit." Shumica e fëmijëve gjithashtu thanë se Terre des hommes pagoi për kurset e tyre të gjuhës angleze. Edhe pse fëmijët nuk ishin plotësisht në dijeni lidhur me programin që funksionoi në bashkëpunim në mes Qendrës për Punë Sociale dhe SOS Kinderdorf[177], disa prej tyre ishin pjesërisht në dijeni

[177] Në mënyrë që ky shërbim të kuptohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, hulumtuesi pyeti edhe punëtorin social (B) që punoi në këtë komunitet të fëmijëve e që ishte prezent si dhe që kishte ndihmuar personelin e Tdh në aktivitetet e tyre. B sqaroi se SOS Kinderdorf në Kosovë në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale në komunën e Fushë Kosovës ka zbatuar një program për fuqizimin e familjeve. Sipas B, ky program ishte dizajnuar si përpjekje për të ndihmuar familjet e varfra nga komunitetet e minoritetit si dhe fëmijët e tyre në fushat e shërbimit social, arsimimit dhe shëndetësisë. B tha: " për të ofruar shërbime sociale, punëtorët social vizituan shumë familje, mblodhën të dhëna për të identifikuar nevojat e këtyre familjeve, ofruan ushqim dhe pako higjienike si dhe i ndihmuan ata që të

lidhur me ekzistencën e tyre. Kjo është ilustruar nga komenti në vijim nga *G,një djalë 9 vjeçar* i cili tha "SOS na dhuroi të hollat për kurset e gjuhës angleze."

Përfundimisht, fëmijët ishin të angazhuar në diskutimin se a u ishte afruar ndonjëherë ndonjë profesionist, si polic apo punëtor social përderisa ata ishin duke kërkuar lëmoshë ose punuar në rrugë. Si përgjigje, *B një djalë 11vjeçar* shkurtimisht tha "Një herë një polic më është afruar dhe më tha të shkoj në shtëpi."Edhe pse nga ai u kërkua që të ta shtjelloj këtë më tutje, B nuk ofroi detaje të tjera lidhur me vendndodhjen e tij apo rrjedhën e veprimit kur atij i është ofruar polici. Ndryshe, *F një djalë 11 vjeçar* duket të jetë gjithmonë në gatishmëri që të kontribuoj në diskutim, dhe prandaj ofroi një përgjigje më të detajuar; "pak kohë më parë, unë po kërkoja lëmoshë në rrugë, dhe një polic më pyeti se pse po kërkoja lëmoshë dhe se kush më detyronte të kërkoja lëmoshë. Ndërkaq, *G një djalë 9 vjeçar* ndërhyri duke thënë "Unë isha me F atë ditë dhe edhe mua më janë parashtruar të njëjtat pyetje." F vazhdoi: "atë ditë policët gjithashtu u parashtruan shumë pyetje edhe nënave tona, të cilat po ashtu po kërkonin lëmoshë në afërsi, dhe u thanë atyre që të ndalnin së kërkuari lëmoshë si dhe të mos na lejojnë edhe neve të kërkojmë lëmoshë në rrugë. Që nga atëherë, ne nuk kërkojmë lëmoshë më. Tash nëna ime dhe nëna e G-së punojnë së bashku në treg ku shesin pemë dhe perime, në vend që të kërkojnë lëmoshë."

Pasi dëgjoi bashkëmoshatarët e saj, *R një vajzë 10 vjeçare* ngadalë tha " policia po ashtu kërkoi nga nëna ime që të ndaloj së kërkuari lëmoshë si dhe të mos më detyroj mua që të kërkoj lëmoshë, por ajo ende e bën këtë." Në fund të diskutimit, *G një djalë 9 vjeçar* tha "punëtorët social vizituan shumë familje si dhe familjen time dhe u thanë prindërve që të mos lejojnë fëmijët që të kërkojnë lëmoshë dhe të punojnë në rrugë sepse është shumë e rrezikshme për ta. Prindërit e mi nuk më detyrojnë të kërkoj lëmoshë, por ndonjëherë unë mbledhë kanaqe dhe metale. Prindërit e mi nuk dëgjuan punëtorët social."

Në përgjithësi, diskutimi i kufizuar tregoi se fëmijët kanë një njohuri për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe gjithashtu patën një ndërveprim me këta profesionistë. Në disa raste kjo shpiu tek rezultati pozitiv, edhe pse jo gjithmonë qëndron kështu. Për më tepër, intervenimi nuk duket të jetë gjithmonë sistematik, më shumë është një projekt i bazuar dhe jo gjithmonë është bashkërenduar në mes të institucioneve. Në mesin e fëmijëve, një gjetje tjetër e rëndësishme se ata ushqejnë më shumë ndjenja negative ndaj kërkimit lëmoshë, duke menduar se mbledhja e kanaqeve dhe metaleve ishte më e pranueshme. Sidoqoftë, ata i ishin të pavëmendshëm, që në

---

marrin pjesë në programe sociale. Sa i përket shëndetit, ky program ofroi arsimim për ushqimin e shëndetshëm dhe praktika, si dhe ofroi medikamente falas për fëmijët e sëmurë. Ndërkaq sa i përket arsimimit, ky program ndihmoi fëmijët me integrim në shkolla ose riintegrim. Në shumë raste profesionistët biseduan me prindërit mbi rëndësinë e shkollës dhe rreziqet që fëmijët e tyre i ishin ekspozuar kur ishin lënë ose ishin detyruar për të kërkuar lëmoshë dhe për të punuar në rrugë."

fakt, kjo formë e punës së vështirë për fëmijë ishte pothuajse e barabartë e mos më e dëmshme dhe më e rrezikshme për mirëqenien e tyre.

VII. Reagimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijës për FnL

Siç është përvijuar në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, (SMF) përbëhet nga një numër i akterëve, duke filluar nga familja e deri tek përfshirja e një numri profesionistësh si punëtorët social, policia, profesionistët në arsimim, kujdesin shëndetësor dhe çdo kënd tjetër që ka për detyrë kujdesin ndaj fëmijës. Për shkak të rreziqeve të ndryshme me të cilat FnL mund të ballafaqohen gjatë lëvizjeve të tyre, është e rëndësishme që këta fëmijë të mos jenë të padukshëm për SMF-të dhe se një sistem i tillë është në gjendje që t'i përgjigjet në mënyrë të bashkërenduar parandalimit të keqpërdorimit, si dhe intervenimit kurdo që është në interesin më të mirë të fëmijës në rrezik.

Një planifikim i përgjithshëm dhe vlerësim i sistemit të mbrojtjes së fëmijës në Republikën e Kosovës i kryer në vitin 2012, përvijon shumë mangësi të SMF-së aktuale në lidhje me fëmijët. Kjo përfshinë mungesën e të dhënave gjithëpërfshirëse që janë mbledhur, që nuk janë shpërndarë në baza multi-sektoriale. Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, thuhet së një bazë e të dhënave gjithëpërfshirëse e të gjithë fëmijëve që janë abuzuar, maltretuar apo shfrytëzuar në Kosovë, nuk ekziston. Ngjashëm, sa i përket raportimit të llojeve të ndryshme të dhunës, gjithashtu theksohet se nuk ka asnjë mekanizëm në funksion, asnjë formë të standardizuar të raportimit ose gjurmimit të rastit, ndërkaq në mesin e fëmijëve është thënë se ka pak ose aspak dijeni mbi atë se si mund të raportohet dhuna.[178] Një tjetër mangësi e identifikuar është mungesa e bashkërendimit ndër-institucional në mes të akterëve të mbrojtjes së fëmijëve, edhe pse është pranuar se disa hapa pozitiv ekzistojnë si Doracaku për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe qasja multi- disiplinare për mbrojtje të fëmijës në nivelin lokal, kryesisht të ofruar nga QPS[179]

Sido që të jetë, një mekanizëm bashkërendues institucional për mbrojtje është theksuar të mungoj. Një nga shembujt ekzistues i dhënë në Modelin e Taskë Forcës ose Tryezat për Menaxhimin e Rasteve (TMR), i implementuar nga Terre des hommes në bashkëpunim me QPS si dhe persona tjerë përgjegjës e që është njohur si një mekanizëm që ofron një qasje gjithëpërfshirëse multi-sektoriale ndaj mbrojtjes së fëmijës. Edhe pse, qëndrueshmëria e tij nuk mund të sigurohet përmes shoqërisë civile, ka nevojë që të përsëritet i njëjti në të gjitha komunat si dhe të institucionalizohet për të siguruar funksionim efikas.

[178] Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, 'Planifikimi dhe Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijës në Republikën e Kosovës', 2012, at p. 20
[179] Ibid, p. 21-22

Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet se Shtojca 1 tregon, se shtylla SMF është QPS-ja duke operuar ngushtë me banorët në nivel lokal. Ata kanë përgjegjësinë që të iniciojnë hetime për të gjitha rastet e abuzimit, neglizhimit, maltretimit dhe shfrytëzimit me ndihmën e një sërë personash përgjegjës, si dhe të qenit e obliguar që të ndihmoj personat e ndryshëm përgjegjës në përmbushjen e detyrave të tyre, si autoritet i fuqizimit të ligjit në lidhje me fëmijët në konflikt me ligjin ose DSHAM në rastet e fëmijëve që kërkojnë azil. Në këtë kuptim, situata aktuale e QPS dhe shërbimet sociale në përgjithësi është një rrethanë e rëndësishme, sidoqoftë, nuk ekziston hulumtim i përditësuar gjithëpërfshirës lidhur me këtë fushë.

Hulumtimi i mëhershëm nga viti 2004 tregon se një numër i punëtorëve social që punojnë brenda komunës është relativisht i vogël kur krahasohet me tërë popullatën e asaj komune. Për shembull është thënë se mesatarja për Kosovën si tërësi është një punëtor i shërbimit social për 7,859 banorë,[180] e që është në mënyrë të konsiderueshme më i ulët se Standardet Evropiane Perëndimore. Në këtë kuptim, Finlanda është përdorë në studim si krahasues, ku mesatarja është një punëtor i shërbimit social për 2,000 banorë. Nëse kjo ndahet sipas grupeve etnike, për vendet me shumicë shqiptare, mesatarja është një punëtor i shërbimeve sociale për 9,146 banorë, ndërkaq për vendet me shumicë serbe është një punëtor i shërbime sociale për 3,816 banorë.[181] Për më tepër, QPS-ja nuk shikohet si prioritet dhe vuan nga buxheti i ulët, që pengon aftësinë e saj për të ofruar shërbimet e nevojitura.

Në Kosovë, SMF me siguri përfshinë një numër të akterëve dhe listën e personave përgjegjës e cila zgjerohet më tej në lidhje me FnL meqë i referohet atyre fëmijëve që jetojnë jashtë mjedisit mbrojtës, të trafikuar ose në rrezik të të qenit i trafikuar, fëmijëve që kërkojnë azil dhe fëmijëve të kthyer. Sidoqoftë, lidhur me të gjitha këto kategori QPS-ja duhet të jetë në gjendje që të ofroj shërbime në një mënyrë gjithëpërfshirëse, të jetë e qasshme, të ketë një shtrirje adekuate dhe të mjaftueshme. Në shkëmbim, të gjitha këto çështje do të merren parasysh në detaje edhe në frymën e hulumtimit në terren që është kryer me persona të ndryshëm përgjegjës.

a. Ngritja e vetëdijes së personave përgjegjës për SMF

Në mënyrë që të vlerësohet përgjigja e akterëve të ndryshëm brenda SMF, personat përgjegjës në mënyrë specifike u pyetën për atë se çfarë dinin lidhur me SMF dhe se ku mund të gjendej ky. Në këtë kuptim, shumica e personave përgjegjës iu përgjigj këtyre pyetjeve, edhe pse ka dallime mbi atë se çfarë nënkuptohet me SMF, duke menduar se kush janë personat përgjegjës që përbëjnë SMF dhe se ku mund të gjenden brenda komunës së caktuar.

[180] Briscoe, S. 'Numri i Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale në QPS në Kosovë', Grupi Helsinki , 2004
[181] Ibid

Shumica e punëtorëve social që ishin intervistuar për këtë hulumtim thanë se QPS është një pjesë përbërëse e SMF dhe si të tillë shpjeguan sistemin nga perspektiva e tyre. Një punëtor social nga QPS në Obiliq shpjegoi se si QPS merren me të gjitha rastet e fëmijëve që referohen tek ta. Asistenca që QPS-ja ofron asistencën sociale përmes skemës së asistencës sociale dhe shërbimeve sociale për familjet dhe fëmijët në nevojë. Në këtë kuptim, punëtori social pranon se ata nuk mund të përmbushin të gjitha kërkesat dhe ndonjëherë marrin ndihmë materiale nga OJQ-të. Ai gjithashtu thotë se QPS ka Task Forcën/TMR-në, edhe pse kjo nuk është ende plotësisht operacionale. Në ndërkohë, punëtori social i QPS-së në Prishtinë sqaron se QPS-ja menaxhon Autoritetin e Kujdestarisë, si dhe bën monitorimin e situatës së fëmijëve për të konstatuar se a kanë nevojë ata për ndihmë shtesë. Në rastet kur kanë nevojë, kjo iu referohet ofruesve të ndryshëm si OJQ-të ose strehimores si dhe QPS ndihmon me integrimin brenda familjes, shoqërisë dhe shkollës. Për këtë punëtor social, SMF ndaras nga QPS mund të gjendet në mesin e profesionistëve tjerë duke përfshirë OJQ-të, shtëpitë e strehuese dhe psikologët.

Policët ndonjëherë tentojnë që të shikojnë SMF nga perspektiva e tyre dhe si të tillë shpiegojnë mandatin e tyre sipas zonës specifike të patrullimit në të cilin ata janë specializuar. Për shembull, një polic nga Njësia Kundër Trafikimit në Pejë (Sektori për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Femrave) tha “Unë kam takime me organizata tjera që punojnë në mbrojtjen e fëmijës për të trajtuar probleme të mundshme në rajonin e Pejës edhe në nivelin nacional.” Ai gjithashtu theksoi se ekziston një marrëveshje ndër-shtetërore me Shqipërinë dhe Malin e Zi sepse fëmijët po shfrytëzohen dhe se OJQ-të janë veçanërisht aktive në këtë fushë dhe ka mbështetur profesionistët përmes trajnimit. Sido që të jetë, lidhur me atë se ku mund të gjenden SMF, ai iu referua OJQ-ve dhe Task Forcës/TMR-së, të cilën ai e ka ndjekë dhe thotë se ky mekanizëm është përdorur për të bashkërenduar veprimet në një rast të caktuar nga persona të ndryshëm përgjegjës. Sipas policit të Njësisë së Komunitetit Policor, roli i policisë brenda SMF-së është që të identifikoj fëmijët në rrezik dhe të siguroj që ata të jenë të mbrojtur. Në raste të tilla ai tha se ata bashkëpunojnë ngushtë me QPS, veçanërisht kur kanë nevojë të intervistojnë fëmijët e tillë, si dhe bashkëpunojnë me QPS në rastet kur fëmija është në konflikt me ligjin. Ngjashëm, një polic nga Njësia e Komunitetit Policor në Prishtinë thotë se SMF mund të shihet si një sistem për të parandaluar fenomenin negativ si fëmijët në rrugë dhe se është i përbërë nga institucionet e ndryshme si QPS-të dhe OJQ-të.

Ndërkaq, drejtori i Strehimores për Viktimat e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Prishtinë, i cili ofron shërbime në emër të personave përgjegjës tha se "shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve janë të mira pasi që ekziston një bashkëpunim i ngushtë". Ajo përmendi një Marrëveshje të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës dhe njësive të Policisë, që të gjithë janë anëtarë të Task Forcës/TMR dhe puna në ekipe shumë-disiplinore, të cilat ajo thotë se janë shumë më efikase.

Përderisa, ekzemplari i personit përgjegjës ishte relativisht i vogël dhe nuk mund të mos jetë përfaqësues, në bazë të këtyre komenteve është e qartë se aktorë të ndryshëm e shohin veten të përfshirë në SMF dhe shumë prej tyre i referohen Task Forcës/TMR si një mekanizëm që ata i bashkon. Megjithatë, Task Forca apo Tryeza për Menaxhimin e Rasteve ende nuk është institucionalizuar, kjo pjesërisht shpjegon faktin se jo të gjithë personat përgjegjës të intervistuar flisnin me lehtësi në lidhje me SMF. Përveç kësaj, këto pikëpamje gjithashtu tregojnë se duhet të ketë fokus shtesë për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë dhe në veçanti për ngritjen e vetëdijes në lidhje me SMF në mesin e personave përgjegjës dhe publikut të gjerë. Kjo është e rëndësishme sepse siç mund të shihet nga pikëpamjet e ndryshme të shprehura, raportimi i detyrueshëm nuk është përmendur si një detyrim ose një mënyrë me anë të të cilit një person përgjegjës i cili nuk është një punëtor social, të jetë i detyruar për të kontaktuar QPS. Në të njëjtën kohë, ndërsa OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm dhe nganjëherë mbushin boshllëkun në ofrimin e shërbimeve të ndryshme, ose duke qenë të nënkontraktuar ose duke dhënë ndihmë materiale, nuk është roli i OJQ-ve dhe as nuk është e qëndrueshme për të zëvendësuar detyrimet statutore të autoriteteve publike.

b. Vetëdijësimi i personave përgjegjës për FnL

Pasi që ky raport i detajuar për FnL mbulon fëmijët në situata të ndryshme dhe si një përkufizim është qëllimisht fleksibil, pasi ajo njeh disa nga cënueshmëritë e përbashkëta me të cilat përballen fëmijët, derisa janë në lëvizje. Në të njëjtën kohë, edhe pse këta fëmijë në Kosovë që janë të pranishëm në zonat urbane dhe pjesë të qyteteve që janë të frekuentuara gjerësisht, ata nuk janë gjithmonë të dukshëm për institucionet. Si të tillë, për qëllimet e këtij raporti, personat përgjegjës u pyetën kush ishin këta fëmijë dhe/ose prej nga ata vijnë, me qëllim të vlerësimit të vetëdijesimit të tyre të përgjithshëm, si dhe t'u ofrojnë atyre mundësinë për të dhënë hollësitë specifike të rasteve ku ata u kanë dhënë ndihmë FnL në Kosovë.

Një nga pikëpamjet e përbashkëta në mesin e personave përgjegjës rreth FnL është se ata vijnë nga Shqipëria. Shefi i Njësisë së Trafikimit me Qenie Njerëzore në Pejë ka deklaruar "që ata trafikohen nga Shqipëria dhe nga brenda Kosovës. Aktualisht ka më tepër viktima brenda vendit, që edhe kërkojnë lëmoshë edhe merren me prostitucion". Përveç kësaj, ai tha se "ka raste të fëmijëve të trafikuar nga Kosova në Mal të Zi". Megjithatë, fëmijët në ato raste "ne i riatdhesojmë dhe kemi pasur bashkëpunim të mirë me autoritetet atje", ka thënë zyrtari policor.

Përveç kësaj, personat përgjegjës gjithashtu kanë vërejtur se në shumicën e rasteve, fëmijët janë me prejardhje shumë të varfër socio-ekonomike, shumë prej tyre në varfëri të skajshme, si dhe

nga radhët e komuniteteve pakicë, sidomos komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian (RAE). Për shembull, shefi i Njësisë së Trafikimit me Qenie Njerëzore në Pejë deklaroi se "shumica e fëmijëve në lëvizje janë nga komunitetet RAE nga Shqipëria dhe ata fitojnë të holla duke qëndruar në rrugë." Kështu, ai i referohej kryesisht kërkim lëmoshës. Në mënyrë të ngjashme, në Mitrovicë, Zyrtari për Komunitete dhe Kthim shpiegon se FnL janë ata fëmijë të cilët zakonisht përballen me një jetë të vështirë për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së tyre dhe nuk kanë kujdesin e duhur. Në Mitrovicë këta janë "fëmijë nga Mahalla e Romëve që ecin çdo ditë nga lagjja e tyre në Mitrovicë për në Zveçan që të kërkojnë lëmoshë apo të mbledhin kanaqe", tha zyrtari. Disa prej tyre e bëjnë këtë atë para ose pas shkollës, ndërsa të tjerët nuk shkojnë në shkollë fare dhe e kalojnë ditën duke i kryer këto lloje të aktiviteteve. Ata shkojnë atje duke ecur, sepse ka më shumë për të mbledhur atje.

Përveç vetëdijësimit në rritje të disa prej FnL, posaçërisht në lidhje me trafikim, një nga personat përgjegjës ishte në gjendje të shpjegojë trendët që janë zhvilluar në këtë fushë përgjatë viteve. Drejtori i Strehimores për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prishtinë ka thënë se duke punuar me fëmijë të trafikuar që nga viti 2002, ata vërejnë se prejardhja e viktimave të tyre ka filluar të ndryshojë. Deri në vitin 2009, shumica e viktimave kanë qenë nga jashtë, megjithatë, "që nga viti 2008/2009 ne jemi bërë një vend i origjinës dhe më shumë viktima janë nga Kosova". Sa i përket rasteve brenda Kosovës, Drejtori thotë se "ka një rritje në rastet e fëmijëve të trafikuar nga fshatrat".

Megjithatë, ka edhe persona përgjegjës që nga praktika nuk janë të vetëdijshëm për FnL. Për shembull, një punëtor social nga Mitrovica shpjegoi se "QPS-ja bashkëpunon me policinë në këto raste dhe ne kemi një plan veprimi, por ne nuk kemi shumë prej këtyre rasteve". Përderisa shumica e personave përgjegjës ishin në gjendje që t'i referohen disa nga fëmijëve që mund të definohen si FnL, ata nuk ishin në gjendje të identifikojnë në mënyrë sistematike të gjithë ata. Kjo tregon se personat përgjegjës në Kosovë nuk janë plotësisht të vetëdijshëm se kush janë FnL; si dhe cilat janë arsyet e tyre ose faktorët shtytës për lëvizje. Në mënyrë që këta persona përgjegjës të jenë në gjendje që t'u përgjigjen nevojave të tyre, është e rëndësishme që ata të kenë ndërgjegjësim më të mirë në lidhje me këtë grup të fëmijëve dhe të dinë cenueshmëritë me të cilat ballafaqohen. Përveç kësaj, kjo rritje e vetëdijesimit duhet të kryhet duke përdorur të dhëna të besueshme në mënyrë që të mos ketë keqkuptime apo mite, për shembull që të gjithë fëmijët në rrugë janë të trafikuar ose të detyruar nga prindërit e tyre, që nuk është gjithmonë e vërtetë. Megjithatë, nëse ka raste të tilla atëherë sistemi duhet të jetë në gjendje të përgjigjet në mënyrë adekuate, gjë që do të përfshinte personat përgjegjës duke punuar së bashku në identifikimin e fëmijëve që janë trafikuar, për të ofruar asistencën e nevojshme, si dhe kryerjen e hetimeve për krimet që mund të kenë qenë të kryera ndaj këtyre fëmijëve. Në të njëjtën kohë, QPS-ja gjithashtu duhet të jetë në gjendje t'i njehë dhe ndihmojë rastet tjera të tilla si ato që janë jashtë një mjedisi mbrojtës, nëse ata gjenden duke lypur apo mbledhur metale/kanaçe, gjë që i ekspozon ata ndaj një vargu të rreziqeve dhe që i ndalon ata të shkojnë në shkollë.

c. Qasja dhe arritshmëria

Pothuajse të gjithë personat përgjegjës të kontaktuar për qëllimet e këtij hulumtimi, kur u pyetën se a është QPS e arritshme si dhe a ofron shtrirje në terren, u përgjigjën se QPS-ja nuk është mjaftueshëm e arritshme dhe nuk ofron shtrirje të mjaftueshme, gjë që mund të ketë ndikim të dëmshëm në mbrojtjen që duhet të sigurohet për FnL. Për shembull, një punëtore sociale nga Ferizaj tha se "nuk është shumë e arritshme; është shumë e vështirë të bëhet lidhja midis punëtorit social dhe fëmijëve ". Ajo vazhdon të shpjegojë se ndërsa fletëpalosjet shpërndahen për shërbimet që janë në dispozicion, disa familje kërkojnë këto shërbime dhe ky informacion gjithashtu shpërndahet në media, edhe pse ajo e identifikon sektorin e arsimit si problematik. Kjo është për shkak se, sipas saj "mësimdhënësit mendojnë se ata mund të menaxhojnë vetë mbrojtjen e fëmijës, kurse në të vërtetë kjo është detyrë e QPS-së".

Të njëjtën kohë, disa persona përgjegjës të caktuar përshkruajnë vështirësitë me të cilat ata ballafaqohen derisa i përmbushin obligimet e tyre. Për shembull, një punëtor social në Pejë shpjegoi se “ne pyesim për emrat e tyre dhe për ndonjë informatë lidhur me gjendjen e tyre”. Megjithatë, ndonjëherë, sipas saj “fëmijët dyshojnë se ajo është nga policia dhe ata nuk dëshirojnë t’i flasin” asaj. Në anën tjetër, Udhëheqësi i Njësisë për Trafikim me Qenie Njerëzore në Pejë deklaroi “që t’i identifikojmë rastet, ne marrim informata nga Task Forca/TMR. Dy raste ishin iniciuar për shkak të informatave të pranuara atje”. Të njëjtën kohë, sipas tij, ende ekziston nevoja të arsimohen institucionet posaçërisht të fokusohen në Shqipëri, pasi që aty është origjina e shumë fëmijëve që vijnë në Kosovë. Sipas këtij mendimi, nëse ekziston vetëdijesimi më i lartë dhe bashkëpunimi më i mirë, trajtimi i rasteve do të jetë më i lehtë.

Për të rritur arritshmërinë, një OJQ lokale sugjeroi se duhet të ketë një numër lokal të telefonit ku mund të kontaktohen shërbimet sociale lidhur me ndonjë çështje për mbrojtje të fëmijëve. Të njëjtën kohë, QPS-ja duhet të ketë arritshmëri më të madhe dhe duhet të ketë më shumë investime në QPS për ta mundësuar këtë. Në përgjithësi është e rëndësishme të vërehet se të gjithë personat përgjegjës ishin të mendimit se nuk ka shtrirje të mjaftueshme në terren, që është kritike për FnL, në mënyrë që ato të kenë qasje në shërbimet më se të nevojshme. Është kritike se intervenimet e ardhshme nga QPS-ja apo OJQ-të të fokusohen në këtë çështje në mënyrë që të ketë shtrirje efektive, duke u mundësuar personave në nevojë të madhe që të kenë qasje në shërbimet sociale.

Ndërkohë, Koordinatori për Riatdhesim dhe Kthim në Komunën e Obiliqit, ngritë shqetësime tjera. Këto përfshijnë faktin se sistemi nuk është gjithmonë në gjendje të përgjigjet, pasi që është e vështirë për të identifikuar rastet, për shembull, kur fëmijët janë me aftësi të kufizuara, pasi që kjo nuk raportohet për shkak të stigmës dhe turpit lidhur me aftësinë e kufizuar në shoqërinë kosovare. Përveç kësaj, fëmijët nga komunitetet pakicë, thotë ai, mund të përballen me pengesa

në qasjen e shërbimeve për shkak të mungesës së dokumenteve, pasi që prindërit mund të mos e kenë regjistruar lindjen e fëmijëve të tyre.

d. Gjithëpërfshirja

Në mënyrë që një QPS të jetë efektive, ajo ka nevojë që të sigurojë që ajo është gjithëpërfshirëse, që do të thotë që ajo ka aftësinë për t'iu përgjigjur nevojave për mbrojtjen e të gjithë fëmijëve, përfshirë FL. Në këtë drejtim, personat përgjegjës u pyetën gjithashtu se a shikonin sistemin si gjithëpërfshirës në përgjigjen ndaj FL. Edhe një herë, shumica e personave përgjegjës u pajtuan se sistemi aktual nuk është mjaft gjithëpërfshirës dhe kjo sigurisht që është një fushë ku përmirësimet mund të bëhen në nivele të ndryshme.

Për shembull, Udhëheqësi i Njësisë së Trafikimit me Qenie Njerëzore në Pejë tha se "sistemi nuk është gjithëpërfshirës siç duhet të jetë për shkak se problemet vazhdojnë të përsërisin veten e tyre". Megjithatë, ai vazhdoi të shpjegojë se ky nuk është problem vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri. Në veçanti ai përmendi protokollin shtesë, faktin se ekzistojnë Koordinatorët Kombëtar në të dy vendet dhe se ka rekomandime, por zbatimi i tyre ende mungon në lidhje me viktimat e trafikimit.

Një nga aspektet më sfiduese të sistemit, i cili nuk lejon që ai të jetë gjithëpërfshirës, është kriteri i banimit brenda një komune në mënyrë që të marrin shërbime të parapara me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Një punëtore sociale në Pejë ka ngritur pikërisht këtë çështje, siç tha ajo "ligji nuk na detyron që t'i kushtojmë vëmendje të veçantë fëmijëve në lëvizje, por vetëm atyre që banojnë në komunë, ashtu që çdo QPS është përgjegjëse për rastet brenda komunës së tyre". Në këtë rast, qasja e saj ishte, siç tha ajo "kur të gjej një fëmijë nga një vend tjetër, unë përpiqem që t'i flas atij/asaj dhe ta këshilloj atë". Në mënyrë të ngjashme, Zyrtari për Komunitete dhe Kthim shpjegoi gjithashtu se shumë prej fëmijëve romë nuk marrin asnjë ndihmë sociale pasi që ata nuk janë të regjistruar dhe kjo i pengon ata që aplikojnë për ndihmë sociale, madje edhe në qoftë se ata do të ishin të kualifikueshëm.

Përveç kësaj ka fusha të veçanta të sistemit, për të cilat disa nga persona përgjegjës kanë pasur shqetësimet e veçanta dhe që ata i shohin si jo veçanërisht përfshirëse. Për shembull një OJQ lokale që punon me fëmijët romë tha se sfida më e madhe ka qenë në sistemin e arsimit, ku detyra e kujdesit që edukatorët kanë ndaj fëmijëve nuk është marrë mjaft seriozisht. Kjo është veçanërisht një çështje pasi ata janë marrë me rastet kur shkollat gjejnë një shumëllojshmëri të arsyetimeve për të kthyer fëmijët në shtëpi, duke i parandaluar ata nga shkollimi, gjë që mund të

rezultojë që fëmijët të dalin në rrugë për të kërkuar lëmoshë apo për të kryer aktivitete tjera, të cilat mund të jenë të dëmshme për mirëqenien e tyre.

Në të njëjtën kohë ka edhe shembuj pozitiv, siç janë shërbimet e ofruara në strehimore. Drejtori i një strehimoreje për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prishtinë, thotë se edhe pse ata janë të specializuar për të ofruar ndihmë për viktimat e trafikimit, kjo është në dispozicion për të gjithë pa marrë parasysh origjinën e tyre ose statusin ligjor. Në këtë drejtim, ajo shpjegon se më parë ata u kanë ofruar shërbime të tilla fëmijëve nga Shqipëria dhe Serbia. Në raste të tilla, kur është e sigurt të bëhet kjo, viktimat janë kthyer në vendin e tyre të origjinës në përputhje me procedurat kombëtare. Në mënyrë të ngjashme, një punëtor social nga Ferizaj thotë se "shërbimet janë të njëjta për të gjithë fëmijët; ne nuk kontrollojmë nëse ata janë nga vendet e tjera, edhe pse ne kemi pasur përvojë me fëmijë nga Shqipëria dhe Serbia". Në raste të tilla ajo vazhdon të shpjegojë se ne plotësojmë një formular vlerësimi dhe pastaj bashkëpunojmë me institucione nga vendet e tjera". Megjithatë, ajo nuk elaboron se çfarë shërbimet ofrohen dhe personat tjerë përgjegjës kanë deklaruar se ligji kërkon që ata të bëjnë dallime në aspektin e FnL nga vende të tjera dhe nganjëherë madje edhe nga komunat tjera.

Edhe pse diskriminimi nuk është ngritur si çështje në vetvete, ai megjithatë mbetet një shqetësim. Disa profesionistë kanë aluduar në faktin se ofrimi i shërbimeve bëhet në bazë të origjinës kombëtare, që do të thotë që fëmijët nga Shqipëria nuk janë në gjendje të kenë qasje në shërbime të caktuara duke përfshirë asistencën sociale apo arsimin. Kjo është pavarësisht nga fakti se Ligji Kundër Diskriminimit [182] e ndalon diskriminimin në bazë të një varg karakteristikash të mbrojtura, duke përfshirë kombësinë ose përkatësinë etnike[183] në një numër fushash, duke përfshirë; mbrojtjen sociale dhe të arsimit. [184] Megjithatë, në realitet zbatimi i dispozitave të tilla ka qenë i pamjaftueshëm dhe kjo situatë ka lënë viktimat e diskriminimit pa mbrojtje të mjaftueshme. Aktualisht, Ligji Kundër Diskriminimit është në proces të ndryshohet për të adresuar dobësitë në zbatim, duke përfshirë krijimin e një organi të barazisë për të trajtuar rastet e diskriminimit.[185]

[182] Ligji Nr. 2004/3

[183] Neni 2 (a) Ligji kundër Diskriminimit
[184] Neni 4, ibid
[4]Shih Iniciativën e Rinisë për të Drejta të Njeriut në Kosovë, 'Ligji kundër Diskriminimit në Kosovë – shtatë vite pas, dhjetor 2011

e. Përshtatshmëria

Një nga aspektet më të rëndësishme që ky hulumtim ka marrë parasysh është nëse SMF ofron mbrojtje adekuate për FnL. Shumë nga personat përgjegjës të intervistuar ishin pyetur të diskutojnë konkretisht këtë çështje dhe pikëpamjet e tyre janë portretizuar në këtë pjesë. Për shkak të hulumtimit të mëparshëm lidhur me çështjen e SMF në përgjithësi, ky raport fokusohet në pikëpamjet e personave përgjegjës të kontaktuar, në mënyrë që të sigurohet një perspektivë nga personat përgjegjës për ofrimin e mbrojtjes në nivel lokal.

Shumica e personave përgjegjës siguroi përgjigje në pyetjet lidhur me përshtatshmëri përmes përshkrimit të rolit të tyre brenda SMF, edhe pse kohë pas kohe ata kishin identifikuar se ka dobësi brenda sistemit. Si i tillë, është e rëndësishme të grupohen përgjigjet e profesionistëve, në mënyrë që të paraqiten ato në mënyrë koherente, duke i reflektuar anët e forta dhe të dobëta të identifikuara , me të cilat ballafaqohen personat përgjegjës gjatë punës së tyre ditore.

i. Identifikimi i FnL

Një nga dobësitë kryesore të identifikuara është fakti se përderisa punëtorët social ndonjëherë punojnë në terren për të identifikuar fëmijët në nevojë, një punëtor social nga Prishtina shpjegoi se zakonisht ata "nuk e bëjnë këtë për FnL dhe në një mënyrë nuk bënë shumë për FnL". Kjo pikëpamje paraqitet nga një tjetër punëtor social nga një QPS tjetër në Prishtinë i cili thotë "sistemi nuk është adekuat, sepse ai fokusohet vetëm në përgjigjen pasi të jetë bërë dëmi, që do të thotë se nuk është bërë shumë në mbrojtje". Në anën tjetër, një punëtor social nga Prishtina thotë "duke pasur parasysh se këta fëmijë vazhdojnë të qëndrojnë në rrugë duke kërkuar lëmoshë, është e qartë se shoqëria nuk është duke bërë mjaftueshëm për ta dhe as institucionet. Për këto raste, është shumë e rëndësishme që të punojmë së bashku dhe të ketë bashkëveprim dhe bashkëpunim më të mirë në mes të institucioneve në mënyrë që të ketë përgjigje adekuate ndaj nevojave të FnL". Në pajtim me shumë kolegët e tij të intervistuar, punëtori social nga Obiliqi tha se sistemi nuk ofron mjaft shtrirje dhe nuk është në gjendje të përgjigjet ndaj të gjitha nevojave të fëmijëve. Megjithatë, sipas tij, kushtet e punës së punëtorëve social gjithashtu kanë ndikim, pasi që ato janë mjaft të këqija. Përmirësimi kushteve do të ndikonte drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për optimizmin e rezultateve.

Në një rast me të cilin kishte të bënte një punëtor social nga Prishtina, ku një familje kishte 8 fëmijë, të cilët ishin ri-integruar në shkollë. Megjithatë, edhe pse QPS-ja i kishte folur prindërve, ata prapë kërkojnë lëmoshë pas shkollës, që i ekspozon ata ndaj një varg rreziqesh. Punëtori social gjithashtu shton se fëmijët janë të detyruar të kërkojnë lëmoshë ose të punojnë për shkak të varfërisë apo pse prindërit e tyre janë të sëmurë. Në të dy rastet ajo vëren se si QPS ata duhet të

punojnë me prindër, por ata nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë për shkak të kufizimeve financiare. Në këtë drejtim, ajo rekomandon se qeveria duhet të bëjë më shumë lidhur me këta fëmijë, si dhe të avokojnë për publik të mos u japin të holla fëmijëve që shihen duke kërkuar lëmoshë. Ngjashëm thotë edhe një punëtor social "ndonjëherë fëmijët gjinden në situata kur ata duhet të kërkojnë lëmoshë dhe kjo është për shkak të politikave të këqija, shembulli më i mirë është skema e asistencës sociale". Për shkak të pengesave të ndryshme, edhe në rastet kur fëmijët hiqen nga rruga, nuk ka zgjidhje të qëndrueshme që mund t'i sigurohen familjes. Në këtë aspekt, punëtori social beson se shumë mbetet për t'u bërë në mënyrë që të mbrohen të gjithë fëmijët,duke përfshirë edhe ata në lëvizje. Në dritë të përvojës së këtyre punëtorëve social, është e qartë se ka probleme funksionale brenda sistemit, që e pengojnë atë nga ofrimi mbrojtjes adekuate për FnL.

Ndërkaq, një punëtor social nga Peja shpjegon se një rast me të cilin ajo ishte marrë me disa fëmijë nga Gjakova dhe pas identifikimit, ajo i drejtoi at në QPS të Gjakovës. Në rastet e trafikimit, ajo shpjegoi se si punëtorë social zakonisht thërret policia dhe koordinohen me komunën përgjegjëse. Në rastet kur fëmija ka ende nevojë për kujdes mjekësor, punëtori social do ta koordinojë këtë me ofruesin profesional të shërbimeve mjekësore. Në Pejë, ajo ishte marrë me 5 raste të trafikimit, Përveç kësaj, ajo shpjegon se "ka pasur raste të fëmijëve që kanë shkuar në Prishtinë për të kërkuar lëmoshë dhe për një periudhë, këta fëmijë janë vendosur në strehimore". Për këtë punëtor social, megjithatë, vështirësitë kryesore përfshijnë punën me fëmijë dhe prind nga komuniteti RAE, që ka të bëjë me rritjen e FnL, sipas stinëve dhe këtyre fëmijëve që kërkojnë lëmoshë. Lidhur me komunitetin RAE, ajo shpjegon se sfidë kryesore janë kushtet ekonomiko-sociale, që do të thotë se prindërit zakonisht janë të paaftë të gjejnë punë dhe asistencë tjetër sociale, për çka ata mund të mos kualifikohen, nuk ka mbështetje tjetër për tu ofruar. Në dritë të kësaj situate, ofrimi i asistencës, veçanërisht në këto raste, është veçanërisht sfidues, thotë ajo.

Përveç kësaj, ajo thotë se komuna ka linjën emergjente 24 orë, një shërbim që ekziston në komuna tjera për aq sa ajo din, edhe pse ekzistojnë sfida të mbetura kur kemi të bëjmë me FnL. Një nga këto raste është fakti se QPS-ja nuk ka fond për të ndihmuar fëmijët në situata emergjente, që do të thotë që nëse fëmija ka nevojë për ushqim, "ne paguajmë për këtë nga xhepi jonë" shpjegon punëtorja sociale. Ajo gjithashtu vëren se ndonjëherë, ata bëjnë përpjekje për të vendosur se çka të bëjnë në ndonjë rast konkret. Kjo është në rastet kur fëmija nuk dëshiron të kthehet në komunën prej nga ka kanë ardhur, "nuk mund t'i detyrojmë ata dhe është vështire të vendosim se çka të bëjmë me ta". Në disa raste fëmija gjithashtu mund të ketë nevojë të vendoset në strehimore, dhe nganjëherë ka mungesë të vendeve në strehimore. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të ceket se kriteret rigoroze të strehimoreve mund të paraqesin problem, siç thotë punëtori social "disa strehimore nuk pranojnë djemtë mbi moshën 12 vjeçare, përderisa fëmijët nën moshën 14 vjeçare nuk pranohen pa prindërit e tyre".

Një sfidë shtesë të cilën ajo e identifikon është fakti se ka dallime të vogla, por të rëndësishme që duhet të merren parasysh, që nuk ndodh gjithnjë dhe kjo mund të ndikojë në përgjigje. Për shembull ajo thotë se në Kosovë, shumica e FnL "nuk janë pa kujdes prindëror, por ata më shumë neglizhohen dhe është një dallim i vogël ndërmjet trafikimit dhe prostitucionit". Prandaj, duhet t'i shqyrtojnë këto raste me kujdes, posaçërisht prokuroria dhe polica. Të njëjtën kohë, punëtorët social duhet të sigurojnë se ata nuk shikohen nga familjet si armiq dhe ata duhet të kenë mbështetjen e policisë dhe gjykatave, kur ata përpiqen ta kryejnë obligimin e tyre në ofrimin e mbrojtjes. Përkundër raportimeve se ka fëmijë nga Shqipëria që vijnë në Pejë, ky punëtor social raportoi se ajo nuk e dinte për Protokollin Shtesë, që ekziston në me të Kosovës dhe Shqipërisë lidhur me fëmijët e trafikuar.

ii. Mandati i gjerë dhe bashkëpunimi

Një element tjetër thelbësor që ndikon në përshtatshmërinë e QPS është mandati i tyre i gjerë, që ka aspektet pozitive dhe negative. Siç e përshkruan punëtori social nga Ferizaj, QPS-ja ofron një varg aktivitetesh, duke përfshirë mbledhjen e "Autoritetit Kujdestar dhe Task Forcës/TMR, si dhe ofrimin e vizitave në familje, këshillimi, kurse profesionale, qasje te psikologu, mbështetje gjatë ri-integrimit, si dhe mbështetje materiale për familje". Mandati i gjerë nënkupton që janë **"one stop shop"** pa burime adekuate njerëzore ata nuk janë në gjendje të plotësojnë rolin e tyre. Përveç kësaj, nganjëherë ata mund të mos jenë në gjendje të përqendrohen në kategori të veçanta siç janë FL, pasi që nevojat e mbrojtjes mund të jenë komplekse.

Pasi që nevojat për mbrojtje të FnL ndryshojnë me lëvizjet e tyre, bashkëpunimi me homologë në vende të ndryshme, qoftë në rajon ose më gjerë është një aspekt tjetër i rëndësishëm. Në këtë drejtim, një punëtor social nga Ferizaj citoi një shembull kur kishin të bënin me një rast të fëmijës nga Serbia. Ata u pajtuan me autoritetet përkatëse që të takohen te kufiri për të dorëzuar fëmijën dhe kjo u bë pa asnjë problem. Nga ana tjetër, sa i përket bashkëpunimit me Shqipërinë, punëtori social shpjegoi se ata e dinë se është nënshkruar Protokolli Shtesë. Megjithatë, në kushte praktike, punëtori social tha se policia ka një plan të veprimit, që përfshin policinë të shoqëruar me punëtorët social për të identifikuar familjet shqiptare në rrugë. Rastet që janë identifikuar që qëndrojnë në mënyrë ilegale në Kosovë dërgohen në gjykatë dhe mandej kthehen në Shqipëri. Sa i përket qasjes në shërbime, ekzistojnë kriteret për asistencë sociale tha punëtori social, që nënkupton nënshtetësinë, edhe pse në raste emergjente, siç është trafikimi, ata do të ndihmohen. Në përgjithësi, duket se kur punëtorët social merren me ato raste nuk e marrin rolin udhëheqës domosdoshmërish, ata më tepër tentojnë t'i ndihmojnë personat tjerë përgjegjës, siç është policia. Edhe pse kjo mund të jetë mënyrë e duhur për të punuar, sa i përket qëndrueshmërisë së fëmijëve të gjetur duke kërkuar lëmoshë, QPS-ja duhet të shqyrtojë zhvillimin e planeve të veta të veprimit , ashtu që ata t'i kërkojnë këta fëmijë në mënyrë pro-

aktive dhe të gjejnë mënyra për t'i plotësuar nevojat e tyre për mbrojtje. Të njëjtën kohë, është evidente se ekzistojnë shembuj pozitivë siç është ai i cituar me Serbinë, i cili është menaxhuar në mënyrë të suksesshme për shkak të vullnetit të punëtorëve social.

iii. Task Forca/Modeli i TMR-së

Në mënyrë që këto raste të trajtohen në mënyrë efektive, Task Forca/TMR-ja shikohet si një mekanizëm i rëndësishëm, pasi që të gjithë personat përgjegjës e dinë se cilat janë përgjegjësitë e tyre dhe i mbajnë kontaktet me punëtorin social. Megjithatë, ende ekzistojnë probleme lidhur me rastet ku gjendja socio-ekonomike e familjeve është shumë e varfër dhe një nga fëmijët është trafikuar. Për QPS-në, është posaçërisht sfiduese, pasi që ata nuk kanë të holla për t'i ndihmuar ata, madje as për t'i mbuluar shpenzimet elementare siç është dreka në stacionin e policisë. Një punëtor social rekomandoi se duhet të ekzistojë një fond i posaçëm për t'u marrë me këto raste, sepse ai thotë "ne jemi këtu për t'i mbrojtur ata, por ne nuk kemi mjaft për t'i mbuluar nevojat e tyre elementare". Ai vazhdon duke thënë se ky aspekt është posaçërisht i rëndësishëm sepse pas decentralizimit, QPS-ja supozohet të jetë përgjegjësi kryesor, por ata janë lënë të ofrojnë mbrojtje pa mjete, pasi që ata nuk janë prioritet sa i përket financimit brenda në komunë. Si e tillë, mbrojtja e ofruar nga OJQ-të është absolutisht vendimtare për t'i plotësuar mangësitë që ekzistojnë.

iv. Posedimi i një plani operacional

Policia është gjithashtu e përfshirë në faza të ndryshme kur kemi të bëjmë me sigurimin e mbrojtjes për FnL. Udhëheqësi i Njësisë së Trafikimit me Qenie Njerëzore në Pejë deklaroi se si Polici "ne kemi planet operacionale dhe veprojmë sipas kërkesave;" edhe pse herë pas here "neve na kërkohet të ndërmarrim veprime kundër prindërve që i qesin këta fëmijë në rrugë". Përshtypja e tij ishte se "institucionet punojnë më mirë së bashku në nivel kombëtar", ndonëse "ka nevojë për më shumë përkushtim nga të gjitha institucionet në përgjithësi". Sa i përket asistencës, kjo zakonisht u ofrohet vetëm fëmijëve nga Kosova "përveç nëse konstatohet që ata janë viktima të trafikimit". Përveç kësaj, lidhur me trafikim, ai theksoi se nuk ka shumë raste, zakonisht ato kanë të bëjnë me prostitucion dhe se "ne i kemi pasur vetëm dy raste të fëmijëve". Sa i përket ofrimit të shërbimeve, policia nuk ka buxhet të veçantë për mbrojtje të fëmijëve, edhe pse, ai deklaroi se buxheti për shpenzime operacionale gjithashtu përdoret për fëmijë. Në anën tjetër, Oficeri i policisë në Prishtinë tha se ai u pajtua se sistemi mund të përmirësohet sa i përket shtrirjes dhe përfshirjes dhe ai rekomandoi se institucionet e përfshira në sigurimin e mbrojtjes duhet veçanërisht të fokusohen në arritje të FnL.

v. Perspektiva e OJQ-ve

Nga perspektiva e OJQ-ve, Drejtori i Strehimores për Viktimat e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Prishtinë tha se në aspektin e mbrojtjes së ofruar, Task Forca/ TMR-ja është një nga mënyrat në të cilat ekipet shumë-disiplinore mund të bashkohen dhe të ndërhyjnë në mënyrë efikase. Përveç kësaj, si një ofrues i shërbimit, strehimorja zakonisht ka bashkëpunim të mirë me QPS-në, në të cilin mbështetet për identifikim. Megjithatë, kjo nuk vlen për të gjitha QPS-të, pasi që strehimorja nganjëherë has në vështirësi në bashkëpunim me QPS-në jashtë Prishtinës, në qytete si Peja dhe Prizreni. Zakonisht, Drejtori shpjegon se kjo është për shkak se QPS-ja nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për t'u marrë me të gjitha këto raste dhe punëtorët social, për shembull, nuk kanë automjete për të shkuar për vizita në terren në mënyrë që të monitorojë gjendjen e një fëmije të veçantë

Probleme të tjera ekzistojnë në drejtim të ri-integrimit të viktimave, të cilat vazhdojnë të përsëriten sidomos në rastet e dhunës në familje ose sëmundjet mendore dhe këto janë përkeqësuar më tej, pasi familja nuk do të jetë e përfshirë. Ndërkohë, shumica e shërbimeve ofrohen nga OJQ-të, thotë drejtori i Strehimores. Përderisa Qeveria është e gatshme të japë disa të holla për ushqim, ajo nuk ofron shërbime të mjaftueshme dhe u lihet OJQ-ve që t'i mbulojnë ato.

Sipas një tjetër OJQ-je lokale, shërbimet e mbrojtjes vuajnë nga fondet e pamjaftueshme dhe kjo është një nga problemet kryesore. Si një OJQ, ata shpjegojnë se ata kanë mbledhur të holla për të ndihmuar fëmijët nga komunitetet RAE, duke u dhënë atyre rroba. Në të njëjtën kohë, perceptimi i tyre është që punëtorët social gjithashtu duhet të kuptojnë plotësisht mandatin e tyre në fushën e mbrojtjes më të mirë të fëmijëve, si dhe të jenë të përgatitur për të bërë vizita dhe të mbajnë kontakte me të gjithë anëtarët e komunitetit vendor, pavarësisht nga kushtet e tyre ekonomike ose mënyrës së jetës, që nuk është gjithmonë kështu. Megjithatë, mekanizmat lokal, siç është Task Forca/TMR-ja janë parë si një mënyrë që mundëson mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, edhe në qoftë se ajo nuk rezulton gjithmonë në një tregim të suksesshëm. Në një rast, OJQ-ja mori vesh për një fëmijë që ishte duke kërkuar lëmoshë, rreth 5-6 vjeç. Rasti i është referuar Task Forcës/TMR-së, që rezultoi në hetimin e policisë, e cila pas një hetimi zbuloi se fëmija nuk është duke jetuar me prindërit e tij, por me një familje tjetër, të cilët e shfrytëzonin atë. Ky rast kishte një rezultat pozitiv, si rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të policisë dhe punëtorëve social, pasi që fëmija u kthye te prindërit e tij, filloi të shkojë në shkollë dhe u ri-integrua. Megjithatë, në një rast tjetër kur një vajzë me aftësi të kufizuara u identifikua duke kërkuar lëmoshë, e cila iu referua Task Forcës / TMR-së, ka pasur vonesë në trajtimin e këtij rasti pasi që informata nuk arriti te personi i duhur.

Ndërkohë, në përvojën e Tdh-së sistemi i mbrojtjes së fëmijëve nuk i përgjigjet në mënyrë adekuate fëmijëve të kthyer. Kjo është për shkak se mungesa e burimeve financiare e bën të vështirë që Kosova të jetë në gjendje për të mbështetur plotësisht fëmijët që janë kthyer. Megjithatë, ka edhe shumë probleme praktike, duke përfshirë faktin se disa nga këta fëmijë nuk janë në shkollë për një varg arsyesh, duke përfshirë vështirësitë për t'i integruar në komunitetin e tyre të ri; dhe punëtorët social nuk janë të përfshirë në vlerësimin e këtyre rasteve dhe kryerjen e rregullt të vizitave familjare. Kjo është një dobësi e madhe në sistem sepse nuk janë marrë parasysh nevojat për mbrojtjen e fëmijës gjatë procesit të kthimit apo të ri-integrimit. Si rezultat, kjo lë këta fëmijë në një pozitë të cenueshme, ku të drejtat e tyre nuk respektohen dhe në disa raste ata mund të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme, siç është puna e rëndë apo edhe trafikimi. Për më tepër, shumica e fëmijëve të kthyer janë nga komunitetet RAE, që do të thotë se ata mund të përballen me pengesa shtesë në drejtim të barrierave gjuhësore dhe mungesës së mundësive.

Në përgjithësi, nuk mund të thuhet se sistemi i mbrojtjes është i përshtatshëm dhe është në gjendje për t'iu përgjigjur nevojave të mbrojtjes të FnL. Të njëjtën kohë, duhet pranuar se ekzistojnë disa shembuj pozitiv me personat përgjegjës, siç janë punëtorët social dhe policia, që punojnë shumë për këta fëmijë duke u kushtuar kohën dhe madje edhe burimet e tyre për t'u ofruar atyre mbrojtje. Në mënyrë të ngjashme, ka një bashkëpunim gjatë identifikimit në mes të personave përgjegjës, duke ofruar mbrojtje ose në mes të komunave apo edhe përtej kufijve. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se kjo nuk është e pranishme në tërë Kosovën dhe një sistem adekuat i mbrojtjes nuk mund të jetë i varur nga vullneti i individit. Në këtë drejtim, nuk ka plane konkrete se si t'u përgjigjet nevojave të mbrojtjes të FnL ose përmes mandatit të tyre të përgjithshëm të mbrojtjes ose duke u fokusuar në këtë kategori të veçantë. Në mënyrë të ngjashme, disa nga persona përgjegjës duket se nuk dinë shumë për këtë kategori të fëmijëve ose të standardeve në vend, siç është Protokolli Shtesë me Shqipërinë, të gjitha janë në dëm të fëmijëve të cilët janë në lëvizje. Pasi disa persona përgjegjës kanë vënë në dukje se duhet të ketë fokus më të madh në sigurimin se sistemi i mbrojtjes së fëmijëve është adekuat nëpërmjet procedurave më të mira operative dhe bashkëpunimit në mes të personave përgjegjës, duke përfshirë një fokus të veçantë në FnL.

Përfundim

Në përfundim, siç mund të pritet, FnL hasin në një varg të vështirësive dhe të rreziqeve; dhe pa një sistem efektiv të mbrojtjes së fëmijëve, ata në fakt janë lënë të kujdesen për veten e tyre dhe të detyruar të sillen si të rritur, duke humbur fëmijërinë e tyre. Ndërsa perceptimi i përgjithshëm mund të jetë se shumica e FL në Kosovë janë të detyruar të angazhohen në aktivitete të tilla, qoftë për shkak se ata janë trafikuar apo prindërit e tyre i detyrojnë ata për të kërkuar lëmoshë

apo për të mbledhur hekurishte, kjo nuk mbështetet gjithmonë. Në çdo rast, institucionet e ngarkuara me mbrojtjen e fëmijëve, siç janë QPS-ja dhe policia janë të detyruara për të siguruar mbrojtje për të gjithë fëmijët. Në mënyrë të ngjashme, të gjithë profesionistët e tjerë, të cilët kanë për detyrë të kujdesen ndaj fëmijëve, siç janë mësuesit dhe profesionistët e shëndetit kanë obligim ligjor për të raportuar çdo dyshim që ka lidhje me abuzim.

Realiteti në Kosovë është se FnL janë plotësisht të dukshëm, por sistemi nuk i sheh ata si mjaftueshëm shqetësues për t'u ofruar atyre mbrojtje. Disa institucione madje mund të besojnë se ne kemi nevojë për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e popullatës së përgjithshme në mënyrë që ata të mos i japin lypësve, në vend se të hetohen rastet në mënyrë pro-aktive dhe ofrimin e shërbimeve për këta fëmijë. Megjithatë, fëmijët të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim kanë qenë shumë të qartë, në shumicën e rasteve mjedisi i tyre i varfëruar i shtyn ata në rrugë dhe në shumë raste fëmijët ndihen përgjegjës që ata duhet të kontribuojnë në vend se vetëm të mbështeten në prindërit e tyre, pasi që situata në të cilën ata janë, do të thotë se ata nuk janë në gjendje për të mbuluar nevojat e tyre elementare. Në të njëjtën kohë, edhe personat përgjegjës pranojnë se nuk ka shtrirje të mjaftueshme në terren; shërbimet nuk janë gjithëpërfshirëse dhe jo gjithmonë të përshtatshme. Ndërsa ka arsye për këtë, duke përfshirë edhe faktin se mbrojtja sociale nuk shihet si një prioritet politik dhe ka kufizime financiare, ka ende mundësi për bashkëpunim në mes të personave përgjegjës dhe OJQ-ve, si dhe bizneseve. Megjithatë, personat përgjegjës në nivel qendror dhe lokal duhet të jenë më pro-aktiv në shfrytëzimin e këtyre mundësive, të cilat do t'u mundësojnë atyre t'i përmbushin detyrimet e tyre të mbrojtjes ndaj FnL.

Rekomandimet

- MPMS-ja së bashku me QPS-të duhet të zhvillojnë Procedura Standarde të Operimit (PSO) dhe një Protokoll për Mbrojtjen e Fëmijëve: në mënyrë që QPS-të të identifikojnë dhe ndihmojnë FnL pavarësisht nga prejardhja e tyre. Në veçanti është e rëndësishme të parashikohet se si QPS-ja do të identifikojë FnL, të bashkëpunojë me persona tjerë përgjegjës dhe QPS në komuna të ndryshme. Këto duhet të jenë të harmonizuara me ato të përdorura në Shqipëri dhe Mal të Zi, pasi që ka fëmijë nga Shqipëria në Kosovë, por edhe fëmijë kosovarë janë raportuar të jenë në Mal të Zi. Kur kjo të bëhet, është gjithashtu e rëndësishme të shqyrtohen PSO të ngjashme që mund të ekzistojnë në institucione të tjera, siç është Policia dhe Inspektorati i Punës;
- MPMS-ja dhe QPS-të duhet të sigurojnë se ekziston ndërlidhshmëri ndërmjet QPS-ve, kur kanë të bëjnë me fëmijët, të cilët janë në lëvizje në mes të komunave për të siguruar që informatat janë shpërndarë dhe shërbimet e nevojshme dhe mbrojtja është ofruar pavarësisht nga lëvizja;

- MPMS-ja dhe QPS-të duhet të zhvillojnë udhëzime: në mënyrë të veçantë duke detajuar se si e QPS-të janë për të ofruar shërbime, që të sigurojnë se këto janë përfshirëse për të gjithë FL;
- Çdo QPS duhet të zhvillojë një plan të veprimit: duke u mundësuar punëtorëve social në rajonet kryesore/qytetet ku ka shumë FnL në mënyrë që ata të identifikohen rregullisht dhe t'u ofrohen shërbime/mbrojtje. Kjo do të siguronte që kjo të jetë bërë në mënyrë pro-aktive, përkundër atyre në baza *ad hoc* dhe do të duhej të jenë të koordinuara/ harmonizuara me persona të tjerë përgjegjës, siç është policia;
- Të sigurojë trajnime të vazhdueshme për QPS-të dhe personat tjerë përgjegjës në lidhje me identifikimin e FL dhe se si të intervistohen FnL më së miri dhe t'u ofrojnë atyre shërbime adekuate dhe mbrojtje;
- MPMS-ja dhe QPS-ja duhet të zhvillojnë fushata: për SMF në drejtim të personave të tjerë përgjegjës veçanërisht duke u fokusuar në ata që janë të mbuluar nga raportimi i detyrueshëm, gjegjësisht, të gjithë ata me detyrë për përkujdesje ndaj fëmijëve, duke përfshirë mësimdhënësit dhe profesionistët e shëndetit. Përveç kësaj, QPS-të duhet të kryejnë fushata për të informuar të rriturit dhe fëmijët rreth shërbimeve që ato ofrojnë me fokus në FL;
- QPS-të duhet të sigurojnë mbrojtje adekuate për FnL: gjithmonë duke u udhëhequr nga parimi i asaj që është në interesin më të mirë të fëmijës dhe duke shfrytëzuar një qasje shumë-disiplinore në mënyrë që të gjithë personat përgjegjës relevantë të kontribuojnë në një rast të veçantë dhe, kur konsiderohet e nevojshme për menaxhimin e një rasti të vetëm ose nëpërmjet TMR-së;
- Të sigurojnë koordinim në mes të personave përgjegjës në radhë të parë në mes të QPS-ve dhe Policisë në nivel të Komunës, si dhe ndërkombëtarisht në lidhje me prejardhjen e FnL;
- Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit së bashku me MPMS-në dhe QPS-të duhet të rrisin vetëdijesimin për Protokollin Shtesë midis të gjithë personave përgjegjës, të organizojnë takime të tjera të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe të vendosin pikat e kontaktit për të rritur bashkëpunimin dhe implementimin e Protokollit;
- MPMS-ja duhet të ndajë praktikat më të mira në mes të komunave në mënyrë që të gjitha QPS-të të kryejnë rregullisht fushata në terren dhe të ofrojnë shërbime përfshirëse dhe adekuate në lidhje me FnL;
- Bazuar në trendet e paraqitura në këtë raport dhe në hulumtim tjetër, QPS-ja së bashku me personat tjerë përgjegjës dhe OJQ-të duhet në mënyrë pro-aktive të kërkojnë mënyra për të ndihmuar familjet dhe fëmijët në nevojë, siç janë hapja e qendrave rajonale për shërbime ditore, ku familjet dhe fëmijët mund të marrin shërbime të ndryshme siç janë këshillimi, ndihma mjekësore, numërimi dhe orët e shkrim-leximit, si dhe këshillat për qasjen ndaj përfitimeve të ndryshme nga shteti apo asistenca e OJQ-ve;

- Pasi varfëria është një nga arsyet kryesore për detyrimin e fëmijëve për të punuar apo kërkuar lëmoshë, personat përgjegjës, veçanërisht MPMS-ja së bashku me QPS-të dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të shqyrtojnë mënyra të reja për të punuar me familje duke ofruar këshilla dhe duke shfrytëzuar ndihmën e ofruar nga OJQ-të ose institucionet mikro-financiare për ta bërë më të lehtë për familjet që të marrin kredi për të ndihmuar ata që të dalin nga varfëria dhe të lejojnë fëmijët e tyre të kenë një arsim;
- QeK duhet të rishikojë kriteret e skemës së asistencës sociale, në veçanti kriterin e moshës për fëmijët, si dhe të merr parasysh futjen e një mjeti të testuar për përfitim të veçantë të fëmijëve si një masë për të arritur fëmijët më të cenueshëm të cilët po përballen me varfërinë përfshirë FnL, dhe
- QeK duhet të sigurojë financim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për shërbimet sociale në Kosovë në mënyrë që ata janë në gjendje që të përmbushin nevojat për mbrojtje të të gjithë fëmijëve përfshirë FnL.

Shtojca 1 Sistemi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (FnL)



Çdo profesionist i cili ka kontakt me fëmijën, ka për detyrë që të bashkëpunojë dhe ndihmojë QPS-në gjatë vlerësimit

Në raste të abuzimit të fëmijëve: zbatimin e ligjit me obligim për të ndihmuar QPS-në gjatë vlerësimit dhe hetimit të veprave, kur është e nevojshme

Brenda 72 orëve, nëse pëlqimi për heqjen e fëmijës nuk është marrë, rasti duhet të paraqitet para një gjyqtari

Fëmija i kthehet kujdestarit.

Gjyqtari urdhëron një urdhër për vlerësim për t'u kryer brenda 21 ditëve

Pas vlerësimit, brenda 24 orëve, QPS-ja ia dërgon raportin Drejtorisë Komunale përkatëse



Procese të tjera të rëndësishme për FL


Trafikimi përfshirë kërkim lëmoshën
Early Identification
Identifikimi zyrtar
Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe /ose Inspektorët e Punës
Aplikimi i listës së treguesit: Njësitë e Policisë, Prokurorisë, Avokatët e viktimave dhe QPS-ja
Gjatë procedurës penale: fëmija viktimë mund të ketë një përfaqësues të autorizuar / një personi i rritur i përshtatshëm dhe mund të merret në pyetje si dëshmitar me ndihmën e pedagogut, psikologut ose ndonjë eksperti tjetër.
Ndihma dhe mbrojtja e ofruar përfsh. strehimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin. Rastet individuale i referohen QPS-së
Kërkesa për azil
Pika Kufitare, Stacioni Policor ose Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
I mituri i pashoqëruar me punëtorin social të emëruar për ta ndihmuar / përfaqësuar gjatë procedurës
Transferuar në Qendrën për Azilkërkues
Vendim i shkallës së parë
Refuzimi
Statusi i refugjatit ose i mbrojtjes plotësuese
Ankesë në Komitetin Nacional për Refugjatë
Heqja
Dëshmitë e reja rezultojnë në kërkesa të reja
Të kthyerit
Lehtësimi i kthimit:
Ministria e Punëve të Brendshme
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
Këshilli Ndër-ministror Koordinues
Riintegrimi
Niveli
Fondi për Riintegrim
DRRP
KQR
Komisioni për Ankesa
Strehim . e përkosh
ZKKK
Riintegrimi
Drejtoritë Komunale
TRC

Shtojca 3 Mostra e Pyetësorit – Fëmijët

1. Emri
2. Ku është fëmija i vendosur /gjetur?
3. Fëmijët në lëvizje janë…
4. Ata vijnë nga..
5. A janë nga këtu apo ndonjë vend tjetër? Ata vijnë nga …
6. A jeni ju njëri nga ata? Ju jeni nga…
7. Disa fëmijë kthehen këtu? Kur ata shkojnë ata shkojnë te…
8. A mendoni se do të jetë mirë apo keq për të shkuar diku tjetër? A mund të shpjegoni pse?
9. Ku jeni duke jetuar tani? A jeni me familjen tuaj, në një institucion apo…
10. Sa vjeçar jeni?
11. Sa fëmijë ju i njihni si ju?
12. A ka djem dhe vajza, sa nga secili?
13. Çfarë bëni ju çdo ditë, për shembull, a jeni vetëm, na thuani diçka për këtë...
14. A është duke ju ndihmuar ndonjë lloj organizate ose duke bërë ndonjë gjë tjetër me ju? Shpjegoni çfarë...
15. A ka ndonjë gjë tjetër që ju do të donit të thoni?

Shtojca 4 Mostra e pyetësorit – Personat përgjegjës

1. Çfarë dini në lidhje me shërbimet për mbrojtje të fëmijëve?
2. Ku ata mund të gjenden?
3. Cili është mandati i tyre?
4. A e dini se çfarë bëjnë ata?
5. A e konsideroni sistemin gjithëppërfshirës?
6. A është lehtë e qasshme?
7. A ofron shtrirje?
8. A është efektive?
9. A e dini se në qoftë se ka standarde të specializuara për mbrojtjen e e grupeve të veçanta të fëmijëve?
10. Llojet e fëmijëve?
11. A janë të përjashtuar ndonjë grup i fëmijëve? Nëse është kështu, kush janë ata dhe pse?
12. A ndjeni se ato standarde funksionojnë?
13. Çfarë mendoni se janë ato?
14. Sa fëmijë mbulohen nga shërbimet ekzistuese për mbrojtje të fëmijëve?
15. Cilat janë pengesat ligjore, administrative dhe praktike që fëmijët në lëvizje mund të përballen sa i përket qasjes në shërbime?
16. Kur ndodh ajo?
17. A e dini nëse ka dokumentacion për këto shërbime?
18. A keni prodhuar, qenë i përfshirë në prodhimin ose përdorimin e atij dokumentacioni?
19. A ka ndarë organizata juaj buxhet për mbrojtje të fëmijëve?
20. Nëse po, sa është ai?
21. A ka ndonjë gjë tjetër që ju do të donit t'i shtoni asaj që tanimë keni thënë? Për shembull, në përgjithësi a besoni se shërbimet funksionojnë edhe për fëmijët e margjinalizuar siç janë ata në lëvizje që ky studim është në kërkim apo mendoni se diçka tjetër do të mund të bëhet?
22. Ndonjë detaj tjetër

Referencat

Marrëveshja e Bashkëpunimit për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe për Identifikimin e Zgjeruar, Njoftimin, Referimin dhe Kthimin Vullnetar të Asistuar të Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, sidomos Fëmijët, Plotësimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar" të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, qershor 2012

Bitoulas A, Eurostat Të dhënat në fokus 3/2014, 'Kushtet e Popullsisë dhe Sociale, në dispozicion te http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-QA-14-003/EN/KS-QA-14-003-EN.PDF e qasur më 10/04/2014

Briscoe, S. 'Numri i Personave përgjegjës për Shërbime Sociale në MPMS në Kosovë', Helsinki Group, 2004

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 - Për të drejtën e fëmijës që të ketë interesat e tij më të mira primare 2013

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 Trajtimi i pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, 2005

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Misionit të Këshillit të Posaçëm të Evropës në Kosovë, 23-27 mars 2009 në dispozicion në https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1466279 qasur më 10/04/2014

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

Konventa e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual CETS Nr. 201, 25 tetor 2007

C138, Konventa mbi Moshën Minimale (Nr. 138), Konventa për Moshën Minimale të pranimit në punë, 19 qershor 1976

C182, Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve (Nr. 182), Konventa lidhur me Ndalimin dhe Veprimin e Menjëhershëm për Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, 19 nëntor 2000

Dottridge M, 'Çfarë mund të bëni për të mbrojtur fëmijët në lëvizje - një doracak', Terre des Hommes Federata Ndërkombëtare, nëntor 2012

Këshilli Evropian për Refugjatët dhe të Dëbuarit në partneritet strategjik me Save the Children (Zyra e BE-së), "Studim krahasues mbi praktikat në fushën e kthimit të të Miturve", HOME/2009/RFXXPR/1002, dhjetor 2011

Feneyrol O, 'Rritja e sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve ", Politika tematike, Terre des hommes - lehtësimi i fëmijëve, tetor 2011

François Crépeau, botuar në "Fëmijët në lëvizje", Organizata Ndërkombëtare për Migrim, në dispozicion në http://publications.iom.int/bookstore/free/Children_on_the_Move_15May.pdf accessed më 25/04/2014

Organizata Ndërkombëtare për Migrim, 'Fjalor për Migrim, 2004

Knaus V, UNICEF Kosova, "Nuk ka vend për të thirrur në shtëpi - riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë siç shihet dhe përjetohet nga fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian', 2011

Knaus V, UNICEF Kosova, 'Heshtja dëmton - Një raport i vlerësimit të gjendjes së shëndetit psiko-social të fëmijëve të riatdhesuar ", 2012

Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezultatet e regjistrimit të vitit 2011, në dispozicion në http://census.rksgov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?a1=yC&a2=uF0&n=1UR906$$$$$04&o=&v=1UR060DS00V70000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0 qasur më 10/05/2014

Agjencia Kosovare për Statistika, "Anketa e fuqisë punëtore të Kosovës - 2013 Rezultatet", në dispozicion në http://ask.rks-gov.net/publikimet/doc_view/1131-rezultatet-e-anketaeumls-saeuml-fuqisaeuml-punaeumltore-2013-naeuml-kosovaeuml?tmpl=component&format=raw qasur më 10/05/2014

Agjencia Statistikave të Kosovës, " Statistikat e Mirëqenies Sociale" 2013, në dispozicion në http://ask.rks-gov.net/statistikat-e-mireqenies-/publikimet/doc_view/1092-statistikat-e-miraeumlqenjes-sociale-2013?tmpl=component&format=raw qasur më 10/05/2014

Milne B, Mario 'Udhëzime metodologjike për Kërkime dhe Konsultimet me Fëmijë', Projekti Mario 2013

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, "Raporti vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve 2012 ', në dispozicion në https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/Report%202012%20on%20Implementation%20of%20the%20KAP%20for%20Prevention%20and%20Elimination%20of%20CL%20in%20Kosovo.pdf qasur më 05/04/2014

Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, "Hartografi dhe Vlerësim të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Republikën e Kosovës", 2012

Protokolli Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 20 Maj 2000

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, "Ndjekja e braktisjes së shkollës dhe të mospjesëmarrjes në Kosovë", shtator 2012, në dispozicion në http://www.osce.org/kosovo/95112?download=true qasur më 10/05/2014

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë, "Përcaktimi dhe Ndjekja e Krimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore", tetor 2011

Reale D, The Save the Children Fund, 'Larg nga Shtëpia – Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje, 2008

Romani LP, 'Procesi i Riatdhesimit në Kosovë - organizimi institucional, korniza ligjore, mësimet e nxjerra dhe sfidat e mbetura ", Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë, dhjetor 2013

Roelen K, Gassman F, 'Sa mund të jetë efektive efikase? Asistenca sociale në Kosovë dhe çfarë do të thotë për Fëmijët ", dhjetor 2010

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve 1989

Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000

Kombet e Bashkuara, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, Divizioni i Popullsisë, "Migrimi Ndërkombëtar 2013 ', në dispozicion në http://esa.un.org/unmigration/documents/WallChart2013.pdf accessed on 25/03/2014

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Protokolli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, 15 nëntor 2000

Shtetet e Bashkuara Departamenti i Shtetit, "Raporti për Trafikimin e Personave '2013, në dispozicion në http://www.state.gov/documents/organization/210740.pdf qasur më 10/05/2014

Banka Botërore, "Punim për Sfondin Teknik Sektorët Social - Çështjet e politikave në sektorët socialë", Korrik 2008, Konferenca e Donatorëve, Bruksel

ix.